

lidhjes 1 të këtij vendimi është 2167 punonjës me kontratë. Kjo listë është shtuar me VKM nr. 164, datë 20.3.2024 me 94 punonjës të tjerë. Nga auditimi konstatohet se në këto dokumente nuk është përcaktuar efekti financiar respektiv për buxhetin e shtetit për vitin 2024. Në krahasim me vitin 2023, konstatohen se përgjithësisht paraqiten të njëjtat pozicione me të njëjtën kohëzgjatje për institucionet që kanë numrin më të madh të punonjësve të parashikuar, si dhe janë miratuar të njëjtat kuota për punonjës me kontratë të përkohshme, për të njëjtat pozicione, duke mos përbushur kushtin e “përkohshmërisë”. Përdorimi i këtyre kontratave në mënyrë të njëpasnjëshme shoqërohet me riskun e kalimit të afateve dhe shndërrimit automatikisht në kontrata me afat të pacaktuar, duke shmangur procedurat normale konkurruese të rekrutimit.

Shpenzimet për interesa të borxhit, u buxhetuan në nivelin 66,177 milionë lekë dhe u rishikuan me AN5 në nivelin 60,328 milionë lekë. Megjithatë, shpenzimet e vitit 2024 në shumën 54,459 milionë lekë rezultuan 5,869 milionë lekë nën parashikimin buxhetor si rezultat i mosrealizimit të kontigjencës për risqet e borxhit e planifikuar në vlerën 5,420 milionë lekë. Tabela e mëposhtme paraqet raportimet e planit dhe faktit për zërat analitik të shpenzimeve të interesit:

Në milionë lekë

	Fakti 2023	Buxheti fillestar 2024	Akti Normativ 1/2024	Akti Normativ 3/2024	Akti Normativ 5/2024	Fakti 2024	Diferenca fakt-plan 2024	Diferenca fakt 2024-2023
Interesat	47,591	66,177	66,158 ↓	64,238 ↓	60,328 ↓	54,459 ↓	-5,869	⇌ 6,868
Të Brendshme	29,030	34,494	34,475 ↓	34,494 ↑	33,344 ↓	33,118 ↓	-225	⇌ 4,088
Të Huaja	18,561	26,384	26,384	24,414 ↓	21,564 ↓	21,341 ↓	-223	⇌ 2,780
Kontigjencë për risqet e borxhit		5,300	5,300	5,420 ↑	5,420		-5,420	⇌ 0

Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga KLSH

Shpenzimet për interesa përgjatë vitit 2024, kanë rezultuar në rritje përkundrejt 47,591 milionë lekë të realizuara një vit më parë me 6,868 milionë lekë, ose me rreth 15%. Rritja më e madhe në interesat e borxhit konstatohet në interesat e borxhit të brendshëm me rreth 4,088 milionë lekë përkundrejt 2,780 milionë lekë interesa të paguara më shumë për borxhin e jashtëm.

Shpenzimet operative mirëmbajtje. Në këtë zë buxheti u rrit me 9,719 milionë lekë krahasuar me një vit më parë. Megjithatë, realizimi i vitit 2024 me 80,208 milionë lekë rezultoi 2,436 milionë lekë nën parashikimin buxhetor.


Në milionë lekë

	Fakti 2023	Buxheti fillestar 2024	Akti Normativ 1/2024	Akti Normativ 3/2024	Akti Normativ 5/2024	Fakti 2024	Diferenca fakt-plan 2024	Diferenca fakt 2024-2023
Shpenzime Operative Mirëmbajtje nga të cilat:	70,489	67,058	67,286 ↑	72,329 ↑	82,644 ↑	80,208 ↓	-2,436	⇌ 9,719
Të qeverisjes qendrore		63,458	63,686 ↑	68,729 ↑	79,044 ↑			⇌
Arsimi i Lartë nga të ardhurat e veta		1,000	1,000	1,000	1,000			⇌
Të tjerat jashtë limitit		2,600	2,600	2,600	2,600			⇌

Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga KLSH

Nga auditimi mbi bazën e të dhënave të pagesave të kryera për llogari të buxhetit të vitit 2024 për shpenzime operative, u konstatua se zërat më përfaqësues analitik përbëhen nga materiale të ndryshme, shërbime, karburant, dieta, honorare, mirëmbajtje dhe ekzekutim vendimesh gjyqësore sipas grafikut të mëposhtëm:

Në milionë lekë



Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga KLSH

Sipas të dhënave të regjistruara në SIFQ, raportohet se njësitë e qeverisjes së përgjithshme angazhojnë një pjesë të konsiderueshme të buxhetit operativ në materiale dhe shërbime speciale me rreth 14,322 milionë lekë në dy llogari buxhetore. Zëri “Ilaçe dhe materiale mjekësore” me buxhet përfaqësues në sektorin e shëndetësisë, paraqitet në rreth 6,149 milionë lekë, ndërkohë që për shërbimet e pastrimit janë paguar rreth 5,272 milionë lekë. Aktivitetet e furnizimit me shërbime dhe ushqim për mensat, në kuadër të përkujdesjes sociale kanë angazhuar rreth 5,071 milionë lekë. Mirëmbajtja e pajisjeve të zyrës, objekteve ndërtimore apo rrugëve e objekteve të tjera në katër llogari të ndryshme përfshin pagesa në rreth 10,864 milionë lekë. Në pagesën e faturave të energjisë elektrike janë angazhuar 4,569 milionë lekë ndërkohë që për karburant janë paguar 3,953 milionë lekë.

! Kostoja e vendimeve gjyqësore për largim nga puna paraqitet në shumën 1,367 milionë lekë, dhe përbën një shpenzim për të cilin vazhdimisht buxheti i shtetit angazhon burime financiare shtesë mbi fondin pagave. Për këto vendime gjyqësore nuk publikohet një bazë të dhënash për të gjithë sektorin publik, për të provigjonuar fonde për detyrimet e pritshme nga vendimet gjyqësore me qëllim parashikimin e fondeve për shlyerjen e tyre, si dhe institucionet nuk publikojnë grafikun e shlyerjes së vendimeve gjyqësore.

Gjithashtu, nga auditimet në institucione e qeverisjes së përgjithshme janë konstatuar problematika në lidhje regjistrimin, planifikimin por edhe me rradhën e kryerjes së pagesave ndaj gjyqfituesve. Nga auditimi i veprimtarisë së Komisioneve të Posaçme konstatohet se nuk merren masat e duhura për sistemin apo kthimin në punë të gjyqfituesve për të cilët vazhdojnë të kryhen pagesa për pagat mujore, duke gjeneruar kosto shtesë për buxhetin e shtetit vit pas viti.

Sa i takon gjyqfituesve të larguar nga shërbimi civil dhe që ndodhen në listë pritjeje për sistemim në pozicionet përkatëse, konstatohet një tendencë në rritje të numrit të tyre.

Fondet për transferta drejt të tretëve. Nga auditimi mbi fondet e detajuara në llogarinë “transferta drejt të tretëve” u konstatua se janë parashikuar pagesa nga buxheti i shtetit me përfitues institucione shtetërore në një këst të vetëm, të cilat ekzekutohen jashtë sistemit të thesarit. Kjo procedurë bën të pamundur gjurmueshmërinë e përdorimit të këtyre fondeve. Kështu:

! Me aktin normativ nr. 5, datë 19.12.2024, është miratuar një fond prej 2,000 milionë lekë, i përcaktuar si mbështetje financiare në formën e huasë për Albcontrol sha, në llogarinë ekonomike 604 “Të tjera transferta për institucionet jofitimprurëse”, në të cilën regjistrohen grante ose subvencione, dhe jo hua, siç përcaktohet në aktin normativ dhe ndryshe nga huaja e mëparshme për Albcontrol e cila ishte trajtuar sipas zërave të saktë fiskalë “Hua e dhënë për Albcontrol”. Transferimi i fondeve në një këst të vetëm, me kalim direkt në llogaritë bankare të institucionit për të mbuluar aktivitetin vjetor (për shkak të bllokimit të llogarive), nuk respekton parimin e zbatimit të buxhetit përmes sistemit të thesarit duke mos garantuar gjurmueshmërinë dhe kontrollin mbi përdorimin e këtyre fondeve.

Kontrata e huadhënies lidhur më 17.01.2025 ndërmjet Albcontrol dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nuk përmban elementët thelbësorë financiarë, si afati i shlyerjes, normat e interesit apo penaltitetet për vonesë dhe këto elementë janë lënë për t’u përcaktuar në një marrëveshje të mëvonshme mes Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila konstatohet se ende nuk është përmbyllur.

Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) ka kërkuar financim shtesë për zgjatjen e projektit të digjitalizimit të të dhënave kadastrale dhe për projektin e regjistrimit fillestar të 106 zonave kadastrale, në shumën totale 1,577 milionë lekë, përmes Ministrisë së Financave. Kjo kërkesë është miratuar nëpërmjet aktit normativ nr. 5, datë 19.12.2024 dhe fondet janë transferuar përmes programit “Ekzekutimi i pagesave të ndryshme” dhe është regjistruar në llogarinë ekonomike 604 “Të tjera transferime korrente”, që nuk përputhet me natyrën e transaksionit dhe krijon pasaktësi në pasqyrimin buxhetor. Gjithashtu, konstatohet se kërkesa për fondet është nënshkruar NPA në rolin e NA në kundërshtim me nenin 19 të ligjit nr. 9936/2008, i ndryshuar, i cili përcakton qartë rolin e nëpunësit autorizues në njësinë buxhetore. Nga Ministria e Financave është miratuar dhe transferuar shuma e kërkuar për vitet 2024-2025, duke përdorur buxhetin e vitit 2024 për financimin e viteve të ardhshme.


Me shkresën nr. 7906/1, datë 19.12.2024, zëvendësministri i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit i ka dërguar MF “Kërkesë për shtesë buxheti për vitin 2024 (AN5)”, sipas të cilës Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar ka kërkuar financimin e vlerës së mbetur të projektit “Ekipet Sportive në Shkolla”. Nga verifikimi në modulën e pagesave konstatohet se KOKSH ka përfituar fondet nëpërmjet dy transfertave përkatësisht në shumën 200 milionë lekë dhe në shumën 150 milionë lekë nëpërmjet llogarisë 604.

Subvencionet. Në këtë zë përfshihen transfertat të kryera nga buxheti drejt të tretëve. Fondet e akorduara u realizuan në shumën 1,794 milionë lekë ose 70 milionë lekë mbi planin përfundimtar me aktin normativ nr.5 dhe 112 milionë lekë më pak se një vit më parë.

Fondi për dëmshpërblimin financiar të ish të përndjekurve politikë. Menaxhimi i procesit të shpërndarjes së dëmshpërblimit financiar për ish-të dënuarit dhe të përndjekurit politikë kryhet nga Drejtoria e Pagesave dhe Dëmshpërblimeve, pjesë e strukturës së Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, ndërsa planifikimi i fondeve buxhetore të çelur për programin 01190 “Rehabilitimi i të Përndjekurve Politik” kryhet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, e cila bazuar në VKM nr. 609, datë 20.10.2021 ka në fushëveprimin e saj ndjekjen e çështjeve që kanë të bëjnë me integrimin e të ish-të përndjekurve politikë nga regjimi komunist. Për vitin 2023 treguesi i shlyerjes së detyrimit paraqitej në 45% dhe gjatë vitit 2024 është dëshmuar një rritje e ngadaltë e pagesës me rreth 2% në vit. Sipas përlogaritjeve të grupit të auditimit, procesi do të përfundonte në rreth 27 vite, nëse nuk ndryshon buxheti vjetor i akorduar dhe vijon ky ritëm pagese (2% në vit).

Shpenzimet për fondet special. Në këtë zë buxheti u rrit me 25,003 milionë lekë krahasuar me një vit më parë, megjithatë realizimi i vitit 2024 në shumën 251,791 milionë lekë ishte 86 milionë lekë nën planin përfundimtar. Tabela e mëposhtme paraqet raportimet e planit dhe faktit për zërat analitik të shpenzimeve për fondet speciale:

Në milionë lekë



Mbi skemën e sigurimeve shoqërore

Skema e sigurimeve shoqërore financohet kryesisht nga të ardhurat nga kontributet si dhe transfertat nga buxheti i shtetit. Plani fillestar i fondeve për sigurimet shoqërore është miratuar me Ligjin nr. 97/2023 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2024”, në shumën totale 185,825 milionë lekë. Ky plan është rishikuar me akte normative duke arritur në shumën 188,825 milionë lekë, dhe realizimi është 188,626 milionë lekë. Për vitin 2024, gjatë ndryshimeve të buxhetit janë rishikuar treguesit e skemës duke përfshirë edhe fondet e indeksimit dhe bonusit të pensioneve sipas tabelës së mëposhtme:

Në milionë lekë

Zërat e skemës së sigurimeve shoqërore	Plani fillestar 2024	Plani i rishikuar	Ndrshimi +/- në %
Sigurime shoqërore	178,038	177,258	↓ ↔ -0.4%
• Kontributet	136,239	137,367	↑ ↔ 0.8%
• Transferta nga buxheti i shtetit	41,799	39,891	↓ ↔ -4.6%
Politika të reja pensionesh	4,137	1,693	↓ ↔ -59.1%
Bonusi i Pensioneve	3,650	9,874	↑ ↔ 170.5%
TOTALI	185,825	188,825	↑ ↔ 1.6%

Pjesa e financimit të shpenzimeve nga të ardhurat nga kontributet është rritur me 1,128 milionë lekë ndërkohë që transferta nga buxheti i shtetit është ulur me 1,908 milionë lekë, sipas ndryshimeve në planin e buxhetit me akte normative. Nga bonusi i pensionistëve rezulton të jetë rritur me 6,224 milionë lekë, si burim financimi për shpenzimet e fundvitit, ndërkohë që transferta për indeksimin e pensioneve është realizuar në plan me 2,444 milionë lekë.

Për realizimin e shpenzimeve, ISSH nuk ka kërkuar ulje të financimit nga buxheti i shtetit, pavarësisht se të ardhurat nga kontributet e mbledhura janë realizuar në vlerën 959.7 milionë lekë, ose 559.7 milionë lekë më shumë se plani (240% mbirealizim). Krahasimisht me vitin 2023, financimi nga buxheti i shtetit është rritur për shumën 4,730 milionë lekë ose në masën 10% më shumë, pavarësisht se nevojat për financim kanë rezultuar 2,268 milionë lekë më pak.

Nga analiza e të dhënave për realizimin e shpenzimeve për sigurimet shoqërore në vitin 2024, rezultoi se janë realizuar në vlerën 188,626 milionë lekë, duke shënuar një rritje prej 18,388 milionë lekë ose 10.8% në krahasim me vitin 2023. Konkretisht, tejkalim të shpenzimeve krahasuar me planifikimet fillestare patën disa programe buxhetore, si: Programi “Transferta për buxhetet familjare dhe individët” në vlerën 227.9 milionë lekë, ose 12% më shumë se fondi i miratuar dhe Programi “Shpenzime për përfitime” në vlerën 303.7 milionë lekë ose 19% më shumë se fondi i miratuar.

Ky tejkalim lidhet kryesisht me rritjen e numrit të përfituesve dhe nivelit të përfitimeve, për shkak të faktorëve si, rritja e pagave, rritja e pensioneve si dhe faktorë socialë.

Disa programe të tjera kanë rezultuar me mosrealizim të fondit të planifikuar si: Programi “Shpenzime për programe të veçanta shtetërore” me një mosrealizim prej 75.7 milionë lekë, ose 0.5% më pak se fondi i planifikuar dhe Programi “Shpenzime administrative” me mosrealizim në vlerën 426.8 milionë lekë ose 11% të fondit të parashikuar.

Rritja më e madhe në shpenzimet për fondet speciale konstatohet se ka ardhur nga bonusi i pensionistëve të parashikuar në shumën 9,874 milionë lekë sipas planit përfundimtar i cili fillimisht ishte parashikuar 3,650 milionë lekë.

Sa i takon indeksimit, ai në planin përfundimtar rezulton në shumën 1,693 milionë lekë nga 4,137 milionë lekë planifikimi fillestar, ndërkohë që shpenzimet për sigurime shëndetësore janë rritur me 3,558 milionë lekë më shumë se viti i kaluar.

Financimi nga buxheti i shtetit përfshin grantet për mbulimin e disa skemave të pensioneve, si dhe fondet për mbulimin e defiqitit të skemës së pensioneve. Llogaria 720 “Grant nga buxheti për pagesa të posaçme” paraqitet në realizimin faktik të vitit 2024, për 17,656 milionë lekë, me një rritje prej 1,601 milionë lekë, ose në masën 10% më shumë se një vit më parë.

Kjo rritje lidhet kryesisht me shtimin e bonusit për pensionistët nga 3,650 milionë lekë në mbi 9,800 milionë lekë duke treguar një angazhim më të madh social për të mbështetur kategoritë në nevojë dhe për të përballuar efektet e inflacionit. Transferta nga buxheti i shtetit për indeksimin e pensioneve u ul nga 4,137 milionë lekë në 1,693 milionë lekë. Pra, rritja e bonusit për pensionistët ka kompensuar uljen e vlerës së indeksimit të pensioneve, duke ruajtur mbështetjen totale ndaj përfituesve.

Në total, gjatë vitit 2024, **defiqiti financiar i skemës së pensioneve** ka zbritur në -17,724 milionë lekë ose 0.71% i PBB, krahasuar me -18,358 milionë lekë në vitin 2023, me një përmirësim prej 634.1 milionë lekë ose 0.03% të PBB.

Përmirësimi i defiqitit për vitin 2024, ka qenë kryesisht si rezultat i rritjes së të ardhurave për shkak të rritjes së pagave mesatare dhe i rritjes së numrit të kontribuuesve. **Për skemën e qytetit**, shpenzimet për vitin 2024 rezultuan në vlerën 148,756 milionë lekë, duke shënuar një rritje në masën 11% krahasuar me vitin 2023.

Në nivel degësh shpenzimet krahasuar me 2023 paraqiten:

- shpenzimet për sëmundje janë rritur me 80.22 milionë lekë ose 11.5% më shumë ;
- shpenzimet për barrë lindje janë rritur me 906.40 milionë lekë ose 20% më shumë;
- shpenzimet për pensione janë rritur me 14,140 milionë lekë ose 11% më shumë;
- shpenzimet për aksidente kanë pësuar rritjen më të madhe në përqindjeje me 9.68 milionë lekë ose rreth 41% më shumë.

Sa më sipër, në lidhje me skemën e qytetit, defiqiti rezultoi në shumën 14,054 milionë lekë nga 13,086 milionë lekë që ishte në vitin 2023, pra është rritur me 968 milionë lekë, ose 0.04% ndaj PBB. Duke krahasuar ritmet e rritjes së të ardhurave me ato të shpenzimeve me vitin 2023, rezultoi që të ardhurat janë rritur më pak se shpenzimet.

Nga auditimi i **skemës së fshatit** për vitin 2024 konstatohet se kontributet për degët e barrë lindjes dhe pensioneve u rritën me 22%, duke arritur në 9,810 milionë lekë, ndërsa shpenzimet totale u rritën me 1.5%, në 13,480 milionë lekë. Për sa i përket strukturës së shpenzimeve totale, ato për pensione u rritën me 2.8% nga 12,823 në 13,178 milionë lekë, ndërsa shpenzimet për barrë lindje u ulën me 35% (nga 463 në 301.8 milionë lekë), si pasojë e uljes së numrit të përfituesve, e lidhur kryesisht me rënien e lindshmërisë në zonat rurale, emigrimin e popullsisë në moshë riprodhuese dhe zhvendosjen drejt zonave urbane. Në lidhje me skemën e fshatit, defiqiti rezultoi në shumën 3,670 milionë lekë nga 5,272 milionë lekë që ishte në vitin 2023, pra është ulur në shumën 1,602 milionë lekë ose me 0.06% ndaj PBB.



Fondi i bonusit të pensionistëve dhe indeksimit të pensioneve

Planifikimi dhe rishpërndarja e fondeve për bonusin e pensionistëve. Nga auditimi u konstatua se, sipas ligjit nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, neni 4, pika 3, ishte parashikuar një shtesë e përhershme nëpërmjet indeksimit të pensioneve në shumën 4,137 milionë lekë dhe një bonus për pensionistët në shumën 3,650 milionë lekë, në total 7,787 milionë lekë. Vetëm 12 ditë para mbylljes së vitit buxhetor, me VKM nr. 736, datë 27.11.2024 “Për shpërblimin e pensionistëve për festat e fund vitit 2024”, u rishpërndanë fondet duke ulur indeksimin në 1,693 milionë lekë dhe duke rritur bonusin në 9,874 milionë lekë, çka e rriti paketën totale në 11,567 milionë lekë. VKM-ja përcaktoi si burime financimi: kursimet nga ulja e fondit të indeksimit me 2,444 milionë lekë dhe shtesë të fondit për bonusin me 6,224 milionë lekë nga buxheti i shtetit dhe buxheti i planifikuar për sigurimet shoqërore. Megjithatë, në momentin e miratimit të VKM-së u konstatua se fondet nuk ishin disponibël për të mbuluar këtë shpenzim i cili u realizua pas miratimit të aktit normativ nr. 5, datë 19.12.2024.

Përlllogaritja e indeksimit të pensioneve. Nga auditimi në ISSH, rezultoi se sipas VKA-së nr. 9, datë 12.09.2024, dhe procesit pasues të indeksimit të pensioneve, për vitin 2024 është përzgjedhur muaji gusht 2024, si bazë për përlllogaritjen e indeksit. Kjo ka ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në uljen e përqindjes së indeksimit për përfituesit e skemës. Ky nivel më i ulët i indeksimit rezulton si pasojë e ndryshimeve të bëra me VKM nr. 11, datë 11.01.2023, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 131, datë 22.02.2017 të Këshillit të Ministrave, për përcaktimin e listës së mallrave të zgjedhura dhe metodën e llogaritjes së indeksit” që e zëvendësoi metodologjinë e mëparshme të përlllogaritjes vjetore, duke mundësuar përdorimin e muajve me inflacion më të ulët si referencë.

Ndryshe nga praktika e ndjekur në vitet 2019 - 2022, kur vendimet për indeksimin miratoheshin në muajin mars mbi bazën e indekseve të janarit/shkurtit kur inflacioni ishte zakonisht më i lartë, për vitin 2024 u aplikua një afat më i vonë (shtator), duke përdorur si referencë muajin me vlerë më të ulët të indeksit të çmimeve. Nga analiza krahasuese e të dhënave të muajve të parë të vitit rezultoi se, në janar 2024 indeksi për shportën e pensionistëve ishte 5.7%. Nëse do të ishte ndjekur praktika e viteve paraardhëse, ku indeksi bazohej në të dhënat e muajit janar të vitit përkatës, përqindja e indeksimit për vitin 2024 do të kishte qenë 5.7% në vend të 4.1%. Ky ndryshim ka ndikuar negativisht në masën reale të rritjes së pensioneve, duke rezultuar në një nivel indeksi më të moderuar i cili nuk reflekton plotësisht tendencën e rritjes së kostos së jetesës për pensionistët, kjo edhe për faktin se vlera 4.1% e aplikuar është më e ulët edhe se mesatarja aritmetike e thjeshtë e indekseve mujore të raportuara nga INSTAT për periudhën janar–gusht 2024, e cila arrinte në rreth 4.6%.



Mbi procedurat e kontrollit në drejtim të përfituesve të skemës së detyrueshme të sigurimeve shoqërore

Nga auditimi në Drejtorinë e Inspektimit të Përfitimeve (DIP), rezultoi se kjo drejtori gjatë vitit 2024 nuk ka planifikuar inspektime pranë Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore (DRSSH), Tiranë, Fier, Lezhë dhe Berat, pavarësisht faktit se këto DRSSH-të, kanë një numër të

konsiderueshëm përfituesish nga skema e detyrueshme e sigurimeve shoqërore, përfshirë pensionet afatgjata, përfitimet e invaliditetit, familjare dhe sociale. Mungesa e inspektimeve ka krijuar mangësi në ushtrimin e kontrollit dhe mbikëqyrjes së rregullt të veprimtarisë së këtyre strukturave, duke rritur ekspozimin ndaj riskut për dhënie përfitimesh të parregullta apo për vonesa në rikuperimin e shumave të paguara në mënyrë të pasaktë. DIP nuk ka inspektuar të gjitha dosjet e paraqitura për kontroll, duke devijuar nga plani i miratuar vjetor si dhe nga detyrimet ligjore në fuqi, mos realizimit në kohë të planeve të inspektimit është në kundërshtim me parashikimet e nenit 62, pika 3 të ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 *“Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, afati për rikuperimin e shumave të konstatuara si të përfituara në mënyrë të padrejtë nga përfituesit e pensioneve është 3 vjet.

Nga auditimi mbi zbatimin e afateve nga përfundimi i inspektimit në terren deri në mbajtjen e Raportit Paraprak dhe të Raportit Përfundimtar, rezultoi se nga ana Drejtorisë së Inspektimit të Përfitimeve (DIP) këto afate nuk janë të njëjta dhe variojnë deri në 60 ditë vonesë. Në disa raste përfituesit në momentin e lidhjes së pensionit kanë vijuar të jenë të punësuar, duke përfituar njëkohësisht pension.

DIP dhe inspektorët pranë DRSSH-ve, në momentin e çertifikimit nuk kanë përlogaritur saktë vlerat debitore dhe kreditore dhe në disa raste përfituesit edhe pse janë shpallur debitor pas çertifikimit për vlerën e përfituar padrejtësisht, kanë vijuar të kryejnë të njëjtin veprim duke u punësuar dhe duke përfituar pension pleqërie.

Mbi skemën e detyrueshme të sigurimeve shëndetësore

Skema e sigurimeve shëndetësore është ngritur dhe funksionon sipas përcaktimeve në ligjin nr. 10383, datë 24.02.2011 *“Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar. FSDKSH administron dhe zhvillon skemën e sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë dhe garanton përfitimet e sigurimeve shëndetësore për popullatën dhe qëndrueshmërinë e skemës së sigurimeve. Legjislacioni parashikon se siguri i detyrueshëm shëndetësor bazohet në pagesën e kontributeve përkatëse për të gjithë personat ekonomikisht aktive, me banim të përhershëm në Shqipëri dhe kategorinë e personave ekonomikisht joaktivë, pagesa e kontributeve të të cilëve financohet nga Buxheti i Shtetit ose burime të tjera të përcaktuara me ligj.

Sigurimi i detyrueshëm financon paketat e shërbimeve të sigurimit të detyrueshëm, ku përfshihen:

- vizitat, ekzaminimet dhe trajtimet mjekësore në qendrat e kujdesit shëndetësor parësor publik dhe në spitalet publike;
- vizitat, ekzaminimet dhe trajtimet mjekësore në dhënës privat të kujdesit parësor dhe spitale private;
- barnat, produktet dhe trajtimet mjekësore nga dhënës të kontraktuar shërbimesh shëndetësore.

Buxheti i miratuar me Ligjin nr. 97/2023 *“Për buxhetin e vitit 2024”*, për Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, është 58,052 milionë lekë. Fondi për rimbursimin e medikamenteve nuk e tejkalon tavanin prej 12,000 milionë lekë. Me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 26, datë 17.01.2024, *“Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga*

skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2024”, është detajuar buxheti për shërbimin spitalor.

Në strukturën e të ardhurave për vitin 2024, për skemën e sigurimit shëndetësor, peshën specifike më të madhe e zënë transfertat e buxhetit të shtetit me 63.8% (nga të cilat 55.4% për shërbimin spitalor dhe 8.4% për shërbimin parësor), ndjekur nga të ardhurat e kontributeve të sigurimeve shëndetësore me 35.7%, ndërkohë që të ardhurat nga burime të tjera zënë një peshë specifike të vogël prej 0.5%.

Në strukturën e shpenzimeve faktike, peshën specifike më të madhe e zënë shpenzimet e shërbimit spitalor me 56.8%, ndjekur nga shpenzimet e kujdesit parësor (financimi i Qendrave Shëndetësore e kontrollit mjekësor bazë) me 21.1%, shpenzimet për rimbursimin e barnave e pajisjeve me 20.3%, shpenzimet administrative (pagat e shpërblimet, sigurimet shoqërore-shëndetësore, mallra e shërbime) me 1.8 % dhe investimet me një peshë jo të konsiderueshme.



Mbi procedurat e kontrollit në drejtim të përfituesve të skemës së detyrueshme të sigurimeve shëndetësore

Lista e Barnave të Rimbursueshme(LBR). Nga auditimi i raport-kontrolleve të Drejtorisë së Kontrollit në FSDKSSH u konstatua se nuk është kryer verifikimi i çmimeve dhe e kontrollit fizik të faturave/transaksioneve duke mos lejuar vlerësimin objektiv të përputhshmërisë me çmimet e referencës rrjedhimisht e ka bërë të pazbatueshme dispozitën e nenit 18, për ndërprerjen e kontratës në rast shkeljesh të përsëritura. Në kontrole është regjistruar vetëm sasia fizike e barnave, pa datat e skadencës, çka përbën mangësi thelbësore duke mos mundësuar vlerësimin objektiv të disponibilitetit, sipas nenit 5 të kontratës dhe të përmbushjes së gjendjeve minimale për alternativat e para/të vetme në LBR.

Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve së raport-kontrollit me inventarizim të plotë në depot farmaceutike, u konstatuan problematika që lidhen me mosdeklarim të saktë të të dhënave në sistemin elektronik “e-Depo”, me mospërfshirjen e plotë dhe të justifikuar të hyrjeve të barnave në procesin e inventarizimit, shkeljen e dispozitave kontraktuale dhe ligjore në lidhje me menaxhimin e inventarit, raportimin elektronik dhe dokumentacionin financiar, mungesë kontrolli dhe dokumentimi të qartë në procesin e inventarizimit, përdorim të gabuar të kodeve të barnave, mospërputhje të të dhënave të depozituara nga subjekti dhe daljes së barnave në sistemin e-depo, si dhe diferenca të paargumentuara në gjendjen fizike. Megjithëse kontratat me depot farmaceutike kanë përcaktuar detyrimin për sigurimin e disponibilitetit të barnave alternative të para dhe të vetme, grupet e kontrollit nuk e kanë konsideruar mungesën e tyre si shkelje të kushteve kontraktuale, situatë kjo që evidenton mungesë të verifikimit dhe monitorimit efektiv të disponibilitetit të barnave alternativë e parë dhe e vetme, duke rritur riskun e mungesës së barnave të nevojshme në tregun farmaceutik.

Nga auditimi rezultoi se, Këshilli Administrativ i FSDKSSH ka miratuar ndryshime thelbësore në draft-kontratat e vitit 2024, pa relacion teknik/juridik shoqërues, duke kufizuar kontrollin fizik të Fondit vetëm të barnat e reja të Listës së Barnave të Rimbursueshme (LBR-së). Nga auditimi i LBR të vitit 2024 u konstatua se janë përfshirë 28 barna për të cilat mungon çmimi CIF i miratuar për

vitin përkatës, si dhe 14 barna të tjera të pajisura vetëm me leje importi, për të cilat mungon deklarimi i çmimit CIF në 12 muajt e fundit, duke përbërë shkelje të barazisë në trajtim.

Gjatë vitit 2024 janë lidhur 7 marrëveshje të posaçme (MEA) ndërmjet MSHMS-së dhe kompanive farmaceutike, për zbatim nga FSDKSH, por dy prej tyre janë finalizuar në tejkalim të afatit 60-ditor sipas pikës 8 të VKM nr. 314, datë 24.05.2023, parashikuan hyrje në fuqi me VKM nr. 491, datë 24.07.2024.

LBR 2024 përfshiu 59 barna pa asnjë konsum dhe pa kontrata (8 në LBR I, 51 në LBR II) dhe, pavarësisht 17 njoftimeve zyrtare të importuesve për ndërprerje furnizimi, 16 prej tyre u mbajtën sërish në listë, në mospërputhje me nenin 16, pika d)–dh) të Ligjit nr. 105/2014.

Gjatë hartimit të LBR 2024, propozimet e kompanive farmaceutike për përfshirjen e barnave antitumorale origjinatore edhe pse të shoqëruara me ulje të çmimit CIF dhe impakt pozitiv buxhetor, nuk u morën në konsideratë nga Komisioni Teknik për shkak të mungesës së fondeve buxhetore. U konstatua se FSDKSH nuk ka lidhur kontrata për një sërë barnash “alternativë e parë/e vetme”, në kundërshtim me nenet 10 dhe 29 të Ligjit nr. 10383/2011, duke sjellë mungesa në treg dhe vështirësi në mbulimin e nevojave të pacientëve.

Në programin vjetor të **kontrollit të farmacive** për vitin 2024 nuk janë përfshirë subjekte me luhatje të konsiderueshme të vlerave të rimbursimit si dhe nga grupet e kontrollit nuk janë kryer verifikimet mbi tregtimin e barnave me rimbursim sipas firmave prodhuese, të përfshira në LBR dhe të shpërndara nga depot me kontratë me FSDKSH-në. Kontrata kërkon që hyrjet nga importuesi të jenë të regjistruara në mënyrë të kompjuterizuar dhe të shoqëruara me faturë tatimore në mungesë të të cilave hyrjet nuk merren në konsideratë për kontroll përmes inventarit.

Nga auditimi i veprimtarisë së **Sektorit të Kontrollit Parësor**, u konstatua se kontrolli është kufizuar te mjekët me vlerë rimbursimi vjetor mbi 12 milionë lekë duke lënë jashtë 160 mjekë që kanë realizuar vlera më të ulëta rimbursimi. Nuk është siguruar mbulimi i plotë me kontrolle në spitale, duke realizuar kontrolle vetëm në 20 spitale (3 universitare, 7 rajonale, 10 bashkiake) ndaj kërkesës për 5 universitare, 11 rajonale dhe 13 bashkiake me mungesë kontrollesh në 2 spitale universitare (“Nënë Tereza”, “Trauma”), 3 rajonale (Dibër, Gjirokastër, Kukës) dhe 2 bashkiake (Has, Skrapar), të cilat duhej të kontrolloheshin respektivisht çdo vit dhe të paktën një herë në dy vjet.

U konstatua se përgjatë vitit 2024, një numër importuesish kanë shfaqur vonesa të përsëritura, duke shkelur kontratat dy-/trepalëshe, ndërkohë që Sektori i Kontrollit të Depove Farmaceutike nuk ka ushtruar kontrolle në depo, nuk ka vlerësuar sinjalizimet dhe nuk ka marrë masa administrative sipas nenit 16 (dypalëshe) dhe nenit 20/2 e 20/11 (trepalëshe), në kundërshtim me Rregulloren nr. 1 (Kapitulli XI). Sipas “Kushtit penal”, për 20 raste të mungesës së alternativës së vetme dhe 10 raste të alternativës së parë, importuesit duhej të ishin penalizuar me 20 milionë lekë dhe 5 milionë lekë respektivisht, por është marrë në konsideratë vetëm shkelja e parë pavarësisht përsëritjeve. Janë konstatuar gjithashtu, mospërmbushje të detyrimeve kontraktuale (neni 15 dhe neni 20/1), pasi nuk janë marrë masa administrative/penalizuese pavarësisht 7 rasteve të mungesës së alternativës së vetme dhe 16 raste të alternativës së parë, për të cilat duhej të aplikoheshin penaltete, respektivisht 7 milionë lekë dhe 8 milionë lekë. Gjithashtu, FSDKSH nuk ka vënë në dijeni AKBPM sipas nenit 16/1/d të Ligjit nr. 105/2014, gjë që ka penguar

masat rregullatore dhe ka rritur rrezikun e mungesave si në rrjetin e hapur, ashtu edhe në atë spitalor.

Gjatë janar–korrik 2024 nuk u realizuan kontrolle në depot farmaceutike, pavarësisht mungesave të raportuara dhe në kundërshtim me nenin 6, pikat 3 dhe 5 të marrëveshjeve. Gjithashtu, rezultoi mungesë koordinimi/transparence, me përjashtime të justifikuara si “jo më në LBR”, ndonëse barnat kanë vazhduar të qarkullonin dhe janë ri-përfshirë me VKM nr. 491, datë 24.07.2024;

Nga auditimi i procesit të verifikimit të disponibilitetit të barnave alternativë e parë dhe e vetme, gjatë vitit 2024 Drejtoria e Kontrollit nuk ka kryer verifikime në terren në 17 raste (janar–korrik) si dhe për një subjekt me 59 barna (tetor–dhjetor), me gjithë njoftimet e importuesve për stok nën konsum mesatar, të pambështetura me dokumentacion, siç kërkohet nga neni 6 i kontratës së mëparshme dhe nenit 5 i kontratës aktuale, si dhe nuk janë aplikuar penaltete sipas neneve 15 dhe 16 “Kushtet Penale”.

Nga auditimi mbi vlerësimin e funksionimit dhe efektivitetit të sistemit *e-Depo* lidhur me regjistrimin, monitorimin dhe kontrollin e hyrje-daljeve të barnave nga subjektet importuese farmaceutike, për vitin 2024 u konstatua se, nga kompanitë importuese farmaceutike janë kryer dalje për barna të klasifikuara si “spitalore” në një sasi prej 3,690,084 njësi, me vlerë 3,225 milionë lekë. Nga kjo sasi, 159,760 njësi me vlerë të rimbursueshme 60,485 milionë lekë janë shpërndarë në rrjetin e hapur (jo përmes farmacive spitalore publike). Referuar Anekseve 1, të LBR-së 2021 dhe LBR-së 2024 barnat e klasifikuara si “spitalore” janë të destinuara ekskluzivisht për përdorim brenda institucioneve spitalore publike, në bazë të rekomandimeve nga mjekët specialistë, ku e gjithë sasia e importuar e tyre sipas kontratave 3-palëshe (FSDKSH – Depo Importuese – QSUT), duhet të bëhet dalje vetëm tek farmacitë spitalore publike, sipas të drejtave dhe detyrimeve të kontratës. Sa më sipër, veprime në kundërshtim me pikën 1 të VKM nr.489, datë 30.07.2021 “Për miratimin e listës së barnave, që rimbursohen nga FSDKSH dhe masën e mbulimit të çmimit të tyre”, me pikën 1 të VKM nr.491, datë 24.07.2024 “Për miratimin e listës së barnave, që rimbursohen nga FSDKSH dhe masën e mbulimit të çmimit të tyre”, të cilat përcaktojnë qartësisht se përdorimi dhe rimbursimi i barnave spitalore mund të bëhet vetëm nëpërmjet sistemit spitalor publik.

Për këtë situatë, Drejtoria e Kontrollit në FSDKSH nuk ka marrë veprime parandaluese dhe nuk ka ushtruar kontrolle të thelluara ndaj depove farmaceutike që kanë kryer dalje të barnave spitalore drejt rrjetit të hapur. Gjithashtu, nuk janë marrë masa për të penalizuar importuesit për shkeljet e kushteve kontraktuale.

Nga auditimi i të dhënave të gjeneruara nga sistemi “e-depo”, për periudhën janar–dhjetor 2024 u konstatuan raste të shumta të daljeve të barnave nga importuesit/shpërndarësit farmaceutik të shoqëruara me fatura me vlerë zero lekë për të cilat çmimi i barit nuk është gjeneruar automatikisht nga sistemi, siç parashikohet në manualin e përdorimit të “e-depove” por është vendosur manualisht. Për këto barna është përfituar rimbursim të plotë nga FSDKSH në vlerën e çmimit të barit sipas LBR-së, plus marzhin tregtar të miratuar prej 24% për tregtimin me pakicë dhe 8% për shumicën, sipas përcaktimeve në VKM-së nr. 489 datë 30.07.2021 “Për miratimin e listës së barnave që rimbursohen nga FSDKSH dhe të masës së mbulimit të çmimit të tyre” i ndryshuar dhe nenit 4 të VKM-së nr. 491, datë 24.07.2024 “Për miratimin e listës së barnave që rimbursohen nga FSDKSH-ja dhe të masës së mbulimit të çmimit të tyre”.

Nga auditimi i të dhënave të gjeneruara nga sistemi “e-depo” për daljet e barnave nga importuesit/shpërndarësit farmaceutike gjatë vitit 2024, si dhe të transaksioneve të regjistruara në sistemin “e-depo” u konstatua se nga 207 transaksione të regjistruara në sistemin “e-depo”, në 37 raste fatura shitjeje për gjithsej 102,778 njësi barna, ato kanë datë skadencë identike me datën e shitjes/hyrjes në farmaci dhe në 170 fatura shitjeje për 143,598 njësi barnash janë bërë dalje nga depot me datë skadencë me afat 1-5 ditë nga data e shitjes/hyrjes në farmaci.

Kjo situatë ka ardhur si rezultat i mungesës së mekanizmave efektivë të mbikëqyrjes, monitorimit dhe kontrollit, nga ana e strukturave përkatëse të FSDKSH-së, lidhur me qarkullimin e barnave me afat skadence të afërt ose të njëjtë me datën e daljes nga depot farmaceutike.

Nga verifikimi i procedurave, rezultoi se FSDKSH nuk ka kryer kontrole ose monitorime të vazhdueshme dhe të dokumentuara për këto raste. Si pasojë, është lejuar qarkullimi dhe përdorimi i barnave të skaduara ose pranë skadencës, në rrjetin farmaceutik, duke u rimbursuar nga fondet publike kur shiten në farmacitë me kontratë. Ky fenomen përbën shkelje të standardeve të menaxhimit farmaceutik dhe të protokolleve të sigurisë së barnave.

Nga auditimi i kryer mbi disponibilitetin e barnave në trajtimin e sëmundjeve tumorale është evidentuar se, nga institucionet e përfshira në auditim, konkretisht nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, FSDKSH, Agjencia e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, nuk janë ezauruar në mënyrë të plotë veprimet e ndërmarra në kuadër të sigurimit të disponibilitetit të barnave, për trajtimin e sëmundjeve tumorale, veçanërisht në kuadër të mekanizmave të kontrollit dhe mbikëqyrjes, si dhe bashkëpunimit ndërinstitutional.

Buxheti i akorduar për sektorin shëndetësor (përkatësisht për barna) rezultoi i nënfinancuar, me mangësi në planifikimin e bazuar në nevoja reale nga shërbimet, vonesa procedurale, kombinuar me parregullsi përgjatë procesit të administrimit të barnave, mbikëqyrjes së furnizimeve, si dhe mungesës së monitorimit nga organet përgjegjëse. Gjithashtu, janë evidentuar mangësi në marrjen e masave për përditësimin e protokolleve të trajtimit të sëmundjeve tumorale, planifikimin e nevojave për barna ashtu dhe në mirëadministrimin e tyre.

Procesi i furnizimit është gjithashtu i ndikuar negativisht nga mungesa e penalteteve për vonesat në zbatimin e kontratave, si dhe nga praktikat joefektive të mbikëqyrjes së zbatimit të kontratave dhe kushteve të furnizimit, të cilat në raste të caktuara kanë çuar në certifikimin e padrejtë të operatorëve ekonomikë si “pa probleme”, pavarësisht mungesave të gjata të barnave gjatë periudhave kritike për trajtimin e pacientëve.

Në Spitalin Rajonal Vlorë, planifikimi i buxhetit për barna dhe materiale mjekimi, kryhet në një procedurë të pa detajuar dhe të pa analizuar, duke mos u bazuar në nevojat reale të fondeve për barna. Nga shërbimet spitalore u konstatua se nuk ka analiza të hollësishme të nevojave për barna, të tilla si konsum historik i llojit të barnave, nevojat për barna sipas mjekimit, numrit të sëmurëve në periudhat e mëparshme dhe sasinë e barnave të akorduara sipas pacientëve etj. Problematikat në planifikim kushtëzohen edhe nga kufizimet në tavanet buxhetore të përcjella nga FSDKSH.

Shpenzimet për buxhetin vendor

Në zërin shpenzime, buxheti vendor u parashikua me një rritje prej 5,565 milionë lekë krahasuar me një vit më parë. Megjithatë, realizimi i vitit 2024 në shumën 74,407 milionë lekë ishte në masën 89.91% ose 8,344 milionë lekë nën planin përfundimtar të miratuar me aktin normativ nr. 5. Pavarësisht se plani i shpenzimeve sipas burimeve të ndryshme të financimit është shoqëruar me rritje të njëpasnjëshme sipas akteve normative gjatë vitit 2024, realizimi i tij nuk ka ndjekur të njëjtën linjë. Tabela e mëposhtme paraqet raportimet e planit dhe faktit të shpenzimeve për buxhetin vendor:

në milionë lekë

	Buxheti fillestar 2024	AN1	AN3	AN5	Plani përfundimtar sipas KLSH-së	Fakti 2024
Shpenzime për Buxhetin Vendor	71,249	71,377 ↑	79,377 ↑	82,750 ↑	92,045 ↑	74,407 ↓
Transferta nga Buxheti i Shtetit për pushtetin vendor	36,657	36,785 ↑	36,785	38,388 ↑		
Transferte të pakushtëzuara e përgjithshme	24,343	24,343	24,343	25,773 ↑		
Transferte të pakushtëzuara sektoriale (Grant Specifik)	10,814	10,942 ↑	10,942	11,115 ↑		
Transferte sektoriale për pagat	1,500	1,500	1,500	1,500		
Buxheti vendor (të ardhurat e veta tatimore)	29,114	29,114	37,114 ↑	39,314 ↑		
Taksa të ndara	1,478	1,478	1,478	1,478		
Buxheti vendor (të ardhurat e veta jo-tatimore)	3,000	3,000	3,000	3,000		
Financimi i huaj vendor dhe të tjera të mbartura	1,000	1,000	1,000	570 ↓		


Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga KLSH



Me ligjin fillestar të buxhetit, shpenzimet për buxhetin vendor janë planifikuar në vlerën 71,249 milionë lekë, nga të cilat shpenzimet nga transfertat e buxhetit të shtetit janë planifikuar në vlerën 36,657 milionë lekë ose 51% e buxhetit total. Me Aktin Normativ 5, datë 19.12.2024, shpenzimet për buxhetin vendor janë rritur për vlerën 11,501 milionë lekë, krahasuar me buxhetin fillestar.

Megjithatë, ky akt normativ nuk reflekton ndryshimet që ka pësuar ky plan me VKM-t për shpërndarje nga fondi i kontigjencës, fondi i rindërtimit apo shkresa të tjera (ri-alokim fondesh), duke sjellë planin përfundimtar në nivelin 92,045 milionë lekë, ose 9,655 milionë lekë me shumë se plani i parashikuar me AN nr. 5, datë 19.12.2024, dhe me realizim në masën 80.52%.


Sa i takon nivelit të shpenzimeve të realizuar nga çdo njësi e vetëqeverisjes vendore, rreth 21 njësi prej tyre përbëjnë 76.34% të totalit të shpenzimeve të realizuara, ku peshën kryesore e zë Bashkia Tiranë, Bashkia Durrës, Bashkia Kamëz, Bashkia Elbasan, Bashkia Vlorë etj. Paraqitja grafike e shpenzimeve të realizuara nga bashkitë, në zërin e shpenzimeve për pushtetin vendor paraqitet në grafikun në vijim:



Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga KLSH

e cila përfaqëson në përbërje edhe shpenzimet e pushtetit vendor për borxhin, sipas llogarive ekonomike dhe eliminime të tjera për efekt të kontabilizimit dhe raportimit të shpenzimeve sipas natyrës, ku peshën më të madhe të shpenzimeve vendore e zënë shpenzimet korrente, ku shpenzimet për paga dhe sigurime janë në vlerën 34,014 milionë lekë ose 45% e totalit të shpenzimeve.

Për vitin 2024, shpenzimet korrente të buxhetit vendor janë realizuar për vlerën 61,087 milionë lekë ose në masën 80.7% të totalit të shpenzimeve, ndërsa shpenzimet kapitale zënë 19.3% të totalit të shpenzimeve dhe janë realizuar në shumën 14,561 milionë lekë ose 89.9% kundrejt planit përfundimtar sipas AN5. Referuar bazës së të dhënave të Drejtorisë së Financave Vendore, shpenzimet e pushtetit vendor janë realizuar në vlerën 75,648 milionë lekë, kundrejt 74,407 milionë lekë të raportuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit në Tabelën e Treguesve Fiskalë të Konsoliduar, me diferencë në vlerën 1,241 milionë lekë,



Mbi detyrimet e prapambetura dhe gjendjen financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore

Në fund të vitit 2024, stoku i detyrimeve të prapambetura për njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas të dhënave të publikuara në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave është 3,258.8 milionë lekë, nga të cilat detyrimet e prapambetura për bashkitë janë 3,239.2 milionë lekë dhe për qarqet janë në shumën 19.6 milionë lekë. Në krahasim me vitin e mëparshëm, stoku i detyrimeve të prapambetura është ulur për shumën 1,580.5 milionë lekë edhe pse referuar bazës së të dhënave

së pagesave të SIFQ, gjatë vitit 2024, nga bashkitë janë paguar detyrime të prapambetura që i përkasin periudhës 2007-2023, në shumën totale 7,267 milionë lekë.

Për pjesën e detyrimeve të bashkive, stokun më të lartë të detyrimeve të prapambetura e ka Bashkia Kavajë, në shumën 737.6 milionë lekë ose 22.7% e totalit të detyrimeve, Bashkia Tiranë me detyrime në shumën 570.4 milionë lekë ose 17.6% e totalit, Bashkia Pogradec në shumën rreth 238.1 milionë lekë ose 7.3% e totalit, Bashkia Rrogozhinë në shumën 161 milionë lekë ose 4.9% të totalit etj. Në lidhje me statusin e gjendjes financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore për vitin 2024, 53 bashki janë klasifikuar pa probleme financiare, 5 bashki janë klasifikuar me probleme financiare (Pogradec, Vorë, Peqin, Konispol, Cërrik) dhe 3 bashki janë klasifikuar në vështirësi financiare (Rrogozhinë, Dimal, Kavajë). Për sa u përket qarqeve, 10 qarqe janë klasifikuar pa probleme financiare dhe 2 qarqe janë klasifikuar në vështirësi financiare (Durrës, Berat).


në milionë lekë

Statusi i Vështirësisë	Nr. i bashkive	Bashkia	Detyrime të prapambetura, më 31.12.2024	% e detyrimeve/Total shpenzimeve faktike
Pa probleme financiare	53	Të gjitha bashkitë e tjera		
Me probleme financiare	5	Pogradec	238,093	18.45%
		Vorë	153,757	16.91%
		Peqin	78,470	19.01%
		Konispol	38,865	19.46%
		Cërrik	115,953	22.85%
Në vështirësi financiare	3	Rrogozhinë	161,007	34.64%
		Dimal	143,810	28.78%
		Kavajë	737,626	54.75%

Krahasuar me vitin 2023, konstatohet se Bashkia Rrogozhinë ka kaluar nga statusi me probleme financiare në statusin në vështirësi financiare. Bashkia Cërrik dhe Vorë kanë përmirësuar statusin krahasuar me vitin e kaluar, duke kaluar nga statusi në vështirësi financiare në statusin me probleme financiare. Bashkia Pogradec ka një stok të detyrimeve të prapambetura në nivelin 18.45% të shpenzimeve vjetore faktike, Bashkia Vorë në nivelin 16.91%, Bashkia Peqin në nivelin 19.01%, Bashkia Konispol në nivelin 19.46% dhe Bashkia Cërrik në nivelin 22.85% të shpenzimeve faktike. Bashkia Dimal dhe Kavajë vijojnë me statusin në vështirësi financiare. Për bashkinë Dimal, niveli i detyrimeve të prapambetura paraqitet në nivelin 28.78% të shpenzimeve vjetore faktike, bashkinë Rrogozhinë në nivelin 34.64% dhe bashkinë Kavajë në nivelin 54.75% të shpenzimeve vjetore faktike. Nga auditimi mbi saktësinë e raportimit të detyrimeve të prapambetura dhe përcaktimit të statusit të gjendjes financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore, rezultoi se në 22 bashki detyrimet e prapambetura të raportuara në fund të vitit 2023 rezultojnë 1,730 milionë lekë më pak se pagesat e kryera gjatë vitit 2024 për detyrime më të hershme se tetor 2023, pra për detyrime të prapambetura të pa raportuara më parë. Kjo evidenton pasaktësitë në raportimin e detyrimeve të prapambetura të mbartura nga vitet e kaluara dhe duke ndikuar në saktësinë e vlerësimit të gjendjes financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore³.

³ Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar me ligjin nr. 40/2023, parashikon llogaritjen e gjendjes financiare nga shpenzimet vjetore të miratuara te shpenzimet vjetore faktike, duke dhënë vlerësim më realist të situatës. Parashikohen katër nivele: (i) me probleme financiare - vonesa >30 ditë dhe detyrime të papaguara ≥15% të shpenzimeve faktike; (ii) në vështirësi financiare – vonesat vijojnë

Në nivel sistemi vendor, për vitin 2024, raporti i stokut të detyrimeve të prapambetura, ndaj totalit të të ardhurave të veta faktike rezultojnë të jetë rreth 7.3%. Krahasuar me një vit më parë, ky raport është zvogëluar me rreth 6.5%. Megjithatë, një pjesë e bashkive kanë një raport mjaft të lartë, mbi 100% të stokut të detyrimeve të vitit 2024 ndaj të ardhurave të veta, si Dibra (105%), Konispoli (110%), Rrogozhina (111%) dhe Peqini (128%). Kapaciteti fiskal mjaft i ulët i këtyre bashkive dhe menaxhimi jo i mirë i mbledhjes së të ardhurave dhe planifikimit të shpenzimeve ka krijuar këto problematika në stokun e detyrimeve. Bashkitë me përqindjen më të lartë të këtij raporti janë paraqitur në grafikun në vijim:



Burimi: Ministria e Financave

Shpenzime të tjera. Në zërin shpenzime të tjera, buxheti i vitit 2024 u parashikuar me 16 milionë lekë më pak krahasuar me një vit më parë dhe realizimi faktik në shumën 30,931 milionë lekë ose 349 milionë lekë nën parashikimin buxhetor. Tabela e mëposhtme paraqet raportimet e planit dhe faktit për zërat analitik të shpenzimeve të tjera:

në milionë lekë

	Fakti 2023	Buxheti fillestar 2024	Akti Normativ 1/2024	Akti Normativ 3/2024	Akti Normativ 5/2024	Fakti 2024	Diferenca fakt-plan 2024	Diferenca fakt 2024-2023
Shpenzime të tjera	30,948	30,450 ↓	30,450	30,329 ↓	31,281 ↑	30,931 ↓	-349	↔ -16
Pagesa e papunësisë	858	800	800	800	764 ↓	832 ↑	67	↔ -26
Ndihma Ekonomike dhe Paaftësia	25,686	26,250 ↑	26,250	26,129 ↓	24,944 ↓	26,841 ↑	1,891	↔ 1,154
Mbështetje financiare për shtresat në nevojë	1,098				2,167		-2,167	↔ -1,098
Kompensim për ish të përndjekurit politikë	3,306	1,200	1,200	1,200	1,200	1,059 ↓	-141	↔ -2,247
Bonusi i lindjeve		2,200	2,200	2,200	2,200	2,200	0	↔ 2,200

Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga KLSH

muajin pasues dhe detyrimet >25%; (iii) në vështirësi serioze financiare - borxhe afatgjata + detyrime të papaguara >80%; (iv) paaftësi paguese – dështim i planit të rehabilitimit dhe/ose borxhe + detyrime >130% të shpenzimeve vjetore faktike.

Zëri më përfaqësues i këtyre shpenzimeve paraqitet “ndihma ekonomike dhe paaftësia”, i realizuar në shumën 26,841 milionë lekë ose 1,891 milionë lekë më shumë se plani përfundimtar dhe 1,154 milionë lekë më shumë se realizimi i vitit të kaluar. Kjo rritje ka ardhur nga zgjerimi i fondit të mbështetjes financiare për shtresat në nevojë në fund të vitit financiar, akorduar me aktin normativ nr. 5 datë 19.12.2024.

Transferime kapitale. Transferimet kapitale përfshijnë pagesat e kryera për krijimin e kapitalit fillestar të shoqërive të krijuara, dhe rritjen e tyre. Në vitin 2024 transfertat kapitale paraqiten në vlerën 550 milionë lekë, me një ulje prej 216.48 milionë lekë krahasuar me 2023. Për këtë zë buxhetor nuk është parashikuar plan sipas tabelës 4 të aktit normativ nr. 5 datë 19.12.2024, duke mbivlerësuar raportimin e realizimit të zërave të shpenzimeve.


B.2. Shpenzimet kapitale

Në zërin e shpenzimeve kapitale, buxheti u ul me 3,620 milionë lekë krahasuar me faktin e një viti më parë. Gjithashtu, realizimi i vitit 2024 në shumën 115,433 milionë lekë rezultoi 16,787 milionë lekë nën planin buxhetor përfundimtar. Tabela e mëposhtme paraqet raportimet e planit dhe faktit për zërat analitik të shpenzimeve kapitale:

në milionë lekë

	Fakti 2023	Buxheti fillestar 2024	AN 1	AN 3	AN 5	Fakti 2024	Diferenca plan-fakt 2024	%	Diferenca 2024-2023	%
Shpenzime Kapitale	119,053	129,381	135,581 ↑	150,506 ↑	132,219 ↓	115,433 ↓	-16,787	87.30%	-3,620	96.96%
Financimi Brendshëm	88,489	77,351	87,551 ↑	100,476 ↑	93,389 ↓	88,903 ↓	-4,487	95.20%	414	100.47%
Investime nga të ardhurat e Arsimit të Lartë	602	1,000	1,000	1,000	1,000	832 ↓	-168	83.20%	230	138.21%
Tatimi mbi Fitimin	13,761	44,030	40,030	40,030	28,830 ↓	17,427 ↓	-11,403	60.45%	3,665	126.64%
Akcizat	16,201	7,000	7,000	9,000 ↑	9,000	8,271 ↓	-729	91.90%	-7,930	51.05%

Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga KLSH



Gjatë vitit 2024, vlera e planifikuar e investimeve publike është rritur nga ligji i buxhetit deri në aktin normativ nr.3. Ndërsa Akti Normativ nr. 5 datë 19.12.2024, ka kryer shkurtime në nivelin e investimeve duke reflektuar efektin e mosrealizimeve në nivel projekti. Pavarësisht rishikimeve realizimi i këtij treguesi paraqitet poshtë planit të rishikuar, ku konkretisht financimi i huaj është nënrealizuar me rreth 11,403 milionë lekë dhe financimi i brendshëm në shumën 4,487 milionë lekë.

Shpenzimet kapitale me financim të huaj janë realizuar në masën 60.4% kundrejt planit përfundimtar dhe me mosrealizim në vlerën 26,603 milionë lekë ose 39.58% e planit fillestar. Megjithatë, krahasuar me vitin 2023, është shënuar një rritje prej 3,666 milionë lekë ose 26.6% më shumë.

! Nisur nga fakti që në treguesit fiskalë të raportuar janë përfshirë në zërin e investimeve publike edhe realizimet e financuara nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, në shumën 1,537 milionë lekë, efekti i mosrealizimit paraqitet në shumën 18,323 milionë lekë, ose 13.8% të planit përfundimtar.

Nga auditimi konstatohet gjithashtu se, shpenzimet për investime kapitale nuk janë realizuar në mënyrë të njëtrajtshme përgjatë vitit buxhetor, duke arritur vlerën më të lartë të realizimit prej 51,660 milionë lekë, ose 45% të totalit në muajin dhjetor 2024. Pas paraqitjes së kërkesave në projekt buxhet, me ligjin nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, janë miratuar fonde sipas tabelës shoqëruese nr. 1, në shumën 922,800 mijë lekë më shumë se kërkesat e paraqitura për investimet kapitale me financim të brendshëm. Fondet për investime shtesë janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

në mijë lekë

Kodi ML		Shpenzime kapitale projekt buxhet	Shpenzime kapitale miratuar në ligj	Diferenca +/-
2	Kuvendi	48,000	115,000 ↑ ⇌	67,000
10	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	4,319,379	4,289,379 ↓ ⇌	(30,000)
29	Këshilli i Lartë Gjyqësor	250,000	383,000 ↑ ⇌	133,000
30	Gjykata Kushtetuese	24,000	35,000 ↑ ⇌	11,000
41	Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar	250,000	550,000 ↑ ⇌	300,000
63	Institucionet e sistemit të Drejtësisë	57,500	78,500 ↑ ⇌	21,000
76	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave	3,000	38,000 ↑ ⇌	35,000
87	Institucione të tjera Qeveritare	3,913,880	4,253,880 ↑ ⇌	340,000
89	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	1,000	18,000 ↑ ⇌	17,000
90	Komisioni i Prokurimit Publik	1,000	16,000 ↑ ⇌	15,000
95	Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit	2,000	15,800 ↑ ⇌	13,800
Totali i ndryshimeve Projekt Buxhet me Ligj				922,800

Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga KLSH

Pakësime janë konstatuar vetëm për Ministrinë e Financave, ndërkohë që shtesat paraqiten kryesisht në institucionet e Sistemit të Drejtësisë, buxhetin e Kuvendit dhe grupit 87 “Institucione të tjera qeveritare” për AKSHI-n, në programin “E-qeverisja”.

Me Aktin Normativ nr. 1 datë 21.02.2024, janë parashikuar shtesa në planin e investimeve publike në shumën 6,200 milionë lekë, nga të cilat shtesa në investimet me financim të brendshëm në shumën 10,200 milionë lekë dhe pakësime në investimet me financim të huaj në shumën 4,000 milionë lekë. Me këtë akt janë pasqyruar ndryshimet edhe në buxhetin vjetor të riorganizimit të ministrive të reja, duke u bazuar në fushat e përgjegjësisë funksionale dhe ndarjen institucionale

dhe buxhetore mes Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, në zbatim të VKM nr. 30 dhe VKM nr. 31 datë 17.01.2024. Ndryshimet më të mëdha në programet dhe institucionet përkatëse për investimet publike me financim të brendshëm dhe të huaj paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Në mijë lekë

Kodi	Emërtimi i Institucionit / Programit	Financim i Brendshëm	Financim i Huaj	Totali i Sh. Kapitale
6	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	9,830	-5,600	4,230
04520	Transporti rrugor	0	1,000	1,000
04540	Transporti Detar	9,830	-8,600	1,230
04550	Transporti Hekurudhor	0	1,000	1,000
06370	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	0	1,000	1,000
56	Fondi i Zhvillimit Shqiptar	400	1,600	2,000
06210	Programe Zhvillimi	400	1,600	2,000

Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga KLSH

Shtesat më të mëdha konstatohen vetëm një muaj pas detajimit fillestar të fondeve të investimeve në programin “Transporti Rrugor” në shumën 1,000 milionë lekë, në programin “Transporti Detar” në shumën 1,200 milionë lekë (së bashku me ndryshimin e burimit të financimit nga ai i jashtëm në të brendshëm për projektin e “Portit të ri tregtar - Porto Romano, Durrës” me vlerë të përgjithshme 9,000 milionë lekë), në programin e transportit hekurudhor në shumën 1,000 milionë lekë, në programin “Furnizimi me ujë dhe kanalizime” në shumën 1,000 milionë lekë dhe në programin “Programe zhvillimi” të FSHZH në shumën 2,000 milionë lekë. Në konkluzion, konstatohet se efektet e Aktit Normativ nr. 1, janë:

- ▶ kanë ndryshuar burimin e financimit për projektin madhor për “Portin e ri tregtar - Porto Romano, Durrës”, duke rritur njëkohësisht vlerën e financimit për vitin 2024 vetëm një muaj pas miratimit të ligjit dhe ende pa u kryer procesi i detajimit fillestar të investimeve;
- ▶ kanë rritur financimin e huaj në 3,000 milionë lekë për MIE, vetëm një muaj pas miratimit të buxhetit për projekte ekzistuese;
- ▶ kanë rritur financimin e huaj në 1,600 milionë lekë për FSHZH vetëm një muaj pas miratimit të buxhetit për projekte ekzistuese;
- ▶ kanë rritur financimin për investimet me financim të brendshëm për FSHZH në projektin e investimit M56009 “Projekte investimi” me 400 milionë lekë, pa një projekt specifik dhe në vijim është kryer shpërndarja e tij në projekte të reja/vazhdim.

Me aktin normativ nr. 3 datë 28.08.2024 janë ndryshuar fondet për investime kapitale në shumën 14,925 milionë lekë, nga 135,581 milionë lekë sipas aktit normativ nr. 1 datë 21.02.2024, në shumën 150,506 milionë lekë, duke ndryshuar fondet për:

- ▶ shtesë në investimet kapitale me financim të brendshëm në shumën 12,925 milionë lekë;
- ▶ shtesë për rindërtimin në shumën 2,000 milionë lekë;
- ▶ financimin e huaj me lëvizje ndërmjet programeve, konkretisht pakësimin e programit 4220

“Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit” në shumën 170 milionë lekë dhe programit 4250 “Zhvillimi Rural duke mbesht. Prodh. Bujq, Blek, Agroind dhe Market.” në shumën 400 milionë lekë të MBZHR dhe shtesën e programit 6210 “Programe zhvillimi” në shumën 570 milionë lekë për FSHZH.

Nga auditimi konstatohet se në MIE janë shtuar fondet për 6,750 milionë lekë në dy programe buxhetore, në FSHZH janë shtuar fondet buxhetore në shumën 5,000 milionë lekë për 3 programe buxhetore dhe në grupin 87 për institucione të tjera janë shtuar fonde për AKSHI-n në një program buxhetor në shumën 600.5 milionë lekë.

Me aktin normativ nr. 5 datë 19.12.2024 janë pakësuar fondet për investime kapitale me 18,286 milionë lekë, nga 150,506 milionë lekë sipas aktit normativ nr. 3 datë 28.08.2024, në 132,219 milionë lekë, duke ndryshuar fondet për:

- pakësim në investimet kapitale me financim të brendshëm në shumën 7,086 milionë lekë,
- pakësim në financimin e huaj në shumën 11,200 milionë lekë.

Megjithëse në muajin dhjetor 2024, me anë të Aktit Normativ nr. 5 datë 19.12.2024 janë shkurtuar fondet e investimeve me rreth 18,000 milionë lekë në krahasim me planin e përditësuar, konstatohet se ato nuk kanë reflektuar ecurinë e projekteve të cilat paraqiten me mosrealizim në fund të vitit buxhetor. Lista e institucioneve për të cilat kanë ndryshuar fondet për investimet kapitale në muajin dhjetor paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në mijë lekë

Kodi	Emërtimi i Institucionit / Programit	Shpenzimet Kapitale		
		Financim i Brendshëm	Financimi i Huaj	Totali i Shp. Kapitale
6	Presidenca	-222,490	-	-222,490
04520	Kuvendi	-51,200	-	-51,200
06370	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	-390,500	-1,268,691	-1,659,191
56	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	3,573,482	-1,746,162	1,827,320
06210	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	-436,000	42,000	-394,000
06220	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinise	-595,595	-355,000	-950,595
04230	Ministria e Kulturës	-1,070,228	-118,400	-1,188,628
87	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	-496,020	30,000	-466,020
01320	Ministria e Drejtësisë	-585,057	-110,000	-695,057
01140	Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme	211,000	-	211,000
6	Ministria e Brendshme	-622,800	-263,650	-886,450
04520	Ministria e Mbrojtjes	-1,456,700	-6,964,597	-8,421,297
06370	Drejtoria e Radio Televizionit	-77,000	-	-77,000
56	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	-436,347	-349,400	-785,747
06210	Këshilli i Lartë i Gjyqësor	-45,000	-	-45,000
06220	Gjykata Kushtetuese	-	1,500	1,500
04230	Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar	-282,000	-	-282,000
87	Instituti Statistikës	-57,000	10,000	-47,000
01320	Fondi i Zhvillimit Shqiptar	-4,040,000	-	-4,040,000
01140	Qendra Kombëtare e Kinematografisë	-	2,400	2,400
6	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	-72,000	-	-72,000
04520	Institucione të tjera Qeveritare	62,800	-110,000	-47,200
06370	Komisioni i Prokurimit Publik	4,300	-	4,300
56	Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit	-2,000	-	-2,000
06210	TOTALI	-7,086,355	-11,200,000	-18,286,355

Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga KLSH

Në të gjitha institucionet ka shkurtime në fondet në dispozicion për investime kapitale me përjashtim të MIE dhe MEPJ. Pakësimet më të mëdha paraqiten në MBZHR, MM, FSHZH etj.



Problematika të konstatuara në investimet publike me financim të brendshëm

Nga auditimi mbi listën e investimeve publike të detajuara për periudhën 2024-2026, pjesë e projekt ligjit “Për buxhetin e vitit 2024”, të paraqitur në Kuvend, u konstatua se ky dokument mbart pasaktësi në plotësimin e tij, si më poshtë:

-U konstatuan pasaktësi në vlerat e raportuara ndërmjet viteve ku vlera totale e projekteve nuk përputhet me vlerat sipas kolonave: financime deri në 2022, plani 2023, parashikimet 2024–2026 dhe “pas 2026”, ku totali rezulton 509,303.8 milionë lekë, ndërsa shuma e kolonave 487,316.8 milionë lekë, duke lënë të pambuluar 21,986.9 milionë lekë. Kjo pasaktësi përsëritet gjerësisht në programet buxhetore të ministrive të linjës.

-U konstatuan pasaktësi ndërmjet shumës totale të projekteve në nivel programi buxhetor dhe shumës aritmetike të projekteve analitike përkatëse, të përhapura gjerësisht në të gjitha programet. Dokumentacioni i paraqitur nuk është sipas parashikimeve të nenit 29 “Projektbuxheti vjetor”, të ligjit nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, referuar komponentëve të listës së investimeve publike për çdo program buxhetor.

-Në dokument është përfshirë kolona “Për tu paguar pas vitit 2026” e cila paraqitet në total në shumën 86,383.4 milionë lekë (megjithëse mbart pasaktësi në shumën aritmetike të vlerës analitike në nivel projekti sipas programit dhe ministrisë së linjës), ndërkohë që referuar kuadrit ligjor për buxhetin, shpërndarja e fondeve duhet të kryhet për tre vite buxhetore. Nga auditimi konstatohet se angazhimet e parashikuara në listën e investimeve publike, janë përtej taveve trevjeçare të propozuar për t’u miratuar me ligjin vjetor të buxhetit, për shkak të projekteve në vazhdim nga vitet e kaluara, si dhe projektet e reja të propozuara për tu financuar.



Problematika të konstatuara në miratimin e detajimit të shpenzimeve kapitale nga autoriteti përgjegjës.

Nga auditimi i shkresave të detajimit të fondeve buxhetore konstatohet se për shpenzimet operative miratimi i detajimit kryhet nga nëpunësi i parë autorizues, ndërkohë që për fondet e investimeve nga Ministri i Financave. Në nenin 43 të ligjit nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet që nëpunësi i parë autorizues miraton detajimin e fondeve buxhetore, të shpërndara për çdo njësi shpenzuese dhe është përgjegjës që kjo të reflektohet në kohë në sistemin e thesarit. Të drejtat dhe limitet të ministrit të financave në rishpërndarjen e fondeve përkundrejt fondeve të investimeve janë parashikuar vetëm në nenin 44 të ligjit “Rishpërndarja e fondeve buxhetore”. Sipas nenit 30 të këtij ligji, për rishpërndarjet e fondeve të projekteve të investimeve brenda të njëjtit program të njësisë së qeverisjes qendrore miratimi kryhet nga Ministri i Financave.

Nga auditimi mbi miratimin e listës unike së investimeve u konstatua se në VKM nr. 887 datë 27.12.2022 “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”, të ndryshuar është parashikuar që, projektet e reja të investimeve publike mbi kufijtë e vendosur me udhëzim nga ministri përgjegjës për financat, të klasifikohen si projekte investimi me rëndësi strategjike dhe si

rrjedhojë i nënshtrohen procesit të vlerësimit për përfshirjen e tyre në Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare. Këto projekte investimi përfshihen në PBA apo buxhetin vjetor në përputhje me hapësirën fiskale, vetëm pasi të jenë bërë pjesë e listës unike të projekteve me rëndësi kombëtare, të rankuar dhe të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave. Kjo listë, sipas pikës 5 të kësaj VKM-je miratohet jo më vonë se data 31 Janar dhe rishikohet jo më vonë se data 1 Korrik, nëse vlerësohet e nevojshme. Për vitin buxhetor 2024, rezultojnë se listat janë miratuar me VKM nr. 161 datë 20.03.2024 “Për miratimin e dokumentit të politikave prioritare 2025-2027” dhe VKM nr. 533 datë 12.08.2024 “Për një ndryshim në Vendimin nr. 161 datë 20.03.2024”. Për sa më sipër konstatohet se nga Këshilli i Ministrave nuk janë respektuar afatet për miratimin në kohë të Listës Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare.

Nga auditimi rezultojnë se, një pjesë e konsiderueshme e fondeve të disbursuara menjëherë pas miratimit të Aktit Normativ nr. 5 datë 19.12.2024, janë përdorur për të mbuluar detyrimet për projekte për të cilat nuk është detajuar në kohë plani buxhetor, si dhe për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura nga vitet e kaluara, duke lejuar rritjen e borxheve të reja të investimeve në 6-mujorin e parë.

Në 7 raste nga projektet e audituara, financimi i projekteve të investimit publik, nuk ka shkuar plotësisht për kontrata në vazhdim, duke qenë në kundërshtim me pikën 23 të Udhëzimit Standard të Zbatimit të Buxhetit nr. 9 datë 20.03.2018, i ndryshuar dhe udhëzimin nr.1 datë 24.01.2024 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024”. Për këto projekte, konstatohet se shpërndarja e financimit nuk ndjek përcaktimet e detajimit të buxhetit minimalisht 20% viti 1, 30% viti 2 dhe 30% viti 3, përgjatë zbatimit të tij, si dhe shlyerja e tyre është parashikuar të kryhet pas tre viteve buxhetore.

Konstatohet ulja e fondeve buxhetore me Akt Normativ, me efekt mbylljen e 11 projekteve për të cilat ndërkohë janë zhvilluar procedura e prokurimit gjatë periudhës shtator-dhjetor 2024 dhe që në shumicën e rasteve kanë rezultuar edhe me lidhje të kontratave, ka bllokuar mundësinë e regjistrimit të angazhimeve në sistemin informatik financiar të qeverisë.

Në 23 raste nga projektet e audituara, autoritetet kontraktore kanë iniciuar procedurat e prokurimit për një vlerë 42,465 milionë lekë, e cila është më e lartë se fondet në dispozicion sipas shpërndarjes 3-vjeçare të buxhetit të miratuar, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 50 të ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor.


Në 20 raste nga projektet e audituara, procedura e prokurimit/angazhimi është kryer përtej afatit ligjor 15 tetor të vitit buxhetor, si afati i fundit për ndërmarrjen e angazhimeve të reja në zbatim të nenit 51 të ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor.

Në 19 raste me vlerë totale prej 5,723 milionë lekë nga projektet e audituara është konstatuar lidhja e kontratave përtej fondeve në dispozicion, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 50 të ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor.

Në 25 raste nga projektet e audituara konstatohen çelje të projekteve të investimit publik me akte normative, të cilat nuk ka qenë pjesë e PBA-së 2024-2026 si dhe as pjesë e listës së investimeve publike të paraqitura me Projekt Buxhetin e vitit 2024. Kjo praktikë financimi të projekteve që nuk kanë ndjekur procesin e miratimit në fazat e planifikimit, zhvleftëson procesin planifikues afatmesëm buxhetor.



Në milionë lekë



Në 21 raste nga projektet e audituara, detajimi i fondeve është kryer për një periudhë 3-vjeçare ndërkohë që, kohëzgjatja e projektit sipas të dhënave të prokurimeve nga APP rezulton të jetë më pak se shpërndarja e fondeve (6 muaj, 1 vit apo 2 vjet).


Në 9 raste nga projektet e audituara, vlera e detajuar në ligjin fillestar për vitin 2024 është më e vogël se kosto e projektit e planifikuar në projekt buxhet, si dhe shpërndarja e shumave nuk është e njëjtë sipas viteve të fillimit dhe mbarimit.

Nga auditimi konstatohet se në përgjithësi është respektuar rregulli 20%, 30% dhe 30% i shpërndarjes së fondeve për 3 vite, por pas lidhjes së kontratës, fondet e investimeve janë shkurtuar në favor të projekteve të reja dhe duke mos respektuar këtë rregull në vijim. Megjithatë, në 12 raste është konstatuar se përfshirja në listën e investimeve publike në projekt buxhet dhe në detajim fillestar të fondeve nuk respekton shpërndarjen e buxhetit sipas viteve në masën 20%, 30% dhe 30% të koston totale të projektit, sipas përcaktimeve të VKM nr.887 datë 27.12.2022 “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”, i ndryshuar.

Detajimi i fondeve të investimeve në masën 20% të vlerës së projekteve me aktin normativ nr. 3 datë 28.08.2024, nëpërmjet pikës 4 të nenit 11 të ligjit nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, përbën risk për përdorim në kohë të këtyre fondeve, si pasojë e kohës së mbetur në dispozicion për realizimin e fondeve buxhetore deri në fund të vitit.

Në 11 raste nga projektet e audituara, detajimi i fondeve në fillim të vitit është kryer në masën 20% të vlerës së projektit, ndërkohë që pas lidhjes së kontratës, fondet janë pakësuar por më pas në muajin dhjetor këto fonde janë rritur përsëri.

Në milionë lekë



Për 245 projekte investimi, çeljet janë kryer për herë të parë në muajt shtator-dhjetor në shumën 14,774 milionë lekë. Vetëm në muajin dhjetor evidentohen 16 projekte investimi, në shumën 355 milionë të çelura për herë të parë me aktin normativ nr. 5 datë 19.12.2024, të cilat paraqesin një vlerë realizimi 345 milionë lekë. Gjithashtu, në një numër të konsiderueshëm projektsh, vlera e fondit të detajuar përputhet plotësisht me faturat e lëshuara.

Vetëm në muajin Dhjetor, janë mbyllur 323 projekte investimi të cilët janë çelur nga muaji janar-tetor, ndërkohë që konstatohen edhe projekte të cilat kanë qëndruar të hapura vetëm për 2-3 muaj, në 78 raste në shumën 6,673 milionë lekë. Gjithashtu, në muajin dhjetor evidentohen dhe 150 projekte me financim të brendshëm të cilat kanë vlerë realizimi 0 lekë, ndërkohë që nuk janë marrë masa për rishpërndarjen e fondeve të këtyre në projekteve pa realizime duke mbetur të papërdorura.

Nga auditimi janë konstatuar raste të klasifikimit të shpenzimeve operative në zërin e shpenzimeve për investime. Në Fondin Shqiptar të Zhvillimit, në programin buxhetor 6210 “Programe zhvillimi” raportohet si investim i realizuar kosto lokale e menaxhimit të projekteve të investimit në shumën 668 milionë lekë, me kod projekti M560322 “Projekti i rrugëve dytësore dhe lokale”, ndërkohë që këto fonde administrohen në llogari bankare të nivelit të dytë nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit për aktivitetin e shpenzimeve korrente të institucionit, për menaxhimin e

projekteve të investimit. Në programin 4250 “Zhvillimi rural” në AZHBR konstatohet se janë raportuar investime kapitale me kod projekt 18AL301 “Përfitues nga Programi IPARD II nga masa 1” në shumën 152 milionë lekë, kapitulli 3 “kosto lokale”. Këto pagesa kryhen në kuadër të bashkëfinancimit të fondeve të BE-së për mbështetjen e fermerëve/agroturizimit në kryerjen e investimeve nga ana e investorëve, pra për nga natyra, nuk kemi të bëjmë me investim kapital, por me grant të dhënë të tretëve. Në këtë mënyrë, treguesit e investimeve publike janë të mbivlerësuar për këto fonde të cilat përfshijnë shpenzimin e tyre në zëra të shpenzimeve operative dhe jo investime publike.

Nga auditimi i projekteve të investimeve me financim të brendshëm janë konstatuar 130 institucione të qeverisjes qendrore që kanë paguar detyrime të prapambetura në vlerën 8,385 milionë lekë, të cilat përfaqësojnë rreth 9.4% të investimeve kapitale me financim të brendshëm të realizuara për vitin 2024. Pagesa e këtyre detyrimeve të cilat janë raportuar si investime të vitit 2024, është në kundërshtim me pikën a, të nenit 61, të ligjit nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”. Si pasojë, treguesit e realizimit të investimeve publike për vitin 2024 rezultojnë të mbivlerësuar në këtë masë dhe kërkojnë rishikim e korrigjim përmes riklasifikimit të pagesave si shlyerje detyrimesh të prapambetura.

Nga Ministria e Financave është dhënë miratimi për 4 kontrata të Fondit Shqiptar të Zhvillimit për parapagime në vlerën 453.8 milionë lekë. Këto kontrata nuk paraqesin elementë për të qenë të një rëndësie të veçantë, si dhe nuk ka dokumentacion bashkëlidhur për të vërtetuar rëndësinë e veçantë të tyre, duke sjellë si pasojë financimin me fonde buxhetore të operatorëve ekonomikë privatë pa filluar punën për kryerjen e investimeve publike. Këto parapagime janë kryer në kundërshtim me pikën 160 dhe 161 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.



Nga auditimet në njësitë e qeverisjes së përgjithshme në lidhje me shpenzimet u konstatuan problematika në realizimin e tyre, si më poshtë:

- Parregullsi lidhur me hartimin e preventivave dhe përlogaritjen e fondit limit, pasi janë përfshirë në mënyrë jo të drejtë dhe të pa argumentuar zëra punimi dhe në disa raste vendosja e çmimeve të zërave të punimit, nuk është në përputhje me manualët e ndërtimit, duke rritur në mënyrë joreale fondin limit në shtatë njësi të vetëqeverisjes vendore dhe në dy njësi të qeverisjes qendrore,
- Mos përputhje mes afatit të lëvrimin të objektit që prokurohet në raport me natyrën e mallit, shërbimit apo punëve që prokurohen në dy njësi të vetëqeverisjes vendore, dhe në tre njësi të qeverisjes qendrore,
- Në hartimin e specifikimeve teknike nuk janë angazhuar anëtarët e komisioneve përkatëse sipas përcaktimeve ligjore në një njësi të vetëqeverisjes vendore dhe në një njësi të qeverisjes qendrore,
- Kërkesat për prokurim nuk argumentohen me disponibilitetin në inventar të mallrave që kërkojnë të prokurohen në një njësi të vetëqeverisjes vendore dhe në një njësi të qeverisjes qendrore,
- Janë parashikuar dhe kryer procedura me copëzim të fondit të prokurimit me vlerë të vogël,

- Janë konstatuar prokurime të drejtpërdrejta, pa dokumentacion të përllogaritjes së fondit limit në dy njësi të vetëqeverisjes vendore, dhe në tre njësi te qeverisjes qendrore,
- Grupi i punës i ngritur/miratur për specifikime teknike/vlerësimin të ofertave të procedurave të prokurimit/zbatimit të kontratës nuk ka në përbërje të tij specialist të fushës në dy njësi të vetëqeverisjes vendore , dhe në dy njësi te qeverisjes qendrore,
- Mangësi në kriteret e specifikimeve teknike të vendosura në procedurat e prokurimit, në disa raste jashtë objektit të kontratës dhe jo në përpjesëtim me volumnin dhe natyrën e punimeve, si dhe mos argumentim apo analizim i nevojës për numrin e punonjësve, apo numrin e makinerive të kërkuar në trembëdhjetë njësi të vetëqeverisjes vendore, dhe në pesë njësi te qeverisjes qendrore,
- Plani buxhetor i pa detajuar dhe pa analizë duke u anashkaluar procedurat e prokurimit publik, si dhe me mungesë të aktit të marrjes në dorëzim në dy njësi te qeverisjes qendrore,
- Mangësi në hartimin e raportit përmbledhës të prokurimit në pesë njësi te qeverisjes qendrore,
- Mangësi në verifikimin e dokumentacionit të prokurimit duke shpallur fitues operatorë ekonomik me mangësi në plotësimin e kriterëve të kualifikimit, si gjatë vlerësimit të vetëdeklarimeve, ashtu edhe gjatë verifikimit të dokumentacionit fizik të dorëzuar nga fituesit në katërmëdhjetë njësi të vetëqeverisjes vendore, dhe në gjashtë njësi te qeverisjes qendrore. Mangësitë kryesore konstatohen në disponimin e licencave përkatëse të kërkuara, mungesë dokumentacioni për makineritë e deklaruar, mos plotësim dokumentacioni në referencë të “Kritereve të Përgjithshme”,
- Vonesa në marrjen në dorëzim të mallrave apo mos kryerje e të gjitha shërbimeve të përcaktuara në kontratë në dy njësi të vetëqeverisjes vendore, dhe në tre njësi te qeverisjes qendrore,
- Duplikim i procedurave të blerjes për të njëjtin qëllim, referuar objektit të kontratës në një njësi te qeverisjes qendrore,
- Diferenca midis punimeve faktike dhe ato të raportuara në situacionin përfundimtar në pesëmbëdhjetë njësi të vetëqeverisjes vendore, në një njësi te qeverisjes qendrore,
- PAGESA të kryera pa konfirmimin e strukturave përkatëse autorizuese dhe në një njësi te qeverisjes qendrore,
- Mangësi në dokumentacionin justifikues për urdhër shërbimet, në rastet e shpenzimeve pritje përcjellje në dy njësi te qeverisjes qendrore,
- Janë lidhur kontrata me operatorë të huaj me TVSH duke ngarkuar me kosto shtesë buxhetin e shtetit në një njësi te qeverisjes qendrore.



Problematika të konstatuara në ekzekutimin e investimeve publike me financim të huaj

Në vitin 2024, planifikimi fillestar në raport me planin përfundimtar paraqet shkurtime në rreth 15,200 milionë lekë ose rreth 34% për investimet kapitale me financim të huaj.

Efekti më i madh në këtë ndryshim konstatohet se ka ardhur nga ndryshimi i burimit të financimit për projektin madhor për “Portin e ri tregtar - Porto Romano, Durrës” në rreth 8,900 milionë lekë, duke rritur njëkohësisht vlerën e financimit për vitin 2024 vetëm një muaj pas miratimit të ligjit

dhe ende pa u kryer procesi i detajimit fillestar të investimeve. Konstatohet se është kryer rishikim i buxhetit me akt normativ për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë vetëm një muaj pas miratimit të ligjit, për projekte të cilat janë në vazhdim duke ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme vlerën e financimit, nëpërmjet përdorimit të fondit të ngrirë në vlerë 106 milionë lekë, dhe ku vlera e projekteve të shtuara në total paraqitet 3,106 milionë lekë për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë. Gjithashtu me Aktin Normativ nr.5 të fund vitit në 19.12.2024, në Ministrinë e Mbrojtjes, programi “Forca e Luftimit”, janë pakësuar fondet buxhetore vetëm 12 ditë nga mbyllja e vitit buxhetor në vlerën 5,400 milionë lekë, me qëllim zbutjen e efektit të mosrealizimeve në treguesit e konsoliduar fiskalë.

Në fund të vitit 2024, për 4 projekte investimi me financim të huaj, konkretisht 4 grante në vlerën 19.2 milionë lekë, disbursimet janë regjistruar në vlerë negative. Regjistrimi i disbursimeve në vlerë negative nuk ka logjikë ekonomike, deri sa kemi të bëjmë me të ardhura, si dhe ul vlerën totale të disbursimeve, me një efekt prej 17,744.28 milionë lekë, kjo jo në përputhje me pikën 6.3 të Udhëzimit të MFE nr. 35, datë 21.09.2020.

Për 123 projekte në shumën 326.91 milionë lekë nuk rezulton të ketë plan buxhetor për realizimin e tyre edhe pas ndryshimit me AN nr. 5, datë 19.12.2024. Realizimi i projekteve të investimeve me financim të huaj pa pasur plan buxheti apo në tejkalim të planit buxhetor të miratuar, si dhe mos marrja e masave për sistemin e tyre nëpërmjet rialokimeve gjatë vitit apo gjatë procesit të rishikimit të buxhetit është në kundërshtim me pikën 28 të Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave nr. 1, datë 24.01.2024 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024”.

Në 126 projekte në vlerën 1,007.66 milionë lekë, konstatohet realizim në tejkalim të planit të buxhetit të miratuar. Janë raportuar si investime kapitale fonde të cilat janë përdorur për paga, sigurime shoqërore, shëndetësore dhe operative të tjera në shumën 513.79 milionë lekë nga grantet dhe 62.28 milionë lekë nga kreditë.

Nga auditimi rezulton se investimet me financim të huaj kanë arritur në vlerën 17,725.07 milionë lekë, nga të cilat disbursimet në formë granti në vlerën 4,757.29 milionë lekë, ndërsa disbursimet në formë kredie, janë regjistruar në vlerën 12,968 milionë lekë.

Nga auditimi rezultoi se për investimet me financim të huaj ka mospërputhje midis regjistrimeve të strukturës së borxhit dhe Thesarit. Edhe pse është kryer akt-rakordim nëpërmjet dy strukturave, rakordimi është bërë në monedhë origjinale dhe jo në monedhë kombëtare, duke krijuar diferenca në treguesit fiskalë të raportuar. Gjithashtu, diferenca në raportim konsiston edhe në përfshirjen e komisioneve të disbursimit nga struktura përgjegjëse e borxhit, ndërsa Thesari raporton neto pa komisione disbursimi. Konstatohet se disbursimet në formë kredie së bashku me komisionet e disbursimit raportohen në shumën 13,016 milionë lekë sipas borxhit dhe 12,968 milionë lekë sipas thesarit, me një diferencë në shumën 48 milionë lekë, e cila sipas shpjegimeve konsiston në diferencat e kursit të këmbimit nga raportimi i njësive të zbatimit të projektit në thesar ndërkohë që në sistemin e borxhit pasqyrohen të regjistruara me kursin e datës në të cilin ka ndodhur disbursimi.

Nga auditimi mbi raportimin e të dhënave të projekteve me financim të huaj, nga Njësitë e Zbatimit të Projekteve (NJZP) në Ministrinë e Financave, për vitin 2024, u konstatuan 40 raste që institucionet nuk kanë bërë raportim, për të cilat nga ana e Ministrisë së Financave, është tërhequr

vëmendja, por nuk është vijuar me masa administrative drejt këtyre njësive, në kundërshtim me pikën 7.3 të Udhëzimit nr. 35 datë 21.09.2020 dhe pikën 10.2 të udhëzimit nr. 10 datë 12.07.2024.

Sa i takon monitorimit të kontratave me financim të huaj, KLSH ka audituar Drejtorinë e Përgjithshme të Financimeve dhe Kontratave për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorë të tjerë, në Ministrinë e Financave, misioni i të cilës është të sigurojë një menaxhim efektiv administrativ, financiar dhe teknik të projekteve të miratuara, në përputhje me Marrëveshjet Financiare me Komisionin Evropian e donatorë të tjerë. Nga auditimi janë konstatuar problematikat si me poshtë:

- Nga ana e CFCU nuk janë identifikuar dhe raportuar kontratat objektivat e të cilëve kanë pësuar ndryshime apo kanë patur nevojë për ndryshime në varësi të ecurisë së tyre; nuk rezulton të jetë kryer një analizë / apo vlerësim mbi impaktin në outputin final, se si është arritur ai, në zbatim dhe reflektim të ndryshimeve të ndodhura krahasuar me zërat e parashikuar.
- Nga auditimi i projektit të “Zhvillimit të kontabilitetit në Sektorin Publik”, me përfitues Ministrinë e Financave, ka filluar procedurën e prokurimit në 17.05.2018 parashikuar të përfundojë në 30.06.2020 dhe për të cilin janë lidhur gjithsej 5 kontrata implementimi i të cilave ka përfunduar në dhjetor 2022, rezulton se ende nuk ka një produkt final për zbatimin në praktik të Standardeve të Kontabilitetit në Sektorin Publik.
- Në projektet e binjakëzimit janë identifikuar parregullsi në respektimin e afateve procedurale, si p.sh. përcaktimi i kohës më të shkurtër se sa parashikon manuali për përgatitjen e propozimeve dhe zhvillimi me vonesë i mbledhjeve të komisioneve të përzgjedhjes, e cila cënon korrektësinë e procedurave.
- Kontrollët “on the spot” për fondet e huaja nuk janë kryer plotësisht sipas planifikimit, shpesh janë zhvilluar me vonesa, pa dokumentacion të plotë mbështetës, duke mos garantuar kontroll të plotë dhe efektiv mbi kontratat e granteve dhe shërbimeve.
- Procesi i miratimit të raporteve narrative për grantet është kryer me mungesa dokumentacioni dhe vonesa në procedura, çka ka sjellë shtyrje të pagesave përtej afateve të parashikuara dhe mosrealizim të fondeve sipas planifikimit.
- Mos realizim të fondeve të TVSH-së për vitin sipas së cilit janë buxhetuar, për rastet kur këto pagesa nuk realizohen sipas planifikimit të duhur, duke mos mundësuar rialokimin në kohë të tyre për investime me ecuri më të mirë.

Nga auditimet në lidhje me projektet me financim të huaj, janë konstatuar problematikat, të cilat përfshijnë:

Nga auditimi i projektit *“Ndërtimi i qendrës rajonale të menaxhimit të integruar të mbetjeve në Sherishtë të Vlorës”*, u konstatua vonesë e zbatimit të projektit dhe shtyrje e afatit të disbursimit deri më 30.12.2024, si pasojë e mosrishikimit në kohë të projektit, vonesa në lejen e ndërtimit, planifikim jo realist i afateve të prokurimit dhe vonesa në ekzekutim. Këto parregullsi kanë gjeneruar kosto shtesë dhe efekte financiare negative: tarifa e zotimit financiar u rrit nga 68,070 euro në 108,293 euro dhe kontrata e konsulencës/mbikëqyrjes u shtua rreth 38% (nga 1,395,940 në 1,930,000 euro), duke vonuar ofrimin e shërbimit publik, pamundësuar mbylljen e vend-depozitimeve ekzistuese dhe amplifikuar risqet mjedisore e të shëndetit publik. Gjatë zbatimit u miratuan 8 ndryshime kontrate duke e çuar vlerën e kontratës në 3,004,143 euro, pa u shoqëruar me shtesë të “Garancisë së performancës” në masën 10% të kësaj shtese. U konstatuan pagesa


para-financimi për pajisje, kryerje e pagesave të ndërmjetme nën pragun 5% dhe para-financime pa mbështetje kontraktuale, si dhe u evidentuan mangësi në realizimin e punimeve në përputhje me specifikimet kontraktuale.

Nga auditimi i projektit *“INFRASTRUKTURA BASHKIAKE V” – AKUK*, u evidentua mospërputhje e afateve financiare me kohëzgjatjen kontraktuale, duke ekspozuar 1.5 muaj pa mbulim financiar dhe duke cenuar afatin përfundimtar të përcaktuar në Marrëveshjen e Veçantë. Deri më 31.12.2024 është paguar tarifë angazhimi 453,824 euro, si kosto e shtuar nga ecuria e ngadaltë dhe mosdisbursimi në kohë sipas grafikut. Po ashtu, përmes Shtesës së Kontratës është miratuar rritje për Komponentin A/B (Elbasan) dhe Komponentin A (Kamëz) ndonëse Faza 1 ishte mbyllur dhe/ose anuluar, me pagesa jashtë strukturës financuese të Fazës 2. U konstatuan gjithashtu vonesa dhe mangësi në procedurat e përzgjedhjes së konsulentëve të angazhuar, si dhe mospërputhje në realizimin e objektivave me specifikimet kontraktuale.

B.2.1 Fondi i rindërtimit

Nga auditimi i të dhënave nga SIFQ, rezulton se fondi i rindërtimit është realizuar në shumën 8,271 milionë lekë, nga të cilat, shpenzimet për qeverisjen qendrore janë realizuar në shumën 542.6 milionë lekë për shpenzime kapitale, ndërsa shpenzimet e qeverisjes vendore janë realizuar në shumën 7,728.8 milionë lekë nga të cilat 5,478.3 milionë lekë për shpenzime kapitale dhe 2,250.5 milionë lekë për shpenzime operative dhe transfertat te të tretët.

Në milionë lekë



Nga auditimi konstatohet se raportimi në zërin e shpenzimeve kapitale në tabelën e treguesve fiskalë si nën komponent i investimeve kapitale të fondit të rindërtimit, denatyrton vlerat e raportuara për investimet kapitale pasi konstatohen të paktën 2,250.5 milionë lekë shpenzime korrente të raportuara në nënzëra të shpenzimeve kapitale.

Fondet për rindërtimin për vitin 2024 janë përcaktuar në tabelën shoqëruese nr.5 të shpenzimeve, në shumën 7,000 milionë lekë, pa e destinuar në mënyrë specifike

pjesën që i atribuohet njërive të vetëqeverisjes vendore. Kjo nuk rezulton të jetë reflektuar në tabelën nr.3 *“Transferta e pakushtëzuar për bashkitë 2024”* edhe pas ndryshimeve të buxhetit me Akte Normative. Sipas të dhënave të marra nga SIFQ dhe nga Drejtoria e Financave Vendore konstatohet se Fondi i Rindërtimit që i atribuohet Njësive të Vetëqeverisjes Vendore përfshin një plan përfundimtar në shumën 13,639 milionë lekë dhe një realizim në shumën 7,729 milionë lekë. Në raportimin e këtij zëri konstatohet mospërputhje pasi, sipas nenit 7 të ligjit 99/2023 “Për

buxhetin e vitit 2024”, i ndryshuar, plani buxhetor është parashikuar në zërin e shpenzimeve të buxhetit vendor (formë e transfertës së pakushtëzuar), ndërsa realizimi është raportuar në zërin e Fondit të Rindërtimit sipas tabelës nr.4 të të njëjtit ligj.

Plani përfundimtar vjetor në shumën 13,639 milionë lekë nuk përputhet me planin buxhetor përfundimtar prej 9,000 milionë lekë parashikuar në Aktin Normativ nr.5. Kjo vjen si pasojë e fondeve të trashëguara nga vitet e mëparshme buxhetore, të cilat nuk reflektohen në treguesit fiskalë. Rezulton se gjatë vitit 2024, bashkive u janë shtuar fonde në shumën 8,194 milionë lekë në formën e transfertave të pakushtëzuara për Fondin e Rindërtimit.

Gjithashtu, nga auditimi konstatohet se shpenzimi dhe raportimi i fondeve të rindërtimit është kryer në llogari të ndryshme për natyrë të njëjtë të fondeve të alokuara. Kjo është konstatuar në Bashkinë Krujë, Bashkinë Kavajë dhe Bashkinë Mirditë, ku janë kryer veprime nëpërmjet llogarisë 606 “transferta drejt individëve” për rindërtimin e banesave.

Konstatohet se, në vlerën e raportuar në tabelën e treguesve fiskalë janë përfshirë edhe shpenzimet për rindërtimin që janë realizuar nga të ardhurat e veta të institucioneve në vlerën 36.5 milionë lekë, duke e bërë të pasaktë raportimin sipas klasifikimin ekonomik dhe burimit të financimit.

Rezulton se, për projektet e rindërtimit është përdorur i njëjti kod projekti/prodakti për disa investime të ndryshme, duke mos identifikuar specifikisht investimet e kryera për çdo projekt/prodakt. Kjo sjell vështirësi në ndjekjen, monitorimin dhe auditimin e ecursisë së tyre si dhe raportimin mbi krahasueshmërinë ndër vite të treguesve.

Konstatohet se në ligjin nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, i ndryshuar, fondet për rindërtimin janë planifikuar në shumën 9,000 milionë lekë për vitin 2024, për vitin 2025 është 2,000 milionë lekë dhe për vitin 2026 është 0 lekë. Referuar të dhënave të vendosura në dispozicion nga Drejtoria e Buxhetit konstatohet se kosto totale e fondeve të shpërndara sipas VKM-ve të miratuara nga 2020-2024 paraqitet në shumën 122,794 milionë lekë progresivisht për të gjitha VKM-të e procesit, ndërkohë që realizimi faktik për të njëjtën periudhë paraqitet në shumën 100,030 milionë lekë, duke rezultuar në një diferencë progresive në shumën 22,764 milionë lekë. Diferenca prej 22,764 milionë lekësh evidenton se angazhimet e miratuara nuk janë reflektuar plotësisht në tabelat dhe tavanet shumëvjeçare. Pra, rezulton se kosto totale e projekteve të deritanishme të miratuar me VKM nuk është shoqëruar me ndryshimet përkatëse dhe paraqitje të drejtë të vlerës së planifikuar në vitet vijuese të këtij programi në ligjin e buxhetit, duke rritur riskun për mbulimin financiar në vijimësi të programit të rindërtimit.


Në vijim të mos planifikimit të fondeve të nevojshme në tabelën e treguesve fiskalë të konsoliduar në buxhetin e vitit 2024 dhe për vitet në vijim konstatohet se nuk janë respektuar përcaktimet e bëra në nenin 7 të ligjin 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, ku parashikohet se fondi i rindërtimit për përballimin e pasojave të tërmetit të vitit 2019 prej 9,000 milionë lekësh përdoret për të përballuar kostot për projektet e miratuara dhe të pa financuara të viteve të mëparshme dhe pjesa e mbetur për projekte të reja. Gjatë vitit 2024 jo vetëm që nuk janë financuar të plota projektet në vazhdim por janë miratuar VKM për projekte të reja pa ndjekur prioritetin e ecursisë së projekteve. Në 11 raste, këto VKM për projekte të reja në vlerën 1,493 milionë lekë janë miratuar vetëm pak ditë para mbylljes së vitit buxhetor, duke e bërë të pamundur përdorimin e këtij fondi.

Transferta për Llogarinë e Fondit të Pensioneve

Nga auditimi u konstatua se me Aktin Normativ nr. 5, datë 19.12.2024, është planifikuar zëri “Transfertë për Llogarinë e Fondit të Pensioneve në BSH” në shumën 6,300 milionë lekë, i cili është kontabilizuar në SIFQ si shpenzim në llogarinë 604 “Transferime”, me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 7, datë 20.01.2025. Ky kalim mjetesh nga llogaria e unifikuar e Thesarit në llogarinë e mbështetjes për pensionistët në Bankën e Shqipërisë nuk ka sjellë pakësim të pasurisë neto dhe, rrjedhimisht, nuk ka plotësuar përkufizimin e “shpenzimit buxhetor” sipas nenit 3, pika 17, dhe nenit 61 të ligjit nr. 9936/2008 të ndryshuar, si dhe rregullave për kontabilitetin dhe raportimin të Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, të ndryshuar dhe pikës 265 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.

B.3. Fondi rezervë dhe kontigjenca

Fondi rezervë përdoret për rastet e financimit të shpenzimeve të cilat janë të pamundura të parashikohen gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit. Për vitin 2024, Fondi Rezervë është parashikuar në shumën 3,770 milionë lekë nga të cilat 520 milionë lekë fondi për diferencat e pagës së magjistratëve sipas aktit normativ nr. 5 datë 19.12.2024. Në tabelën e treguesve fiskalë të konsoliduar realizimi i Fondit Rezervë është raportuar i shpërndarë në zërat sipas destinacionit ku ai është përdor, pavarësisht se në planifikim qëndron si një zë më vete.



Fondi rezervë sipas planit të rishikuar në shumën 3,250 milionë lekë, është përdorur në shumën 2,426.7 milionë lekë ose 74.7%, nëpërmjet 13 Vendimeve të Këshillit të Ministrave, me destinacion: rreth 1,537 milionë lekë ose 63% e planit për shpenzime kapitale, rreth 877.9 milionë lekë ose 36% e planit për shpenzime operative dhe transfera të brendshme dhe rreth 11.6 milionë lekë ose 1% e planit, janë akorduar për shpenzime personeli.

Nga auditimi u konstatua se është miratuar përdorimi i fondit rezervë të buxhetit të

shtetit për shpenzime që nuk plotësojnë kriterin e paparashikueshmërisë së tij gjatë përgatitjes/rishikimit të buxhetit dhe në mungesë të plotësimit të kriterëve të nenit 45 të ligjit nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Në disa raste, sikurse është evidentuar edhe në komentet e Ministrisë së Financave, në kërkesat për përdorim këto aktivitete nuk kanë qenë pjesë e planifikimit fillestar nga institucioni kërkuar dhe këto fonde nuk kanë ndjekur alternativën e miratimit të fondeve shtesë apo të rishikimit buxhetor. Konkretisht, janë shpërndarë:

- ▶ 1,504 milionë lekë për Ministrinë e Mbrojtjes, miratuar me VKM-së nr. 300, datë 17.05.2024. Në relacionin shoqëruar është përcaktuar që, qëllimi i tij është rritja e buxhetit për

modernizimin e Forcave të Armatosura dhe përmbushja e angazhimit për të akorduar 2% të PBB në sektorin e mbrojtjes, angazhim që nuk ishte përmbushur shkak të veprimeve korigjuese në vijim të vlerësimeve të ndryshme të PBB-së nga institucionet ndërkombëtare.

- ▶ 56 milionë lekë të miratuara me VKM nr. 861, datë 26.12.2024 “Për një shtesë fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2024 për Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit”, bazuar në kërkesën nr. 3645/5 datë 23.09.2024 të Ministrisë së Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit. Kërkesa ka përfshirë shqyrtimin dhe miratimin projekt- aktit dhe relacionit shpjegues, duke siguruar shtesën e fondit për financimin e konkursit të projektimit dhe të projekt idesë përfundimtare për “Expo Albania”, nga të cilat 23.5 milionë lekë për shpenzime korrente dhe 33.2 milionë lekë për investime.
- ▶ 12.2 milionë lekë për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare miratuar me VKM nr. 635, datë 10.10.2024 “Për një shtesë fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2024 për drejtorinë e shërbimeve qeveritare, për përballimin e shpenzimeve të organizimit të konferencës shkencore ndërkombëtare “Nanobalkan 2024””. Kërkesa për fonde nga Drejtoria e Shërbimeve qeveritare me shkresë nr. 1481/5 datë 08.10.2024 drejtuar Ministrisë së Financave, është iniciuar në bazë të kërkesës së Akademisë së Shkencave drejtuar DSHQ me nr. 181/3 datë 18.04.2024 dhe 181/5 datë 11.06.2024, për organizimin e konferencës në ambientet e Pallatit të Kongreseve dhe Pallatit të Brigadave.
- ▶ 17.7 milionë lekë me VKM nr. 324, date 29.05.2024 “Për miratimin e kalendarit të integruar të veprimtarive në kuadër të vitit mbarëkombëtar të 80-Vjetorit të Çlirimit”, ku sipas pikës 2, Ministrisë së Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit i shtohen fonde në programin “Arti dhe Kultura”, në llogarinë 604.
- ▶ 48.1 milionë lekë me VKM nr. 531, date 1.08.2024 "Për një shtesë fondi në Buxhetin e vitit 2024, miratuar për Ministrinë e Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit për sezonin turistik 2024", në vijim të kërkesës me nr. 9873 datë 31.07.2024.
- ▶ 36 milionë lekë janë akorduar për Ministrinë e Drejtësisë me VKM nr. 615, datë 2.10.2024 “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2024, miratuar për Ministrinë e Drejtësisë, për pagesën e tarifës për konsulencën e ofruar nga subjekti ndërkombëtar Boston Consulting Group (BCG) për ofrimin e shërbimit të konsulencës, për identifikimin e mekanizmave eficientë për të nxitur më tej luftën kundër korrupsionit dhe mundësinë e përdorimit të inteligjencës artificiale (IA) për këtë qëllim, si dhe për pagesën e tarifës për konsulencën e ofruar nga subjekti ndërkombëtar G37 chambers, për ofrimin e shërbimit të konsulencës për analizimin dhe vlerësimin e të dhënave që duhet të mblidhen nga Ministria e Drejtësisë, me qëllim vlerësimin e fushave të rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit dhe për hartimin e metodologjisë për mënyrën e vlerësimit e të ndjekjes në vazhdimësi të zbatimit të këtyre rekomandimeve”, nga të cilat 30 milionë lekë për subjektin Boston Consulting Group dhe 6 milionë lekë për këstin e parë të tarifës për konsulencën e ofruar nga subjekti G37 Chambers.

Përdorimi i fondeve të kontigjencës në vitin 2024, për financimin e shpenzimeve buxhetore konstatohet se nuk ndjek ciklin e planifikimit të rregullt të shpenzimeve buxhetore nëpërmjet tabelave dhe parimeve të ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë. Në të njëjtën kohë, përdorimi i kontigjencës në këtë masë nuk përputhet me qëllimin e krijimit dhe përdorimit të saj, që sipas kuadrit rregullator në fuqi lidhet me efektet e rasteve të mosrealizimit të të ardhurave apo efektet e paparashikuara të normave të interesit.



Mbi respektimin e nivelit të rezervës dhe kontigjencës ndaj totalit të shpenzimeve në planifikim buxhetor

Sipas ligjit organik të buxhetit përcaktohet që “Fond kontigjence” është fondi i pashpërndarë në zëra/projekte konkrete, që krijohet për të mbuluar risqet e mundshme, për të ardhurat dhe shpenzimet, gjatë zbatimit të buxhetit. Në vijim, përcaktohet që në çdo vit buxhetor të planifikuar duhet të përfshihet një kontigjencë e veçantë, prej jo më pak se 0.7% e shpenzimeve totale të buxhetit, për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit ose normat e interesit, me ndikim në nivelin e borxhit. Gjithashtu, Buxheti i Shtetit përfshin një fond rezervë dhe një fond kontigjence, i cili miratohet nga Kuvendi në ligjin të buxhetit vjetor, deri në masën 3% të vlerës totale të fondeve të miratuara. Në planifikim fillestar, sipas tabelës 5 të ligjit nr. 97/2023 konstatohet se nuk janë respektuar kufijtë e nivelit 3% për fondet rezervë dhe të kontigjencës, pasi në llogaritje nuk është përfshirë kontigjenca për risqet e borxhit.

Nga auditimi konstatohet se sipas planit përfundimtar të buxhetit, shuma e fondit rezervë dhe i kontigjencës, i parashikuar në aktin normativ nr. 5 datë 19.12.2024 “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar, nuk respekton kufirin prej 3% të totalit të shpenzimeve buxhetore të planifikuara pasi kalon vlerën prej 23,140 milionë lekë (3% të 771,348 milionë lekë). Sipas tabelës 5 shoqëruese të ligjit të buxhetit kjo shumë raportohet në total 26,337 milionë lekë (pa efektin e kontigjencës për risqet e borxhit).

B.4. Mbi Risqet fiskale dhe Impaktin buxhetor

Risqet fiskale janë faktorë që mund të shkaktojnë devijim nga parashikimet fiskale dhe buxhetore gjatë ciklit të buxhetit, si pasojë e ngjarjeve të paparashikuara dhe zhvillimeve makroekonomike, vendimeve mbi politikat fiskale dhe materializimit të detyrimeve kontingjente. Për vitin 2024, sipas Ministrisë së Financave është vijuar me monitorimin e risqeve kryesore buxhetore që kanë të bëjnë me performancën e ndërmarrjeve shtetërore kryesore të cilat ndikojnë financat publike dhe buxhetin e shtetit; shpenzimeve për kontratat koncesionare dhe të partneritetit publik privat (PPP) me mbështetje buxhetore; detyrimet e prapambetura të qeverisjes së përgjithshme dhe detyrime të tjera kontingjente për çështjet gjyqësore ndërkombëtare.

Ministria e Financave, me shkresën nr. 17308 prot., datë 17.12.2024, ka përcjellë për informim në Këshillin e Ministrave dokumentin “*Deklarata e Risqeve Fiskale për vitin 2023*”. Kjo deklaratë është orientuar kryesisht pas faktit, duke analizuar risqe tashmë të materializuara, çka e kufizon funksionin parandalues të instrumentit dhe rolin e tij proaktiv për identifikimin, vlerësimin dhe zbutjen e të ekspozimeve fiskale. Kështu, procesi aktual i vlerësimit të risqeve fiskale rezulton i kufizuar në mbulim dhe në qasje (me orientim retrospektiv), dhe nuk garanton efektshmëri të plotë në përmbushjen e rolit të tij si instrument proaktiv për parandalimin ose minimizimin e ndikimeve të mundshme mbi buxhetin e shtetit.

Mbi Entet publike me kapital shtetëror

Reforma e **sektorit të energjisë** ka pasur si synim të saj përmirësimin e cilësisë së furnizimit me energji elektrike dhe arritjen e qëndrueshmërisë financiare të sektorit. Qëndrueshmëria financiare e sistemit energjistik në Shqipëri varet nga shumë faktorë, ku ndër të tjera qarkullimi i likuiditeteve

ndërmjet shoqërive OSHEE, KESH, OST si dhe kryerja në kohë e pagesave të përdoruesve fundorë, privatë apo publikë është thelbësore.

Nga auditimet në ndërmarrjet e sektorit energjetik rezultoi se moskorrektësia e pagesave ndërmjet shoqërive në sistem ka sjellë vështirësi në shlyerjen e furnitorëve, akumulimin e penaliteteve e shoqëruar me faturat përkatëse, duke sjellë rritje të detyrimeve, mosmarrëveshje mes palëve dhe mungesë dakordësie për detyrimet e ndërsjellta. Detyrimet e prapambetura për energji elektrike nga njësitë e tjera publike, veçanërisht ndërmarrjet e ujit, mbeten problem për shkak të mekanizmit të dobët të ekzekutimit të pagesave. Për rrjedhojë, procesi i reduktimit të detyrimeve të prapambetura dhe parashikueshmëria e të ardhurave janë penguar, duke krijuar vështirësi për likuiditetin dhe planet e investimit. Marrja e masave për të ndaluar akumulimin e borxheve të reja është një parakusht i rëndësishëm për reduktimin e përgjithshëm të detyrimeve të prapambetura në sektor.

Nga auditimet u konstatua se nuk ka përfunduar ende procesi i rakordimit të detyrimeve të ndërsjella ndërmjet sektorit energjetik dhe enteve të tjera publike (KESH, OST, OSHEE, MF DPT). Në raportin “Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatën makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2024”, këto detyrime paraqiten në vlerën 171.24 miliardë lekë. Për periudhën objekt auditimi konstatohet se sektori i energjisë ka përfutur mbështetje buxhetore në vlerën 6,045 milionë lekë, me një rritje prej 762 milionë lekë krahasuar me vitin 2023. Për sa më sipër, Ministria e Financave dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nuk kanë arritur përmbushjen dhe zbatimin e Urdhrit të përbashkët nr. 304, datë 17.12.2020 “Për miratimin e planit të veprimit për uljen e detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike” dhe Urdhrit nr. 379, datë 30.09.2021 “Për zbatimin e planit të masave për uljen e detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike”, pasi konstatohet një nivel i lartë i detyrimeve të ndërsjella, ende të pa rakorduara dhe me një përmirësim minimal nga rreth 180 miliardë lekë, referuar konstatimeve në auditimet e mëparshme të KLSH.



Problematika në menaxhimin e sektorit të energjisë me impakt në performancën financiare

Nga verifikimi i planifikimit operacional për vitin 2024 u konstatua se, në agjencitë/ njësitë me humbje më të larta (p.sh. Tirana 1; Shkodër 5 dhe Shkodër 6; Njësia Krujë dhe Shijak), nuk janë nxjerrë urdhra pune të dedikuara dhe nuk janë kërkuar “matje specifike” nga OSSH Qendrore për analizë. Kjo qasje pasive ka kufizuar parandalimin/uljen e humbjeve jo-teknike dhe ka ndikim negativ në performancën operationale e financiare të shoqërisë.

Nga verifikimi i humbjeve të energjisë për Janar–Dhjetor 2024 u konstatua diferenca midis humbjeve totale në rrjet dhe rasteve të konstatuara me “ndërhyrje të paautorizuar” në të tre rajonet: në OSSH Tiranë humbjet ishin 11.18% ndaj total energjisë që OSSH Tiranë ka futur në rrjet; në OSSH Shkodër 32.30% dhe në OSSH Durrës 17.56%.

Nga verifikimi i aplikimeve për lidhje të reja/modifikime, për vitin 2024 u konstatua mosrespektim i afateve dhe vonesa të theksuara në të tre rajonet: në OSSH Tiranë u paraqitën 17564 aplikime, prej të cilave 12096 mbetën “ende në proces të pa lidhura me tension”, 4377 u kryen jashtë afatit, 5124 u bllokuan në fazën e vendosjes së sistemit matës dhe 4924 u “administruan me vonesë”; në OSSH Shkodër 4584 aplikime, prej të cilave 3154 “ende në proces të pa lidhura me tension”,

1181 jashtë afatit, 1121 të mbetura në fazën e matësit dhe 1373 “administruar me vonesë” ; në OSSH Durrës 6064 aplikime, prej të cilave 3711 “ende në proces të pa lidhura me tension”, 2005 jashtë afatit, 1311 të mbetura në fazën e matësit dhe 2029 “administruar me vonesë”.

U konstatua mosrespektim i përsëritur i afatit 3-mujor dhe i rregullave të faturimit sipas Metodologjisë së Vlerave Referuese për anomalitë “01” (matësi nuk u gjend) dhe “51” (matësi i dëmtuar). Në Tiranë u raportuan 206 raste “01” dhe 661 raste “51”; në Shkodër 243 raste “01” dhe 856 raste “51”; në Durrës 258 raste “01” dhe 1050 raste “51”. Gjithashtu u evidentua raportim i gabuar nga lexuesit në shkallë të gjerë në 478 raste. Nga auditimi në njësitë rajonale të OSSH u konstatua dëm ekonomik si rezultat i mosarkëtimit të energjisë elektrike të faturuar dhe për raste me ndërhyrje të paligjshme.

Nga auditimi në njësitë e OSSH u konstatua se: në OSSH Tiranë dhe OSSH Shkodër rezultojnë aktive të cilësuar si “të paidentifikuara” gjatë inventarizimit fizik: për Tiranën në vlerën 939 milionë lekë dhe për Shkodrën në vlerë 8.8 milionë lekë. Në OSSH Durrës, procesi i inventarizimit është shoqëruar me parregullsi duke e bërë të pamundur shprehjen mbi vërtetësinë dhe saktësinë e gjendjeve kontabël dhe fizike të mallrave në magazinë.

Spektori i Ujësjetllës Kanalizimeve vijon të paraqitet me vështirësi financiare në pagimin e detyrimeve dhe mbledhjen e të ardhurave të faturuara korrente dhe të prapambetura. Për vitin 2024, buxheti i shtetit ka alokuar një vlerë totale subvencioni prej 350 milionë lekë në strukturën buxhetore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Nga auditimi konstatohet se në raportin “Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatën makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2024”, mungojnë të dhëna në lidhje me monitorimin dhe raportimin e të dhënave financiare të ndërmarrjeve të këtij sektori. Për sa më sipër konstatohet se kundrejt këtij sektori, monitorimi konsiston vetëm në drejtim të mbledhjes dhe raportimit të të dhënave statistikore në lidhje me detyrimet e ndërsjella. Sipas raportit për zbatimin e buxhetit të vitit 2024, OSHEE Group SH.A raporton se detyrimet e akumuluar të ndërmarrjeve të ujësjetllës-kanalizimeve rezultojnë të jenë rreth 32.6 miliardë lekë nga të cilat rreth 16.6 miliardë lekë janë detyrime të faturuara ndaj kompanisë dhe rreth 16 miliardë lekë janë detyrime për kamatëvonesa. Nga totali detyrime vetëm ndërmarrja e UK Durrës SH.A ka rreth 5.62 miliardë lekë detyrime të akumuluar ndër vite (pa kamatëvonesa).

Për sa më sipër, nga ana e Ministrisë së Financave, përveç evidentimit të tyre në raporte, nuk rezultojnë të jenë ndërmarrë masa konkrete për të monitoruar ndikimin e këtyre detyrimeve në buxhetin e shtetit dhe për të nxitur përmirësime strukturore në praktikën e rakordimit dhe shlyerjes së tyre, me qëllim minimizimin e ekspozimit fiskal për buxhetin e shtetit.

Nga auditimi në *Korporatën e Investimeve Shqiptare* (Korporata), në lidhje me projekt-propozimet në fushën e pronave shtetërore, rezultojnë se ky aktivitet bazohet në Ligjin nr. 71/2019 “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare” dhe VKM-në nr. 137, datë 06.03.2024 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurës për dhënien e pronës shtetërore me qira, enfitëozë, leasing, shitje, përdorim si kolateral dhe të përdorimit në formë të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare”, të cilat funksionojnë të lidhura me njëra-tjetrën, ku ligji përcakton misionin dhe objektivat themelore të Korporatës, ndërsa VKM-ja krijon rregullat operative për të realizuar këto objektiva për pronat shtetërore. Baza ligjore e sipërcituar i jep Korporatës një pavarësi në administrimin, menaxhimin dhe përdorimin e pronave shtetërore, duke përfshirë dhënien e tyre

me qira, enfiteozë, leasing, shitje apo përdorim si kolateral, si dhe zhvillimin e projekteve përmes procedurave të veçanta konkurrimi dhe negocimi të drejtpërdrejtë.

Nga auditimi u konstatua se këto akte ligjore nuk ofrojnë mekanizma të qartë për monitorimin dhe vlerësimin e vazhdueshëm të efektivitetit të procedurave dhe të ekzekutimit të projekteve, të cilat paraqesin një risk të lartë operacional dhe institucional për menaxhimin e pronave shtetërore, si dhe nuk garantojnë sigurinë e tyre. Për më tepër, proceset e përcaktuara në këto akte ligjore nuk janë në përputhje me legjislacionin shqiptar mbi Prokurimet Publike, por mbështeten ekskluzivisht në kompetencat dhe procedurat e brendshme të Korporatës për të cilat ajo nuk ka hartuar, akte nënligjore, rregullore ose manuale specifike për të gjitha proceset e punës që do të kryhen nga struktura, duke filluar nga përzgjedhja dhe administrimi i pronave shtetërore për zhvillim, si dhe mbi llojet e procedurave mbi të cilat do të operojë në përputhje me këtë bazë ligjore dhe me karakteristikat specifike të praktikave të parashikuara.

Nga ana e Korporatës nuk është hartuar një Plan Strategjik Afatmesëm, mbi veprimtarinë e saj, për të identifikuar objektivat strategjike institucionale duke cënuar vijueshmërinë institucionale të saj. Edhe pse përbërja e Këshillit Mbikëqyrës ka qenë pothuajse e njëjtë, në projekt propozimet e vitit 2024 konstatohet një ndërprerje në realizimin e projekt-propozimeve të mëparshme (2021-2023), duke përfshirë ato në sektorin e energjisë dhe zhvillimit të zonave prioritare.

Për projektet e përzgjedhura në kuadër të Zhvillimit të Pronave Shtetërore përgjatë vitit 2024, konstatohet se nuk ka një dokument/rregullore/manual, mbi identifikimin dhe përzgjedhjen e tyre, si dhe nuk ka një analizë mbi përfitueshmërinë, kostove financiare, risqet potenciale, vlerën e shtuar të parasë, rentabilitetin e investimit, apo për hapat konkrete që do duhet të ndiqen për çdo projekt propozim përpara shpalljes së tij, të tilla si parafizibiliteti/fizibiliteti sikundër vepruar për projektet e periudhës 2022-2023; si dhe një analizë krahasuese nëse këto projekt-propozimet do të zhvilloheshin nga vetë Institucionet, me financim të brendshëm nga buxheti i shtetit.

Nga auditimi rezulton se institucioni ka raportuar humbje të akumuluar në rezultatin financiar prej 139.68 milionë lekë, të cilat kanë ardhur si rrjedhojë e mos gjenerimit të të ardhurave nga projektet e investimeve. Nga viti në vit humbjet kanë ardhur në rritje të konsiderueshme ndërkohë, nga strukturat drejtuese të Korporatës, nuk janë marrë masa për analizimin e kësaj situate, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 71/2019 “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare”, dhe me ligjin nr.10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. Deri në fund të periudhës objekt auditimi u konstatua se Korporata nuk disponon një plan vjetor apo strategjik lidhur me të ardhurat që parashikohen të gjenerohen nga veprimtaria e saj.



Problematika në menaxhimin dhe përdorimin e fondeve në dispozicion nga shoqëritë aksionere me kapital shtetëror

Nga auditimi mbi zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, me efekt edhe në zbatimin e kontratave, u konstatuan disa problematika si më poshtë:

- Përlllogaritja e fondit limit, nuk është e dokumentuar me dokumentacion mbështetës si preventivat ose analizat përkatëse të tregut (UK Lezhë), si dhe gjatë testimit të tregut, ofertat janë marrë para daljes së urdhrit të prokurimit; me mangësi edhe nga ana e formës dhe përmbajtjes në pesë raste,

- ▶ Mangësi në përcaktimin e kriterëve të kualifikimit në gjashtë raste,
- ▶ Mangësi në vlerësimin e ofertave, duke kualifikuar dhe shpallur fitues operatorë ekonomik të cilët kanë mangësi në përmbushjen e kriterëve të kualifikimit, si dhe skualifikimin e operatorëve ekonomikë në raste të devijimeve më të vogla, apo jo materiale në tre raste,
- ▶ Në procedurat e prokurimit blerje të vogla, janë realizuar prokurime për produkte të ngjashme, që duhej të trajtoheshin si një grup mallrash dhe të prokuroheshin me një procedurë të vetme tenderimi në dy raste,
- ▶ Gjatë zbatimit të kontratave për punime civile kanë rezultuar punime ndërtimi të pakryera në volumet e stacionuara dhe jo në përputhje me specifikimet teknike apo vonesa/ mangësi në realizimin në afat të shërbimeve të kontraktuara, por të pa penalizuara në tre raste,
- ▶ Në njësinë e prokurimit dhe në KVO mungon specialisti i fushës, si dhe është konstatuar mungesë e përcaktimit të saktë të objektit të kontratës, si kontratë shërbimesh dhe jo si kontratë e punimeve civile në dy raste,
- ▶ Mangësi në krijimin dhe përbërjen e komisioneve të marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve të prokuruar në dy raste,
- ▶ Në lidhje me vendimet gjyqësore me objekt marrëdhëniet e punës, konstatohet se “TEC Vlorë” SHA është penalizuar në vlerën gjithsej prej 23.1 milionë lekë; OST Sh.a në shumën 7.67 milionë lekë; OSSH Tirane në shumën 6.6 milionë lekë; OSSH Shkodër në shumën 4.9 milionë lekë; OSSH Durrës në shumën 945 mijë lekë,
- ▶ Parregullsi në akordimin e shpërblimeve mbi pagë, në llogaritjen e shtesës së vështirësisë në pagë, për trajtimin ushqimor dhe dieta në tre raste,
- ▶ Programe ekonomike të hartuara pa u mbështetur në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik e Social dhe strategjitë sektoriale përkatëse; në disa raste programet nuk janë përcjellë për miratim, ose nuk kanë kaluar ciklin e plotë të miratimit nga ministria përgjegjëse, bashkë me paketën shoqëruese. Gjithashtu, kërkesat buxhetore dhe rritjet e kostove nuk shoqërohen me argumentime, llogaritje të verifikueshme dhe elementët thelbësorë.

Kontratat koncesionare

Për vitin 2024 rezultojnë 11 kontrata koncesionare dhe të Partneritetit Publik-Privat (PPP) me mbështetje buxhetore, për 10 prej të cilave janë kryer pagesa faktike. Në total, plani përfundimtar për këto projekte paraqitet në shumën 13,644 milionë lekë, ndërkohë që pagesat rezultuan në shumën 13,293 milionë lekë, me një realizim në masën 97.4%. Pagesat vjetore faktike nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, për kontratat koncesionare apo PPP, në shumën prej 13,293 milionë mijë lekë përbëjnë 2.22% e totalit të të ardhurave tatimore faktike të vitit 2023, prej rreth 598,661 milionë lekë, duke qenë brenda kufirit të pagesave prej 5% të të ardhurave tatimore faktike. Sipas raportit të buxhetit faktik 2024, të detajuara sipas kontratave respektive plani dhe pagesat për secilën kontratë koncesionare/PPP paraqitet si në vijim:

në milionë lekë

Emërtimi i Kontratës PPP		Fillim	Mbarim	Fakt 2023	Plan 2024	Fakti 2024	% e realizimit Fakt/Plan 2024
MIE	Inceneratori për përpunimin e mbetjeve urbane të Bashkisë Fier	2016	2022				
	Rruga e Arbrit	2018	2031	2,844	3,504	3,504	↔ 100%
	Autostrada Milot – Morinë	2017	2047	667	609	609	↔ 100%
	Porti i Jahteve – By Pass Orikum – Dukat	2019	2032	727	786	786	↔ 100%
MF	Shërbimit të skanimit të kontejnerëve e automjeteve të tjera	2013	2030	1,540	1,435	1,412	↓ ↔ 98.4%
MSHMS	Kontrolli mjekësor bazë (Check-up)	2015	2025	876	876	876	↔ 100%
	Ofrimi i setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale	2016	2026	1,750	1,756	1,756	↔ 100%
	Ofrimi i shërbimit të dializës	2016	2026	849	920	894	↓ ↔ 97.2%
	Ofrimi i shërbimeve laboratorike spitalore	2020	2030	1,719	1,850	1,803	↓ ↔ 97.4%
Bashkia Tiranë/MASR	Për Përmirësimin e Infrastrukturës Arsimore "Për Projektimin, Financimin, Ndërtimin, Mobilimin, Mirëmbajtjen, e 5 objekteve në Zonën Tirana 1 dhe për 4 objekte në zonën Tirana 4"	2018	2026	698	723	722	↓ ↔ 99.9%
MIE / Bashkia Tiranë	Inceneratori i Tiranës	2017	2047	990	1,185	931	↓ ↔ 78.6%
TOTALI				12,660	13,645	13,294	
Totali i të Ardhurave Tatimore				598,662	658,847		
Respektimi i Rregullit Fiskal (përpjesa e pagesave të PPP ndaj totalit të të ardhurave tatimore të vitit paraardhës buxhetor më pak se 5%)				2.34%	2.22%		

Burimi: Ministria e Financave

! Në lidhje me pagesat e kryera për vitin 2024 u konstatuan problematikat, si në vijim:

Me buxhetin e vitit 2024 janë shlyer detyrime të viteve të mëparshme për projektin "Për Projektimin, Financimin, Ndërtimin, Mobilimin, Mirëmbajtjen, Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e pesë objekteve arsimore në Zonën Tirana 1 dhe për 4 objektet arsimore në zonën Tirana 4", në vlerën 138.37 milionë lekë.

Për koncesionin "Shërbimi i Skanimit në Dogana", pagesat e kryera në vitin 2024 rezultojnë në shumën 1,289.7 milionë, ndërkohë në raportin "Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatës makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2024", raportohen 1,412 milionë lekë, pra 122 milionë lekë më tepër sesa pagesat faktike. Kontrata koncesionare "Ndërtimi i Landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimit të vend depozitimeve ekzistuese Tiranë dhe prodhimin e energjisë elektrike" nuk është mbuluar nga programi 06220 "menaxhimi i mbetjeve urbane", por nga buxheti i Bashkisë Tiranë. Sipas të dhënave të Ministrisë së Financave, pagesat për këtë kontratë janë regjistruar vetëm nga Bashkia e Tiranës, në shumën 931.3 milionë lekë. Megjithatë, në databazën e pagesave në SIFQ rezulton se përveç pagesave të Bashkisë Tiranë, janë paguar fonde nga buxheti i shtetit edhe nga njësi të tjera shpenzuese si: 204 milionë lekë janë paguar nga Bashkitë Kamëz, Kavajë, Vorë, si dhe 295.5 milionë lekë nga Bashkia Durrës, duke e çuar vlerën totale të pagesave në 1,431 milionë lekë.

Për kontratën koncesionare “Ofrimi i shërbimeve laboratorike spitalore”, nga sistemi SIFQ pagesat faktike të vitit 2024 rezultojnë 1,843 milionë lekë, ose 40.49 milionë lekë më tepër sesa pagesat e raportuara nga Ministria e Financës.

Nga auditimi mbi planifikimin dhe realizimin e fondeve për kontratat PPP, në sektorin e shëndetësisë, rezultoi se për vitin 2024 janë evidentuar problematika që lidhen me pagesat e kryera për shërbime të parealizuara, konkretisht:

Nga auditimi i kontratës koncesionare nr. 3082/20, datë 07.01.2015, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH) dhe shoqërisë koncesionare për shërbimin e Kontrollit Mjekësor Bazë (KMB)/ Check up, evidentuan një sërë dobësish në projektim dhe zbatim, të cilat kanë ndikuar në ofrimin efikas të shërbimit dhe në administrimin ekonomik të fondeve publike. Kontrata parashikon ofrimin e 475,000 kontrolleve mjekësore në vit, me një tarifë 1,844.4 lekë/kontroll me TVSH, me një fond vjetor planifikimi në shumën 876.09 milionë lekë. Nga auditimi rezulton se, gjatë vitit janë realizuar faktikisht 461,376 raste, ndërkohë që pagesa është kryer për numrin e parashikuar në kontratë prej 475,000 rastesh, duke shkaktuar një mbipagesë në shumën 25.13 milionë lekë.

FSDKSH nuk ka realizuar asnjë verifikim mbi përmbushjen e detyrimeve të kontraktuara nga koncesionari, si: instalimin dhe funksionimin e infrastrukturës teknologjike si dhe raportet e dorëzuara nga koncesionari përmbajnë vetëm të dhëna statistikore mbi numrin e kontrolleve dhe analizave të kryera, por nuk dokumentojnë përmbushjen e komponentëve të tjerë kontraktualë apo funksionimin e sistemeve mbështetëse të kërkuara.

Kontrata PPP për Shërbimin e Dializës me nr. 710, datë 10.02.2016, ndërmjet FSDKSH-së dhe shoqërisë koncesionare, përcakton ofrimin e shërbimeve të dializës në pesë qendra të specializuara, ku pagesa bëhet mbi bazën e seancave të realizuara, por jo më pak se projeksioni minimal vjetor i kontratës, i cili për vitin 2024 ka qenë 79,560 seanca dialize. Nga auditimi ka rezultuar se gjatë vitit 2024 janë realizuar faktikisht 69,828 seanca, ku në disa qendra janë realizuar dhe paguar 10,389 seanca më pak se projeksioni vjetor, ndërkohë që në disa të tjera u tejkalua me 657 seanca.

Për vitin 2024 nuk është vënë në dispozicion asnjë dokumentacion që të vërtetojë ushtrimin e kontrolleve të drejtpërdrejta apo monitorimeve të plota nga ana e FSDKSH-së, mbi:

- Ndërtimin/rikonstrukcionin e qendrave të dializës sipas specifikimeve kontraktuale
- Pajisjen me makineri dhe aparatura të kërkuara
- Sigurimin e stafit të kualifikuar dhe trajnimin e tij sipas kriterëve
- Zbatimin e protokolleve mjekësore dhe regjistrimin e të dhënave sipas standardeve
- Dixhitalizimin e raportimit dhe ndjekjes së seancave të dializës.

Nga ana e FSDKSH-së nuk disponohet informacion lidhur me ushtrimin e kontrolleve të mësipërme nga ana e MSHMS, apo institucioneve të tjera të ngarkuar nga MSHMS për realizimin e monitorimeve për realizimin e objektivave të kontratës koncesionare. Gjithashtu, nuk është dokumentuar asnjë plan monitorimi periodik, raport vlerësimi apo plan korrigjimi lidhur me zbatimin e kontratës, sidomos për qendrat që historikisht nuk kanë realizuar projeksionet e kontraktuara (Shkodër, Vlorë, Korçë).

Nga auditimi u konstatua se nuk është vendosur në funksion një sistem efektiv sinjalizimi dhe ndjekjeje për rastet e mosfunksionimit të aparaturave apo ndërprerjes së shërbimit në qendrat e dializës, siç parashikohet në dispozitat kontraktuale. Mungesa e këtij mekanizmi ka kufizuar ndjeshëm kapacitetin për të monitoruar performancën dhe për të verifikuar cilësinë e shërbimeve të ofruara nga koncesionari. Për pasojë, FSDKSH ka vijuar me pagesat mujore ndaj koncesionarit, në mungesë të dokumentacionit justifikues mbi përmbushjen cilësore dhe sasiore të shërbimeve të kontraktuara.

Nga auditimi i kontratës së PPP për ofrimin e shërbimeve laboratorike mjekësore, lidhur në zbatim të VKM-së nr. 258, datë 24.04.2019, u evidentua një sërë mangësish në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale nga palët përgjegjëse, në kundërshtim me dispozitat e kontratës koncesionare dhe shtojcat përkatëse të saj. Nga auditimi i zbatimit të kontratës së koncesionit u konstatua se strukturat përgjegjëse për administrimin dhe mbikëqyrjen e saj, Komiteti Ndërlidhës, koncesionari dhe FSDKSH, nuk kanë garantuar realizimin dhe dokumentimin e procesit të monitorimit, raportimit dhe trajtimit të ankesave, duke mos garantuar cilësisë dhe transparencën e shërbimeve të ofruara për pacientët.

Nga FSDKSH nuk u vendos në dispozicion asnjë raport kontrolli apo inspektimi në lidhje me këtë kontratë për periudhën objekt auditimi, si dhe nuk disponohej informacion lidhur me ushtrimin e kontrolleve të mësipërme nga ana e MSHMS, apo institucioneve të tjera të ngarkuar nga MSHMS.

Gjithashtu, nuk është vënë në dispozicion asnjë raport vjetor mbi performancën e koncesionarit siç parashikohet në shtojcës 2 dhe shtojcës 14 të VKM-së, i cili duhet të përmbajë informacion mbi performancën, përputhshmërinë me indikatorët e kontratës, si dhe sistemet e kontrollit të brendshëm të zbatuara. Referuar shtojcës 10 pika 1.12, u konstatua se nga FSDKSH nuk disponohej asnjë dokumentacion mbi funksionimin e sistemit të vlerësimit dhe ankesave nga pacientët apo mjekët.

Nga auditimi i kontratës koncesionare për furnizimin, trajtimin dhe dezinfektimin e pajisjeve kirurgjikale sterile u konstatua se zbatimi dhe monitorimi i kësaj kontrate nuk është realizuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në kontratë, duke evidentuar parregullsi dhe mungesa të rëndësishme në dokumentacionin dhe proceset e kontrollit të shërbimeve, përfshirë anekset e kontratës, dokumentet standarde të koncesionit (pika 12), projektin teknik sipas pikës 6.3 dhe 6.4 të kontratës, formularët standard për raportimin ditor dhe mujor (pika 11, 24), si dhe raportet vjetore dhe tremujore të investimeve (pika 13), e cila pengoi verifikimin efektiv të përmbushjes së detyrimeve kontraktore dhe vlerësimin e cilësisë së shërbimit.

Në aspektin financiar, u konstatua rritje në përdorimin e seteve kirurgjikale sterile dhe shpenzimeve për vitin 2024 krahasuar me vitin 2023, ndërkohë që diferencat midis faturave të koncesionarit dhe verifikimeve në spitalet përfituese (muajt Qershor dhe Shtator 2024), sidomos për sterilizimin me avull, tregojnë mos përputhje dhe pagesa të papaguara për shërbime të faturuara, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 10 dhe 26.


FSDKSH nuk dispononte të dhëna lidhur me investimet e kryera, trajnimet profesionale të personelit (pikat 13 dhe 17), teknologjitë e instaluar (pika 18) dhe qendrat back-up (pika 22), të cilat janë detyrime të përcaktuara për t'u realizuar nga koncesionari. Monitorimi i realizuar nga FSDKSH është i kufizuar vetëm në analizën e të dhënave raportuese, pa përfshirë kontrolle fizike

dhe verifikime të detajuara, duke rrezikuar cilësinë e shërbimit dhe pa garantuar verifikimin e përmbushjes së kërkesave të përcaktuara në pikën 12 të kontratës koncesionare dhe pikën 6 të kontratës së financimit. Gjithashtu, FSDKSSH nuk dispononte informacion nëse MSHMS apo institucioneve të tjera të ngarkuar kanë ushtruar kontrollet e nevojshme.

Referuar të dhënave lidhur me financimin dhe likuidimin e shpenzimeve për kontratën e koncesionit “PPP-Kontrolli Mjekësor Bazë” dhe “PPP-Sterilizimi i pajisjeve mjekësore”, është likuiduar me TVSH vlera e shpenzimeve të kryera për dhënien e këtyre shërbimeve.

Nga ana e Ministrisë së Financave nuk është finalizuar dhe nuk është publikuar raporti i Performancës së Kontratave të Koncesionit dhe të Partneritetit Publik Privat për vitin 2024, raport i cili përfshin mbledhjen dhe raportimin e të dhënave të ecursisë dhe performancës financiare dhe jo financiare të kontratave të koncesionit/PPP dhe synon të sigurojë që risqet kryesore fiskale nga kontratat e koncesionit/PPP janë identifikuar dhe raportuar në mënyrë sistematike, në kundërshtim me pikën 4 dhe 7 të nenit 10 të ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar ku përcaktohet detyrimi për mbikëqyrjen, vlerësimin dhe raportimin e rregullt mbi ecurinë dhe ndikimet fiskale të kontratave koncesionare dhe PPP.

Detyrimet e prapambetura të qeverisjes së përgjithshme



Për vitin 2024 pavarësisht se evidentohet ulje krahasuar me vitin e kaluar, konstatohet ende një nivel i lartë i stokut ekzistues dhe gjithashtu krijim i detyrimeve të reja nga institucione të ndryshme publike.

Deri në fund të muajit Dhjetor 2024 u regjistrua një stok kumulativ prej 7.32 miliardë lekë nga të cilat: totali i detyrimeve të qeverisë qendrore rreth 2.66 miliardë lekë, totali i detyrimeve të qeverisë vendore rreth 3.26 miliardë lekë, totali i detyrimeve për rimbursimin e TVSH-së rreth 1.4

miliardë lekë ku kjo e fundit ka qenë 0 lekë në fund të vitit 2023.

Përsa u përket njësive të vetëqeverisjes vendore konstatohet se vetëm 13 bashki (në totalin bashki/qarqe) përbëjnë rreth 79.5% të totalit të stokut të detyrimeve të prapambetura të njësive të vetëqeverisjes vendore ku peshën kryesore e zënë Bashkia Kavajë me rreth 737.6 milionë lekë ose rreth 23% e totalit të detyrimeve, Bashkia Tiranë me 570.4 milionë lekë ose 17.5%, Bashkia Pogradec me 238.1 milionë lekë, Bashkia Rrogozhinë me 161 milionë lekë, Bashkia Vlorë me 153.8 milionë lekë etj.

Krahasuar me vitin 2023 për njësitë e vetëqeverisjes vendore detyrimet “për investime” kanë pësuar ulje nga 47.4% në vitin 2023 në 28.6% në vitin 2024. Ndërsa detyrimet e prapambetura “të tjera” janë rritur ndjeshëm nga 25.6% në 32.2%, duke u bërë kategoria më e madhe në strukturën e përgjithshme. Rritje të ndjeshme ka shënuar edhe zëri shërbime nga 11.3% në 16.2%, si dhe vendimet gjyqësore nga 7.2% në 11.7%.

Përsa i përket njësive të qeverisjes qendrore vetëm 5 Ministritë përkatësisht: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës, Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Financave përbëjnë rreth 86% të totalit të stokut të detyrimeve të prapambetura të njësive të qeverisjes qendrore. Krahasuar me vitin 2023 rezultojnë se detyrimet për investime kanë pësuar rritje të ndjeshme, nga 31.2% në 41.2%, duke u bërë zëri më i madh në total. Vendimet gjyqësore, edhe pse mbeten një kategori me ndikim të lartë, kanë rënë nga 39.6% në 34.3%.

Në përmbledhje, struktura e detyrimeve të prapambetura për vitin 2024 tregon një zhvendosje drejt investimeve si zëri kryesor, një ulje të barrës nga vendimet gjyqësore dhe një reduktim të detyrimeve të tjera e të sigurimeve shoqërore, ndërkohë që disa kategori të vogla kanë marrë peshë disi më të madhe në krahasim me vitin paraardhës.

Për sa i përket saktësisë dhe plotësisë së të dhënave të raportuara për pagesat e detyrimeve të prapambetura gjatë vitit 2024, si dhe për stokun në datën 31 dhjetor 2024, u evidentua se ky raportim nuk rezultojnë i plotë dhe i saktë. Sipas të dhënave të audituara nga sistemi SIFQ, rezultojnë se vlera faktike e pagesave të kryera për detyrime të prapambetura gjatë vitit 2024 (duke përfshirë edhe ato detyrime të vitit 2024 mbi 60 ditë) është rreth 15,777 milionë lekë më e lartë sesa ajo e raportuar.

Kjo diferencë tregon se një pjesë e konsiderueshme e institucioneve kanë kryer pagesa për detyrime të prapambetura pa i regjistruar ato përmes skemës së përcaktuar të kontabilizimit, pra pa përdorur grupin buxhetor 486 dhe llogarinë 4864 *“Shpenzime të periudhave të ardhshme, fatura të prapambetura”*, me efekt në pasaktësi të vlerës së raportuar të pagesave të detyrimeve të prapambetura gjatë vitit 2024, duke nënvlerësuar detyrimet e prapambetura të periudhës së mëparshme dhe periudhës objekt auditimi 31.12.2024.

Nga analizat e kryera, 491 institucione nga 1094 të testuara rezultojnë me mospërputhje midis pagesave faktike dhe atyre të raportuara. Më konkretisht:

Nga 97 institucione janë raportuar pagesa më të vogla sesa pagesat faktike që rezultojnë nga sistemi SIFQ, me një diferencë prej 11,958 milionë lekë, si Autoriteti Rrugor Shqiptar me diferencë rreth 4,519 milionë lekë, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit me 1,606 milionë lekë, Bashkia Kamëz me 785 milionë lekë, Aparati i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë me 752 milionë lekë, Bashkia Tiranë me 639 milionë lekë, etj.

Nga 69 institucione janë raportuar pagesa më të mëdha sesa pagesat faktike që rezultojnë në sistemi SIFQ, me një diferencë prej 1,873 milionë lekë si, Bashkia Kurbin me diferencë rreth 459 milionë lekë, Aparati i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me 384 milionë lekë, Prokuroria e Rrethit Tiranë me 195 milionë lekë, Bashkia Durrës me 191 milionë lekë, Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar (INUK) me 105 milionë lekë.

Institucionet me shtesën më të lartë të detyrimeve për vitin 2024 konstatohen: ARRSH rezultojnë me një shtesë prej 8,122 milionë lekë, AKSHI me një shtesë prej rreth 1,998 milionë lekë, Bashkia Tiranë me një shtesë prej 1,904 milionë lekë, Aparati i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjetikës me një shtesë prej 753 milionë lekë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizime me një shtesë prej 524 milionë lekë.

Këto devijime tregojnë se procesi i raportimit të detyrimeve të prapambetura nuk është monitoruar në mënyrë të plotë dhe nuk ka garantuar saktësinë dhe plotësinë e vlerave të raportuara në përputhje me të dhënat faktike të pagesave, sipas kriterëve të përcaktuara në Udhëzimin nr. 37 datë 06.10.2020 "Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të Qeverisjes së Përgjithshme". Sa i takon, skemës së kontabilizimit të faturave të prapambetura si "shpenzime të periudhave të ardhshme", ajo ka mbetur e pandryshuar dhe në kundërshtim me pikën 36 të Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018, sipas të cilit shpenzimi duhet të njihet në momentin kur ndodh ose kryhet, duke sjellë devijime të pasqyrave financiare dhe treguesve fiskalë.

Detyrime të tjera kontigjente për çështjet gjyqësore ndërkombëtare

Në detyrimet kontigjente detyrimet e mundshme që kanë lindur apo mund të lindin nga Vendimet e Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg (GJEDNJ), çështje që lidhen me kthimin dhe kompensimin e pronave tek ish-pronarët, si dhe Vendimet e Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit që kanë të bëjnë me vendimet e formës së prerë për zgjidhjen e konflikteve në mosmarrëveshjet dy/shumëpalëshe, në ngarkim të shtetit shqiptar.

a) Vendimet e Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg (GJEDNJ) : Gjatë vitit 2024, Këshilli i Ministrave ka miratuar 2 VKM me një vlerë prej 186,700 Euro (rreth 19 milionë lekë) të cilat janë përballuar nga Fondi Rezervë i buxhetit të shtetit dhe Ministria e Financave ka ekzekutuar edhe 27 vendime të GJEDNJ për vlerë prej 102,049 Euro (rreth 1.4 milionë lekë) pra në total 29.4 milionë lekë pagesa për vendime të GJEDNJ.

Deri në fund të vitit 2024, detyrimet faktike dhe kontingjente për vendimet e GJEDNJ-së raportohen në vlerën 17,996,950 Euro, vlerë e cila i takon 10 vendimeve të cilat janë në tejkalim të afatit 3 mujor dhe rrezikojnë pagesa interesi për likuidim të vonuar të vendimeve. Vetëm për tre vendime interesat/kamatëvonesat e përllogaritura deri më datë 31.12.2024 janë në shumën 4,002,982 euro (nga 3,422,744 euro që rezultonte në 31.12.2023).

b) Vendimet e Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit: Vendimet e Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit kanë të bëjnë me vendimet e formës së prerë për zgjidhjen e konflikteve në mosmarrëveshjet dy/shumëpalëshe, në ngarkim të shtetit shqiptar, me efekte të konsiderueshme financiare dhe për pasojë me risk të lartë për buxhetin e shtetit.


Vlera totale e kostove të vendimeve të arbitrazhit të paguara nga buxheti i shtetit (kosto ligjore/mbrojtje/shpenzime gjyqësore apo kosto të tjera), për vitin 2024 rezulton në shumën rreth 495.7 milionë lekë, nga të cilat Autoriteti Portual Durrës 223 milionë lekë, Ministria e Financës 143.4 milionë lekë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë 56.2 milionë lekë, Albpetrol sha 52.2 milionë lekë dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural 20.9 milionë lekë.

Nga auditimi mbi raportimet e Vendimeve të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit rezulton se deri në fund të vitit 2024, detyrimet faktike dhe kontingjente për vendimet e Arbitrazhit paraqiten në vlerën 179,948,214 Euro. Detyrimet e GJEDNJ-së, Arbitrazhit Ndërkombëtar si dhe mosekzekutimi i tyre në kohë paraqesin një risk të shtuar fiskal, jo vetëm për treguesit buxhetor të institucioneve përgjegjëse por edhe në nivel makroekonomik për financat publike, pasi pavarësisht se këto detyrime nuk llogariten dhe nuk regjistrohen në treguesit e borxhit publik, e implikojnë dhe e nënvlerësojnë këtë të fundit, pasi janë detyrime që do të shlyhen në të ardhmen.

C. DEFICITI BUXHETOR

Të ardhurat buxhetore janë realizuar në mënyrë të njëtrajtshme gjatë vitit buxhetor 2024, me përjashtim të zërave jo tatimorë të klasifikuar si e ardhur, për transfertën e rezultatit të skemës së sigurimit shoqëror dhe transfertën nga llogaria e shpronësimeve. Ndërkohë shpenzime buxhetore janë realizuar në mënyrë të njëtrajtshme gjatë vitit buxhetor 2024, duke akumuluar kryerjen e pagesave në fund të vitit. Në këtë mënyrë, për periudhën Janar- Nëntor raporti të ardhura dhe shpenzime rezulton me suficit. Akumulimi i shpenzimeve në muaji dhjetor ka ndikuar në rezultatin e këtij raporti duke rezultuar në mbyllje të vitit me një deficit buxhetor në shumën 17,984 milionë lekë. Ecuria mujore e të ardhurave dhe shpenzimeve në rezultati në deficit/suficit paraqitet në tabelën e mëposhtme:

në milionë lekë




Muajt	Totali te Ardhurave	Totali Shpenz.	Suficiti/Deficit
Janar	54,516	39,078	15,438
Shkurt	104,298	83,718	20,580
Mars	164,282	131,945	32,337
Prill	231,993	186,381	45,612
Maj	287,226	236,927	50,298
Qershor	343,113	291,283	51,830
Korrik	403,090	348,248	54,843
Gusht	464,716	405,980	58,735
Shtator	528,853	459,586	69,267
Tetor	590,233	519,201	71,031
Nëntor	648,002	576,428	71,575
Dhjetor	710,587	728,571	-17,984

Suficiti fiskal i akumuluar gjatë muajve janar-nëntor është ekzekutuar plotësisht në muajin dhjetor pasi në këtë muaj shpenzimet e realizuar përbëjnë rreth 21% e totalit vjetor të shpenzimeve vjetore, ndërkohë që realizimi i të ardhurave mujore ka ndjekur një trend më linear. Ekzekutimi i lartë i fondeve në fund të vitit tregon se është bërë një grumbullim i pagesave në fund të vitit duke ndikuar në rezultatin përfundimtar të buxhetit vjetor dhe duke rritur riskun për menaxhimin e likuiditetit, tejkalim të tavanëve buxhetore etj.

Konkretisht, evidentohet se përqendrimi i shpenzimeve në muajin dhjetor është kryer për pjesën më të madhe të zërave të treguesve fiskalë, me vlerën më të lartë për shpenzimet korrente (gati dyfish nga muajt e tjerë të vitit) dhe shpenzimet për investime kapitale gati 5-fish nga muajt e tjerë të vitit, paraqitur në tabelën e mëposhtme:

në milionë lekë

Zërat e Shpenzimeve	Shpenzime Janar-Nëntor	Mesatarja mujore	Realizimi Muaji Dhjetor
Shpenzime Korrente	512,460	46,587	93,829
Shpenzime Operative Mirëmbajtje	54,842	4,986	25,365
Shpenzime për fonde speciale	214,134	19,467	37,658
Shpenzime për Buxhetin Vendor	61,905	5,628	12,502
Shpenzime të tjera sociale	25,378	2,307	5,554
Shpenzime Kapitale	63,772	5,797	51,660



Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga KLSH

Gjatë vitit 2024, defikiti buxhetor u ngushtua ndjeshëm krahasuar edhe me realizimin e vitit 2023, i cili u mbyll në nivelin 31,180 milionë lekë, ndërkohë që plani fillestar për 2024 e parashikonte atë në -61,280 milionë lekë. Pas rishikimeve me Akte Normative, niveli i defiktit u ul në -57,280 milionë lekë, por realizimi faktik rezultoi vetëm -17,984 milion lekë, ose 39,296 milionë më pak se plani fillestar dhe 13,196 milionë lekë më pak se viti i kaluar.

Ky nivel i realizimit të defiktit nuk tejkalon kufijtë e defiktit vjetor të planifikuar dhe është brenda nivelit prej 2% të PBB, sipas kërkesave në planifikim të legjislacionit për menaxhimin e sistemit buxhetor.

në milionë lekë

Struktura e Borxhit	Fakti 2023	Buxheti fillestar 2024	Akti Normativ 1/2024	Akti Normativ 3/2024	Akti Normativ 5/2024	Fakti 2024	Diferenca plan-fakt 2024	Diferenca 2024/2023
DEFIKITI	-31,180	-61,280	-57,280	-57,280	-57,280	-17,984	39,296	↔ 13,196
FINANCIMI DEFIKITIT	31,180	61,280	57,280	57,280	57,280	17,984	-39,296	↔ -13,196
I brendshëm	-7,323	76,825	71,346	61,397	69,827	33,360	-36,468	↔ 40,683
Të ardhura nga privatizimi	47					27	27	↔ -20
Hua-marrje e brendshme	20,671	50,000	50,000	50,000	50,000	49,718	-283	↔ 29,046
Të tjera	-28,042	26,825	21,346	11,397	19,827	-16,385	-36,212	↔ 11,657
I huaj	38,503	-15,545	-14,066	-4,117	-12,547	-15,376	-2,829	↔ -53,879
Hua afatgjate (e marrë)	72,475	30,030	26,030	26,030	17,600	12,968	-4,632	↔ -59,508
Ndryshimi i gjendjes së arkës	51					-256	-256	↔ -307
Ripagesat	-53,238	-52,146	-52,146	-45,379	-45,379	-40,453	4,926	↔ 12,784
Mbështetje buxhetore	19,215	6,571	12,050	15,232	15,232	12,366	-2,866	↔ -6,849

Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga KLSH

Nga auditimi u konstatua se, faktorë të tjerë që kanë ndikuar në nivelin e defiçitit buxhetor të raportuar janë:

Mbivlerësimi i të ardhurave të buxhetit nëpërmjet zërit “të ardhura nga shpronësimet” si një nën zë i ri i shtuar në të ardhurat jo tatimore me Aktin Normativ nr. 3, datë 28.08.2024, në shumën 8,000 milionë lekë. Transferimi i mjeteve nga llogaria e shpronësimeve në Llogarinë e Unifikuar të Thesarit nuk gjeneron rritje të pasurisë neto dhe, për rrjedhojë, nuk përbën të ardhur buxhetore në kuptim të nenit 3/18 të ligjit nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar.

Mbivlerësimi i të ardhurave të buxhetit nëpërmjet zërit “të ardhura nga rezultati financiar i ISSH” në shumën 7,916 milionë lekë parashikuar në ligjin nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar, neni 4/3 në nivelin 7,900 milionë lekë, transferim i cili nuk plotëson kushtet për t’u klasifikuar si e ardhur buxhetore, sipas nenit 3, pika 18, të ligjit nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Mbivlerësim i shpenzimeve në zërin “transferta drejt të tretëve” në shumën 3,777 milionë lekë nga buxheti i vitit 2024 për shpenzime të vitit të ardhshëm, drejt enteve jo buxhetore si: Albcontrol në shumën 2,000 milionë lekë, ASHK në shumën 1,577 milionë lekë dhe KOKSH-in në shumën 200 milionë lekë.

Mbivlerësim i shpenzimeve për ndryshimin neto të detyrimeve të prapambetura ku përfshihen pagesat nga buxheti i vitit 2024 në shumën 10,6 miliardë lekë⁴, për llogari të detyrimeve të viteve të kaluara, dhe detyrime të prapambetura të raportuara nga MF në shumën -7.32 miliardë lekë, të cilat nuk janë njohur si shpenzim i vitit buxhetor në vitin 2024. Për shkak të parregullsive në regjistrimin, njohjen dhe raportimin të detyrimeve të prapambetura në SIFQ, kjo përlllogaritje paraqitet me rezerva.

Mbivlerësim i shpenzimeve buxhetore nëpërmjet zërit “transferte për llogarinë e fondit të pensioneve në BSH” me Aktin Normativ nr. 5, datë 19.12.2024⁵ në shumën 6,300 milionë lekë.

Nënvlerësim i shpenzimeve për vendime gjyqësore ndërkombëtare: GJEDNJ përkatësisht në shumën 57.1 milionë lekë nga interesat të akumuluar për vitin 2024. Në këtë përlllogaritje nuk përfshihen si shpenzim vendimet gjyqësore ndërkombëtare të viteve të kaluara, të cilat vazhdojnë të mos njihen dhe paguhen nëpërmjet buxhetit të shtetit, duke gjeneruar kosto shtesë për çdo vonesë në ekzekutim.

Problematikat e mësipërme vijnë si rezultat i mos aplikimit të drejtë të metodologjive për njohjen e të ardhurave dhe shpenzimeve në treguesit fiskal.

⁴ Trajtuar në kapitullin “PLANIFIKIMI DHE REALIZIMI I BUXHETIT”

⁵ Trajtuar në kapitullin “PLANIFIKIMI DHE REALIZIMI I SHPENZIMEVE”

D. BORXHI PUBLIK: MENAXHIMI DHE RAPORTIMI

Gjatë vitit 2024, kufizimet për borxhin e ri të emetuar dhe shlyerjen e borxhit ekzistues janë përcaktuar në nenet 10, 19 dhe 20 të Ligjit Nr.97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, i ndryshuar. Në këtë ligj është përcaktuar **financimi i deficitit** prej 61,280 milionë lekë, nëpërmjet rritjes së huamarrjes totale neto nga burime të brendshme në kufirin maksimal prej 50,000 milionë lekë si dhe pjesa tjetër e financimit të deficitit faktik të buxhetit të shtetit financohet nëpërmjet huamarrjes neto nga burime të huaja, si dhe ndryshimit pakësues ose shtues të gjendjes së llogarisë unike të Këshillit të Ministrave në Bankën e Shqipërisë dhe llogarive të fondeve speciale në bankat e nivelit të dytë dhe të huaja.

Vlera indikative e financimit nëpërmjet huamarrjes neto nga burime të huaja u parashikua në rreth -15,545 milionë lekë. Raportimi në tabelën e treguesve fiskalë të konsoliduar për financimin e deficitit të vitit 2024, së bashku me planet e ndryshuara përgjatë vitit paraqiten:

në milionë lekë

Struktura e Borxhit	Fakti 2023	Buxheti fillestar 2024	Akti Normativ 1/2024	Akti Normativ 3/2024	Akti Normativ 5/2024	Fakti 2024	Diferenca plan-fakt 2024	Diferenca 2024/2023
DEFIÇITI	-31,180	-61,280	-57,280	-57,280	-57,280	-17,984	39,296	↔ 13,196
FINANCIMI DEFIÇITIT	31,180	61,280	57,280	57,280	57,280	17,984	-39,296	↔ -13,196
I brendshëm	-7,323	76,825	71,346	61,397	69,827	33,360	-36,468	↔ 40,683
Hua-marrje e brendshme	20,671	50,000	50,000	50,000	50,000	49,718	-283	↔ 29,046
I huaj	38,503	-15,545	-14,066	-4,117	-12,547	-15,376	-2,829	↔ -53,879
Hua afatgjate (e marrë)	72,475	30,030	26,030	26,030	17,600	12,968	-4,632	↔ -59,508
Ripagesat	-53,238	-52,146	-52,146	-45,379	-45,379	-40,453	4,926	↔ 12,784
Mbështetje buxhetore	19,215	6,571	12,050	15,232	15,232	12,366	-2,866	↔ -6,849

Burimi: Ministria e Financave.

Me Aktin Normativ nr.1 datë 21.02.2024, u vendos ndryshimi i deficitit nga -61,280 milionë lekë në -57,280 milionë lekë. Në këtë akt, kufirin maksimal prej 50,000 milionë lekë nuk ndryshoi ndërsa vlera indikative e financimit nëpërmjet huamarrjes neto nga burime të huaja u ndryshua në -14,066 milionë lekë.

Me Aktin Normativ nr.3 datë 28.08.2024 dhe me Aktin Normativ nr.5 datë 19.12.2024, nuk janë bërë ndryshime të deficitit të parashikuar por janë bërë rialokime në strukturën e borxhit të brendshëm dhe të jashtëm brenda kufirit të deficitit. Nga auditimi u konstatua se defikiti faktik i vitit 2024 ishte 17,984 milionë lekë dhe u mbulua me kontribut neto nga burimet e brendshme 33,360 milionë lekë dhe kontribut neto pakësues nga burimet e huaja -15,376 milionë lekë.

Huamarrja e brendshme me anë të instrumenteve të bonove të thesarit dhe obligacioneve sipas raportimit në treguesit fiskalë të konsoliduar paraqitet në shumën 49,718 milionë lekë, me nën realizim përkundrejt planit me 282 milionë lekë.

Ripagesat për **borxhin e huaj** kanë rezultuar nën nivelin e planifikuar, me shlyerje të principalit në shumën 40,453 milionë lekë përkundrejt 52,146 milionë lekë të planifikuara. Nga auditimi konstatohet se komponenti “hua afatgjatë (e marrë)” u realizua në shumën 12,968 milionë lekë kundrejt planit të fundit 17,600 milionë lekë, “ripagesat” u realizuan në shumën 40,453 milionë lekë kundrejt 45,379 milionë lekë të planifikuara.

Sipas ligjit fillestar, **mbështetja buxhetore** për vitin 2024 ishte planifikuar në shumën 6,571 milionë lekë, vlerë e cila vetëm dy muaj më pas u rrit në shumën 12,050 milionë lekë me Aktin Normativ nr. 1.

Në ndryshimet e mëvonshme të buxhetit me Aktin Normativ nr. 3 dhe nr.5, ky burim financimi ka pësuar përsëri rritje, duke rezultuar në planin përfundimtar në shumën 15,232 milionë lekë. Megjithatë, në përfundim të vitit buxhetor mbështetja buxhetore raportohet me një mos realizim në shumën 2,866 milionë lekë. Në raport me një vit më parë, ky burim financimi është realizuar më pak për 6,849 milionë lekë.

Në përfundim, u konstatua se kufiri ligjor i huamarrjes së brendshme u respektua, por struktura përfundimtare e financimit u ndikua ndjeshëm nga nënrealizimi i projekteve të investimit me financim të huaj.


Sipas raportimit të Ministrisë së Financave në treguesit e borxhit publik, raporti i borxhit publik ndaj PBB për vitin 2024 ka rezultuar në rënie në krahasim me një vit më parë, nga 57.5% në 54% të PBB.

Treguesit kryesorë të borxhit publik dhe ecuria e tij sipas raportimit të Ministrisë së Financave dhe stokut të raportuar për vitin 2024, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

në milionë lekë

STRUKTURA E BORXHIT	VITI				
	2020	2021	2022	2023	2024
Borxhi publik	1,224,470	1,382,940	1,378,626	1,362,828	1,365,005
Borxhi i qeverisë qendrore	1,224,038	1,382,625	1,378,421	1,362,727	1,364,981
Borxhi i pushtetit lokal	432	315	204	101	24
PBB	1,655,984	1,866,674	2,149,741	2,369,906	2,530,043
Stoku i borxhit/PBB (%)	73.94%	74.09%	64.13%	57.51%	54%


Burimi: Ministria e Financave



Ulja e raportit të borxhit publik ndaj PBB-së është ndikuar kryesisht nga rritja e vetë PBB-së, e cila në terma nominalë është vlerësuar në rreth 160,137 milionë lekë ose 6.7% më e lartë se një vit më parë. Ndërkohë, niveli i borxhit gjatë vitit 2024 është rritur me 2,177 milionë lekë krahasuar me fundin e vitit 2023. Është llogaritur një efekt i kursit të këmbimit në portofolin e borxhit të shprehur në valutë prej rreth 28,697 milionë lekësh, ose rreth 1.13% të PBB-së. Ky efekt, duke marrë në konsideratë vetëm tepricën e huasë së rivlerësuar në raport me një vit më parë për njësi të monedhës së huaj (pa efektin e disbursimeve apo pagesave të principalit) vlerësohet në rreth 28,697 milionë lekë dhe ndikimin më të madh e ka nga borxhi në monedhën EURO dhe SDR. Kompozimi i borxhit shtetëror paraqitet në tabelën e mëposhtme:

në milionë lekë


STRUKTURA E BORXHIT	VITI					
	2020	2021	2022	2023	2024	2024/2023
Stoku i borxhit të brendshëm	644,088	702,256	732,654	741,778	788,360	6%
Stoku i brendshëm shtetëror	630,791	678,881	712,779	725,399	774,197	7%
Stoku i brendshëm i garantuar	13,297	23,375	19,875	16,379	14,163	-14%
Stoku i borxhit të jashtëm	579,950	680,369	645,768	620,948	576,621	-7%
Stoku i jashtëm shtetëror	544,434	648,848	613,421	595,991	557,198	-7%
Stoku i jashtëm i garantuar	35,516	31,521	32,346	24,958	19,423	-22%
Stoku i borxhit të qeverisjes qendrore	1,224,038	1,382,625	1,378,421	1,362,727	1,364,981	0.17%



Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga KLSH

Ndryshimi në stokun e borxhit të qeverisjes qendrore i atribuohet kryesisht rënies së stokut të borxhit të jashtëm në rreth 44,327 milionë lekë, për shkak se gjatë vitit 2024 nuk u emetua Eurobond, niveli i mbështetjes buxhetore ishte më e ulët se vitin e kaluar dhe gjithashtu vlera e kredive të disbursuara për financimin e projekteve është më e ulët se në vitin 2023. Për sa i përket kompozimit të portofolit të borxhit publik sipas instrumenteve, më shumë se 60% të peshës vazhdojnë ta mbajnë instrumentet e tregtueshme si: bono thesari, obligacione, eurobond.

Stoku i borxhit të brendshëm dominohet kryesisht nga instrumentet afatgjatë të obligacioneve me një vlerë stoku në fund të vitit 2024 në shumën 581,211 milionë lekë, përkundrajt 192,987 milionë lekë të stokut të instrumenteve afatshkurtër. Të krahasuara me të njëjtën periudhë të vitit më parë, stoku i instrumenteve të tregut të brendshëm paraqitet si më poshtë:



Tendenca përgjatë vitit 2024, ka shkuar në drejtim të rikompozimit të portofolit me instrumente më afatgjatë duke qenë në përputhje me objektivat strategjike afatmesëm për rritjen e maturitetit të portofolit të borxhit.

Borxhi i brendshëm i garantuar, në fund të vitit 2024 ka pasur rënie me 2,217 milionë lekë duke kaluar nga niveli i 16,379 milionë lekë në fund të vitit 2023 në 14,163 milionë lekë, i detajuar në tabelën e mëposhtme:

Në milionë lekë

HUAMARRËSI	2023	2024		Diferenca
FSHU / OSHEE, FTL, OSSH	1,552	1,403	↔	(149)
OSSH / OSHEE, FTL, FSHU	1,712	1,615	↔	(97)
FSHU / OSHEE	2,077	1,955	↔	(122)
FSHU / OSHEE	2,077	1,963	↔	(114)
FSHU / OSHEE	1,039	980	↔	(59)
KESH	778	643	↔	(135)
KESH	500	500	↔	0
KESH	2,037	1,925	↔	(112)
GS1	20	18	↔	(2)
GS2	4,248	2,919	↔	(1,330)
GS3	340	214	↔	(126)
GS4		28	↔	28
TOTALI	16,379	14,163	↔	(2,217)

Burimi: Ministria e Financave.

Ulja e stokut të garancive të brendshme konstatohet se vjen nga dy faktorë, nga efekti i kursit të këmbimit për garancitë e brendshme në monedhë të huaj dhe nga efekti i dy garancitë sovraane, konkretisht: Garancia Sovraane nr.2 dhe Garancia Sovraane nr.3, stoku i të cilës është zvogëluar si rezultat i pagesave të bëra nga bizneset përfituese. Ndërkohë ka pasur disbursime të reja gjatë vitit 2024 për “Garancinë Sovraane Nr.4”. Kjo garanci është parashikuar në shumën 4,000 milionë lekë për bankat tregtare, që ushtrojnë aktivitetin e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, për të mundësuar huadhënien ndaj subjekteve të industrisë përpunuese (kategoria NACE 2), për investime në teknologji dhe në inovacion, si dhe për blerje të lëndës së parë.

Sa i takon **Borxhit të jashtëm shtetëror**, përgjatë vitit 2024 janë regjistruar në sistemin e brendshëm të menaxhimit të borxhit transaksionet e disbursimit për 32 kredi, me një total në monedhë kombëtare në shumën 27,010 milionë lekë nga të cilat 3 kredi janë evidentuar si garanci që kanë pasur disbursime gjatë vitit në shumën 1,166 milionë lekë. Pjesa tjetër prej 29 projektsh përfshin një shumë të disbursuar prej 25,843 milionë lekë. Nga këto 29 projekte 4 prej tyre projektet që janë klasifikuar si mbështetje buxhetore në shumën 12,827 milionë lekë që kanë pasur këtë trajtim duke qenë se janë transferuar drejtpërsëdrejti në llogarinë e unifikuar të

thesarit në monedhën të huaj dhe jo në llogarinë speciale në Bankën e Shqipërisë për projektin përkatës nga IBRD, KFŴ dhe AFD.


Regjistrimi i transaksioneve të disbursimit vlerësohet të jetë kryer në mënyrë të rregullt, duke pasur parasysh vlerën e raportuar në ditë të caktuara në lekë sipas kursit zyrtar të këmbimit të publikuar nga Banka e Shqipërisë. Projektet specifike të cilat janë financuara më shumë përgjatë vitit 2024, duke përfshirë edhe mbështetjen buxhetore sipas disbursimeve të kredive respektive rezultojnë si në vijim:

PËRSHKRIMI	Njësia Zbatuese	Garanci/Kredi	Disbursime Në milionë lekë
Hua për politika publike për të mbështetur aftësinë ripërtëritëse dhe zhvillimin e gjelbër të Shqipërisë	Ministria e Financave	Kredi	5,899.8
Mbështetja e reformës në sektorin e energjisë faza II	Ministria e Financave	Kredi	5,231.5
Përmirësimi i aksesit të barabartë në shërbimet publike nëpërmjet Gov.Tech	Ministria e Financave	Kredi	501.2
Qukës -Qafë Pllaçë. Financim shtesë	MIE	Kredi	1,870.3
Rruga Tiranë-Elbasan-Qukës-Qafë Pllaçë. Financim Shtesë	MIE	Kredi	1,429.7
Rehabilitimi i hekurudhës Tiranë-Durrës dhe lidhja me TIA	MIE	Kredi	1,272.7
Modernizimi i sektorit të ujësjellës kanalizimeve	MIE (AKUM)	Kredi	1,235.1
Linja 400 kV Tiranë-Maqedoni	MIE (OST)	Garanci	898.4
Infrastruktura bashkiake V	MIE (AKUM)	Kredi	880.2
Rrugët Sekondare Lokale	FSHZH	Kredi	1,131.1
Zhvillimi i integruar urban dhe turizmit	FSHZH	Kredi	1,063.5
Furnizimi me ujë i zonave rurale IV	FSHZH	Kredi	990.0
Zhvillimi i Turizmit & Infrastrukturës në Shqipëri	FSHZH	Kredi	527.4
Programi i investimit në shpërndarjen e energjisë	OSHEE	Kredi	606.8

Burimi: Ministria e Financave

Përgjatë vitit 2024 janë nënshkruar 5 marrëveshje huaje në kuadër të huamarrjes së jashtme, për financim të projekteve, kredi të garantuara apo mbështetje buxhetore, për të cilat deri në fund të vitit nuk është realizuar asnjë disbursim:



Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (HSH) ka përfituar një hua prej 98,750 milionë lekësh nga EBRD për rehabilitimin e linjës hekurudhore Vorë–Hani i Hotit, si dhe një tjetër hua prej 100,000 milionë lekësh për projektin “Porta globale”; Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (AKUM) dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit kanë përfituar 75,500 milionë lekë nga IBRD për projektin “Mjedis i pastër dhe me aftësi ripërtëritëse, deti blu”; Ministria e Financave ka përfituar 120,000 milionë lekë nga AFD për mbështetjen e politikave publike për zhvillimin e gjelbër; dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit së bashku me AKSHI kanë përfituar 27,000 milionë lekë nga CEB, për dixhitalizimin e sistemit arsimor në Shqipëri – Smart Labs, duke e çuar totalin e huave në 421,250 milionë lekë.



Borxhi i Jashtëm i Garantuar, përgjatë vitit 2024, paraqitet në rënie me 5,535 milionë lekë sipas raportimeve në regjistrin e borxhit në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë, nga 24,958 milionë lekë në 19,423 milionë lekë.

Borxhi i jashtëm i garantuar për shkak se është në valutë të huaj, ndryshimi në kursin e këmbimit ka dhënë efekt pozitiv në uljen e stokut të raportuar të këtij komponentit të borxhit shtetëror.

Sa i takon pagesave të principalit, në sistemin e brendshëm të regjistrimit të transaksioneve të borxhit janë evidentuar shlyerje principali në shumën 40,459 nga të cilat 37,873 milionë lekë për kreditë shtetërore dhe 2,586 milionë lekë për garancitë shtetërore.



Nga auditimi në lidhje me pasqyrimin e transaksioneve të shlyerjes të principalit në llogarinë e unifikuar të thesarit të marrë nga strukturat e thesarit rezultuan diferenca për shkak të raportimeve të ndryshme midis Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit dhe Drejtorisë së Borxhit.

Buxheti i Shtetit për vitin 2024, ka paguar detyrime për rastet e garancive të huaja, kur institucionet përfituese kanë dështuar të përmbushin këto detyrime, tendencë kjo në vijueshmëri nga viti i kaluar.

Gjithashtu, nga auditimi është konstatuar se pagesat e kryera nga Buxheti i Shtetit për garancitë e huaja jo performuese kryhen jo në përputhje me kërkesat e nenit 42, të Ligjit nr. 9665/2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për shkak të mos verifikimit të aftësisë paguese nga institucioni i krijuar me ligj.



Mbi mos arkëtimin e të drejtave në marrëveshjet e nënhuasë, garancitë shtetërore dhe kredive të tjera

Buxheti i shtetit ndër vite është angazhuar në projekte të financuara me kredi shtetërore të huaja, të cilat më pas i ka nënhuazuar sipas përcaktimeve të ligjit të huamarrjes, drejt përfituesve të projekteve (kryesisht në sektorin energjistik, ujësjellës dhe njësi të vetëqeverisjes vendore). Në të njëjtën kohë, ndër vite, për kredi të huaja apo të brendshme, buxheti i shtetit ka dalë garant për shlyerjen e këtyre kredive të palëve të treta sipas për përcaktimeve të ligjit të huamarrjes.

Megjithëse, projektet janë implementuar ose janë në proces implementimi, përfituesit e nënhuave dhe garancive nuk respektojnë detyrimet e tyre kontraktuale, duke angazhuar fonde buxhetore shtesë dhe në të njëjtën kohë duke mos marrë masa për kthimin e këtyre shumave. Kjo, jo në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr.9665 datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”. Të dhënat në lidhje me të drejtat e shtetit për të arkëtuar përkundërt marrëveshjeve të nënhuave, tregojnë rritje të së drejtës për të arkëtuar dhe për vitet e fundit paraqiten:

Në milionë Lekë

Sektori/Institucioni	Detyrimi 2022	Detyrimi 2023	Detyrimi 2024	+/-
Energjia	28,779	31,063	35,034	3,971
KESH	17,429	20,197	23,937	3,740
OSHEE	2,687	2,734	2,782	48
OST	8,662	8,132	8,316	184
Ujësjellës	8,600	8,542	8,862	320
Ujësjellësi Durrës	1,824	1,722	1,905	183
Ujësjellësi Korçë	2,119	2,218	2,348	130
Ujësjellësi Vlorë	1,998	1,913	1,904	-9
Të tjerë ujësjellës	2,658	2,689	2,706	17
Bashki	7,500	7,729	7,405	-324
Bashkia Tiranë	7,418	7,644	7,365	-279
Të tjera bashki	81	85	40	-45
Mikrokredi	121	139	151	12
FAF	0	0	0	0
Unioni Kursim Kredi	121	139	151	12
Armo	9	9	10	1
Hekurudha Shqiptare	0	0	242	242
Albcontrol	0	0	62	62
TOTALI	45,009	47,483	51,766	4,283

Burimi: Ministria e Financave përpunuar nga KLSH

Kostoja shtesë për vitin 2024 ishte 4,283 milionë lekë ku sektorët me përkeqësim të situatës financiare paraqiten, sektori i energjitikës kryesisht me nënhuatë e KESH, OSHEE dhe OST me një shtesë prej rreth 3,971 milionë lekë. Janë shtuar detyrime të reja nga Hekurudha Shqiptare me 242 milionë lekë dhe Albcontrol me 61 milionë lekë, sektori i ujësjellësve me rreth 320 milionë lekë dhe Institucionet e Mikrokredisë me nënhuanë rreth 11 milionë lekë.

Të drejtat për tu arkëtuar nga marrëdhëniet e garancive shtetërore paraqiten në tabelën në vijim referuar institucioneve dhe projekteve specifike:

Në milionë lekë

Institucioni/projekti	Detyrimet 31.12.2022	Detyrimet 31.12.2023	Detyrimet 31.12.2024
Ministria e Energjisë dhe Industrisë (KESH, OST)	15,982	15,349	15,923
Elektrifikimi i Zonave Rurale	1,243	1,200	1,171
Linja e Transmetimit 400 KV Tiranë-Podgoricë	70	76	81
Linja e Transmetimit 400 KV Tiranë-Podgoricë II	901	820	774
TEC-i Vlorë	6,305	5,835	5,560
Transmetim, Shpërndarje e Energjisë	3,124	2,958	2,920
Hidrocentrali mbi Lumin Drin	614	561	561
Nënstacioni i Transmetimit të Energjisë	958	871	823
Plani i rristurimit të KESH	2,766	3,028	4,032
Projekti i efikasitetit në energji	-	-	-
Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës/UKT	1,648	1,603	1,613
Furnizimi me Ujë i Tiranës II	1,013	987	995
Ujësjellësi i Tiranës I	627	609	612
Rehabilitimi i rrjetit hidrik të Tiranës	8	7	7
Hekurudha Durrës	304	294	295
Rehabilitimi i Hekurudhës së Durrësit	304	294	295
Ministria e Financave (ndihmë në mallra)	230	230	219
Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizime Krujë	74	71	71
Radio Televizioni Shqiptar	1,417	1,585	1,770
TOTALI	19,654	19,132	19,892

Burimi: Ministria e Financave përpunuar nga KLSH

Për vitin 2024, gjendja e detyrimeve në lidhje me garancitë shtetërore që subjektet përfituese kanë ndaj shtetit është rritur nga 19,132 milionë lekë në 19,892 milionë lekë, me një rritje vjetore prej 760 milionë lekë.

Këto detyrime të krijuara janë pasojë e pagesave të kryera nga Ministria e Financave si institucioni përgjegjës për detyrimet e rrjedhura në kuadër të garancive shtetërore, të huasë dhënë shoqërive aksionere shtetërore, në rastet e paaftësisë paguese të këtyre shoqërive.

Detyrimet janë akumuluar në masën më të madhe nga institucionet përfituese me kapital shtetëror që operojnë në sektorin energjetik dhe që mbartin një stok të detyrimeve në shumën 15,923 milionë lekë.

Gjithashtu, gjatë vitit 2024 konstatohet se Buxheti i Shtetit ka kryer pagesa si pasojë e paaftësisë paguese edhe të Radio Televizionit Shqiptar, duke rritur stokun e detyrimeve me 185 milionë lekë; ka kryer pagesa për detyrime të rrjedhura nga projektet në Ujësjellës Kanalizime Tirana, sektor ky i cili mbart një stok të detyrimeve në shumën 1,613 milionë lekë.

Konstatohet se, pavarësisht krijimit me ligj nr.55/2023 “Për menaxhimin e garancive dhe kredive shtetërore të pakthyera” të Agjencisë së Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera (AMGKP), përgjegjësia e të cilës është zbatimi i procedurave për marrjen e masave për menaxhimin e skemave të veçanta të garancive, të kërkojë dhe të marrë nga bankat informacion mbi gjendjen e llogarive bankare të subjekteve përfituese të garancisë përpara kryerjes së pagesës nga buxheti i shtetit, nuk është përmirësuar situata nga viti i kaluar.

Mbetet në përgjegjësinë e kësaj Agjencie dhe të Ministrisë së Financave, si institucion autorizues dhe vendimmarrës, analizimi i situatës së pandryshuar dhe marrja e masave për përmirësimin e saj.

E. MBI KONTABILITETIN E SEKTORIT PUBLIK, SISTEMIN E KONTROLLIT TË BRENDSHËM DHE MENAXHIMIN FINANCIAR, SI DHE AUDITIMIN E BRENDSHËM

Neni 63 i ligjit nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar, ndër të tjera ka parashikuar se “Kontrolli i Lartë i Shtetit shqyrton dhe certifikon pasqyrat e konsoliduara vjetore për transaksionet financiare të shtetit dhe i paraqet Kuvendit një raport të plotë për zbatimin e buxhetit të vitit të mëparshëm fiskal”. Nga auditimi konstatohet se edhe për vitin 2024, pasqyrat financiare të sektorit publik, nuk janë përfshirë në raportin vjetor të zbatimit të buxhetit të shtetit, të përgatitur nga ana e Ministrisë së Financave rrjedhimisht KLSH nuk është shprehur në këtë raport me një opinion mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31.12.2024.

Në zbatim të nenit 62 “Përgatitja e llogarive vjetore të buxhetit”, të Ligjit nr. 9936/2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, njësitë publike duhet të përmbushin detyrimin e dorëzimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit të pasqyrave financiare vjetore individuale. Në këtë kuadër, nga auditimi në këtë drejtori u konstatua se 43 institucione nuk kanë dorëzuar ose kanë dorëzuar më vonesë pasqyrat financiare individuale respektive.

Sa i takon dorëzimit të pasqyrave financiare të konsoliduara nga institucionet me njësi varësie, në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 8, datë 09.03.2018”, nga auditimi rezultoi se 47 institucione, përkatësisht 5 ministri linje, 6 këshilla qarku dhe 36 bashki kanë dorëzuar me vonesë pasqyrat financiare të konsoliduara (pas dërgimit të shkresës së tërheqjes së vëmendjes nga DPTH), ndërsa 25 institucione, përkatësisht 1 ministri linje, 2 këshilla qarku dhe 22 bashki nuk i kanë dorëzuar këto pasqyra të konsoliduara.

Nga auditimet e kryera për qëllim të këtij raporti, u konstatuan devijime dhe mangësi ndaj kërkesave të kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi, të cilat kanë cenuar saktësinë, plotësinë dhe gjurmueshmërinë e të dhënave financiare, kanë dobësuar mekanizmat e kontrollit të brendshëm dhe kanë rritur rrezikun e pasaktësive materiale në pasqyrat financiare. Problematikat më kryesore të konstatuara janë:

- Mungesa e një sistemi të integruar informatik për menaxhimin financiar dhe kontabël në nivelin e njësisë vendore. Gjatë auditimeve u konstatua se 29 njësi të vetëqeverisjes vendore vijonë të mbajnë dhe të përditësojnë të dhëna financiare në skedarë Excel (regjistra paralelë), jashtë sistemeve zyrtare të kontabilitetit dhe/ose sistemit të Thesarit duke cenuar kështu sigurinë e të dhënave dhe rritur rrezikun e pasaktësive materiale në pasqyrat financiare të raportuara.
- Mosregjistrim i saktë dhe i plotë i detyrimeve të prapambetura duke çuar në një paraqitje jo të drejtë të pozicionit të tij të detyrimeve ndaj të tretëve në fund të periudhës raportuese, në mungesë të rakordimeve periodike me furnitorët dhe sistemin e Thesarit dhe/ose përdorimit të regjistrave paralelë për detyrimet e prapambetura, në 4 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 2 njësi të qeverisjes qendrore.
- Mosregjistrim i saktë dhe i plotë i të drejtave të arkëtueshme duke çuar në një paraqitje jo të drejtë të këtij pozicioni në pasqyrat financiare gjithashtu edhe në vlerësimin e të ardhurave të

prishme dhe të pozicionit real të flukseve monetare, duke krijuar një paraqitje jo të drejtë dhe jo të besueshme të situatës financiare, në 19 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 3 njësi të qeverisjes qendrore.

- ▶ Problematika në përlllogaritjen e amortizimit të aktiveve 28 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 7 njësi të qeverisjes qendrore, shoqëruar me regjistrime të paplota në kontabilitet duke cenuar saktësinë e pasqyrës së pozicionit financiar të aktiveve të qëndrueshme, si pasojë e zbatimit jo të njëtrajtshëm të metodologjisë së amortizimit dhe e keqklasifikimit të aktiveve në kategoritë përkatëse.
- ▶ Regjistrime korigjuese të paargumentuara me dokumentacion mbështetës të plotë dhe të verifikueshëm ose pas dorëzimit zyrtar në 5 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 1 njësi të qeverisjes qendrore ; mospasqyrim të rezultateve të dalta nga procesi i inventarizimit në kontabilitet ose mungesë e plotë e procesit të inventarizimit në 11 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 5 njësi të qeverisjes qendrore.
- ▶ Pasaktësi në evidentimin kontabël të vlerës së ndërtesave dhe rikonstruksioneve kundrejt listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore si pasojë e dokumentacion teknik dhe ligjor të paplotë, përfshirë mungesën e akteve të kolaudimit, procesverbaleve të marrje-dorëzimit dhe titujve të pronësisë në 19 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 2 njësi të qeverisjes qendrore; Inventarizime të paplotë të aseteve në 23 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 5 njësi të qeverisjes qendrore. Gjithashtu evidentohet se trajtimi i gabuar kontabël i investimeve në proces në 17 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 2 njësi të qeverisjes qendrore.
- ▶ Mos transferim i aseteve nga 11 njësi të vetëqeverisjes vendore te shoqëritë e Ujësjiellës-Kanalizimeve sh.a, sipas VKM-ve respektive të kaluara në administrim dhe pronësi të tyre. Ky transferim nuk është pasqyruar në regjistrat kontabël dhe në pasqyrat financiare, si pasojë e mos koordinimit ndërmjet institucioneve përgjegjëse dhe mangësive në dokumentacionin shoqëruar të këtyre pronave.
- ▶ Gjatë auditimit u konstatua se 5 njësi të vetëqeverisjes vendore, sipas të dhënave të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), figurojnë si aksionare në shoqëri, por vlera e këtyre aksioneve nuk ishte pasqyruar në llogaritë e investimeve në pjesëmarrje në pasqyrat financiare të institucionit.
- ▶ Është konstatuar se llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” është debituar gabimisht në llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”, duke rezultuar në pasaktësi në regjistrim dhe me ndikim në saktësinë dhe klasifikimin korrekt të detyrimeve dhe shpenzimeve në 10 njësi të vetëqeverisjes vendore.
- ▶ Në llogaritë 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” /231 “Investime për aktive afatgjata materiale” janë identifikuar mospërputhje dhe mungesë konsistence në krahasim me llogaritë përkatëse të kapitalit 115 “Fondet e veta të investimeve ” /105 “Tepricat e granteve të brendshëm” /106 “Tepricat e granteve kapitale të brendshme”, duke ndikuar në pasaktësinë dhe paraqitjen e kapitalit neto, të konstatuara në 19 njësi të vetëqeverisjes vendore).
- ▶ Mosrespektim i afateve ligjore për dorëzimin e pasqyrave në 3 njësi të vetëqeverisjes vendore, duke përbërë shkelje të kërkesave ligjore dhe rregullatore për raportim financiar.

Për sa më sipër, evidentohet se situata mbetet e pandryshuar krahasuar me vitin 2023, ku mungesa e një kuadri të plotë, të miratuar të standardeve të kontabilitetit publik, së bashku me dobësitë në procedurat e raportimit dhe konsolidimit të pasqyrave financiare cenon besueshmërinë dhe transparencën e informacionit financiar që ofrohet nga sektori publik.

Mbi auditimin e brendshëm në sektorin publik


Pika 1 të nenit 10 të Ligjit nr.114/2015 *Mbi auditimin e brendshëm në sektorin publik*, të ndryshuar përcakton se “Të gjitha njësitet publike, të përfshira në nenin 3, të këtij ligji, sigurojnë shërbimin e auditimit të brendshëm sipas njërës prej formave të përcaktuara në gerrat a-c të kësaj pike”. Në këtë kuadër, KLSH ka kryer auditimin në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik dhe Kontabilitetit si dhe e ka përfshirë këtë komponent në auditimet individuale të kryera, pjesë përbërëse e këtij raporti.

Nga auditimi në lidhje me ofrimin e shërbimit të auditimit sipas një prej formave të parashikuara në nenin 10 të ligjit për auditimin e brendshëm, rezultoi se gjatë vitit 2024 kanë funksionuar 136 njësi dhe se ky shërbim nuk shtrihet në të gjitha njësitet e përcaktuara në fushën e veprimit të këtij ligji. Konkretisht sipas të dhënave që disponon Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm (DH/AB) nuk janë mbuluar me shërbim auditimi 33 institucione (27 institucione të pavarura dhe 6 njësi të pushtetit vendor).

Nga auditimi i formave të mbulimit të shërbimit të auditimit, rezultoi se 19 institucione varësie të Kryeministrit e marrin shërbimin nga njësia e auditimit të brendshëm në aparatet e Kryeministrit dhe në 5 institucione shërbimi i auditimit mbulohet nga njësia e auditimit e një njësie tjetër publike, nëpërmjet një marrëveshjeje ndërmjet titullarëve të njësive publike përkatëse. Për këto marrëveshje DH/AB nuk disponon në të gjitha rastet kopje të tyre, veprim ky në kundërshtim me pikën 2.2.4 të Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik.

Në lidhje me numrin e audituesve, rezulton se në nivel sistemi janë pjesë e strukturës 475 auditues krahasuar me 526 të parashikuar në organikë, ç’ka paraqet risk për veprimtarinë audituese si rezultat i mos pasjes së burimeve të nevojshme dhe kapaciteteve profesionale njerëzore që do të mundësonin realizimin në kohë dhe me cilësi të shërbimit të auditimit.

Nga auditimi i përmbushjes së kriterit të certifikimit të audituesve në strukturat e Njësive të Auditimit të Brendshëm (NJAB), rezultoi se 48 NJAB kanë në përbërje më shumë se 1/3 e audituesve të pa certifikuar, në kundërshtim me pikën 3, të VKM nr. 83, datë 04.02.2016. Në total, në nivel sistemi rezultojnë 130 auditues të pa certifikuar, ose rreth 28.4% të numrit faktik të punonjësve pranë njësive të auditimit të brendshëm. Ndërkohë, nga auditimi, rezultoi gjithashtu se regjistri i audituesve të certifikuar nuk paraqet informacion të plotë mbi audituesit e certifikuar dhe nuk është i përditësuar.



Burimi: Ministria e Financave përpunuar nga KLSH

Gjatë 2 viteve të fundit (2023-2024) struktura përgjegjëse për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm, nuk ka iniciuar dhe organizuar procesin e certifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik, siç përcaktohet në nenin 24 të Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar.

Nga verifikimi i raportimeve të bëra nga NJAB-t pranë Dh/AB, rezultoi se: 4 nga 136 njësi nuk kanë dorëzuar pranë DH/AB planet e auditimit, 25 njësi nuk kanë zbatuar afatin e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, 5 njësi ndonëse kanë raportuar, nuk kanë paraqitur të dhëna të plota dhe të qarta, 9 njësi kanë raportuar jo në përputhje me pikën “c” të nenit 14, të Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, të ndryshuar, 8 njësi kanë dorëzuar planin pa miratimin përkatës nga titullari i institucionit, Këshilli Mbikëqyrës ose Bordi Drejtues, në kundërshtim me Manualin e Auditimit të Brendshëm.


Sa i takon pyetësorit të vetëvlerësimit për vitin 2024, ai është plotësuar nga 127 nga 136 njësi që kanë detyrimin për të raportuar veprimtarinë e tyre pranë DH/AB, duke ndikuar në plotësinë dhe cilësinë e përgatitjes së raportit të vlerësimit të funksionimit të kontrollit të brendshëm financiar publik.

Referuar realizimit të Planit vjetor të Auditimeve gjatë 2024, nga 1054 auditime të planifikuara janë realizuar 958 auditime gjithsej, vërehet se gjatë vitit ka 435 auditime të kombinuara dhe 372 auditime përputhshmërie, si dhe një numër i konsiderueshëm i auditimeve të pa planifikuara, 38 me kërkesë të titullarëve të njësive publike.

EMËRTIMI	Auditime gjithsej	Shërbimet e Sigurisë					Shërbime konsulence	Angazhime me kërkesë të titullarit
		Auditime Përputhshmërie	Auditime performance	Auditime financiare	Auditime IT	Auditime të kombinuara		
Ndryshime Planit Vjetor 2024	1054	390	26	76	11	542	9	0
Realizim Planit Vjetor	958	372	13	84	8	435	8	38
% e Realizimit të Planit Vjetor	91%	95%	50%	111%	73%	80%	89%	n/a

Burimi: Të dhënat nga DH/AB, përpunuar nga KLSH.

Nga të dhënat rezulton se mos realizimi i planit vjen më së shumti nga mos realizimi i planit të auditimeve të performances me 50% dhe auditime IT me 73%. Nga ana tjetër auditimet financiare rezultojnë me tejkalim 11% të planit vjetor. Në 958 auditime të brendshme të realizuara janë lënë 7292 rekomandime me një shkallë pranueshmërie 99.6% dhe nivel zbatimi 31% ose 2259 rekomandime. Tipologjia e gjetjeve paraqiten në grafikun e mëposhtëm:



Burimi: Ministria e Financave përpunuar nga KLSH

Për vitin 2024, DH/AB janë parashikuar të kryhen 20 vlerësime të jashtme të cilësisë (VJC) së veprimtarisë së njësive të auditimit të brendshëm, nga të cilat janë realizuar 18 vlerësime. Referuar metodologjisë të Vlerësimit të Jashtëm të Cilësisë ku citohet se frekuenca e vlerësimit të jashtëm të cilësisë duhet të kryhet të paktën 1 herë në 5 vjet, ky kriter nuk siguron mbulimin e plotë në rang sistemi, si në planifikim ashtu edhe në realizim.

KLSH në auditimet e kryera ka vlerësuar, punën e njësive të auditimit të brendshëm në njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe shoqëritë aksionare me kapital shtetëror, ku janë konstatuar problematika, të cilat të grupuara sipas natyrës, paraqiten si më poshtë:

- ▶ Strukturë e paplotësuar e Njësive të Auditimit të Brendshëm në 4 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 3 njësi të qeverisjes qendrore, duke kufizuar mbulimin me auditim të fushave me risk dhe realizimin në kohë të planit vjetor të auditimit. Kjo situatë vjen si pasojë e mungesës së procedurave të rekrutimeve dhe lëvizjet e shpeshta të stafit.
- ▶ Mos ngritje e njësive të auditimit të brendshëm në 4 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 1 njësi të qeverisjes qendrore, si dhe mosngritja e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në kundërshtim me kuadrin ligjor në 17 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 2 njësi të qeverisjes qendrore.
- ▶ Ndryshime të shpeshta dhe të paargumentuara të planit të auditimit në 3 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 2 njësi të qeverisjes qendrore, pa u mbështetur në analiza të dokumentuara të riskut, duke sjellë mungesë koherence në programin e punës dhe dobësim të efektivitetit të planifikimit të auditimit.
- ▶ Plane formale të pashoqëruar me një analizë dhe vlerësim të riskut në institucionet ku operojnë në 10 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 3 njësi të qeverisjes qendrore.

- ▶ Nuk janë audituar fushat me risk të lartë, duke treguar mungesë fokusimi në zonat me ndikim të lartë financiar dhe operacional, çka kufizon efektivitetin e auditimit të brendshëm në 5 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 3 njësi të qeverisjes qendrore.
- ▶ Mangësi në dokumentimin dhe cilësinë metodologjike të dosjeve të auditimit, përfshirë mungesën e inventarit standard, dokumentacionit të takimeve dhe planeve të veprimit të subjekteve në 7 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 2 njësi të qeverisjes qendrore. Problematika në hartimin e dokumenteve të auditimit të brendshëm si karta e auditimit të brendshëm në 4 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 1 njësi të qeverisjes qendrore.
- ▶ Mungesë kualifikimi dhe trajnimi të specialistëve në 11 njësi të vetëqeverisjes vendore, jo në përputhje me kërkesat ligjore.
- ▶ Mosndjekja e rekomandimeve nga NjAB në 5 njësi të vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet planeve të veprimit për zbatimin e rekomandimeve.

Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit (DH/MFKK) koordinon ngritjen dhe zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik në institucionet e sektorit publik, duke siguruar monitorimin sistematik të funksionimit të këtyre sistemeve, qëllim mbledhjen e informacionit të nevojshëm për përmirësimin e metodologjisë dhe standardeve të punës.

Nga auditimi u konstatua se DH/MFKK nuk ka përmbushur kërkesat e përcaktuara në urdhrin nr. 311, datë 23.12.2020, sipas të cilit vlerësimi i cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm duhet të kryhet të paktën një herë në 5 vjet për çdo njësi të qeverisjes së përgjithshme. Nga 201 njësi të tilla, gjatë vitit 2024 janë realizuar vetëm 20 kontrole cilësie dhe me këtë performancë, frekuenca e rikontrollit do të ishte 10 vite e jo 5 siç përcaktohet në Urdhrin e lartpërmendur. Nga auditimi rezultoi se nuk është bërë përcaktim i saktë dhe konkret i afateve për evadimin e dokumentacionit në procesin e kontroleve të cilësisë, pavarësisht rekomandimeve të mëparshme të KLSH-së. Në disa dosje të shqyrtuara nga grupi i auditimit, koha mes përfundimit të vlerësimit në terren dhe dërgimit të raportit është mbi 60 ditë kalendarike, ndërkohë që afati maksimal sipas metodologjisë është 32-35 ditë pune.

Në Planin Vjetor të miratuar me urdhrin nr. 338, datë 26.01.2024, për aktivitetet e DH/MFKK, lidhur me vlerësimet e cilësisë, asistencat teknike dhe trajnimet nuk janë përcaktuar afate konkrete të realizimit, por vetëm përshkrimi “gjatë vitit”, gjë që vështirëson ndjekjen dhe kontrollin e progresit. DH/MFKK nuk ka hartuar dhe miratuar një program vjetor trajnimi me tema të përcaktuara dhe afate kohore për zhvillimin e tyre. Trajnimet janë ofruar në bazë të kërkesave të institucioneve, pa një strategji të centralizuar, duke e kufizuar efektivitetin e ndërtimit të kapaciteteve. Mungon baza e të dhënave të strukturuar, që të dokumentojë informacionin mbi trajnimet e realizuara (pjesëmarrësit, institucionet, temat, kohëzgjatja), si dhe personave përgjegjës për ndjekjen e tyre.

Mungon një plan i detajuar për procesin e ofrimit të asistencës teknike, mënyrat e vlerësimit dhe marrjes së feedback-ut. Nga kërkesat për raportim mbi zbatimin e instrumenteve të MFK, të drejtuara nga DH/MFKK për 4 subjekte, vetëm një ka kthyer përgjigje, dhe jo në formatin e kërkuar. DH/MFKK nuk ka përgatitur asnjë raport përmbledhës mbi rezultatet dhe ndikimin e

asistencës teknike të ofruar, as nuk ka plan konkret në lidhje me këtë proces. Nga dokumentacioni i shqyrtuar rezulton se janë organizuar mbledhje dhe trajnime me subjektet përkatëse me subjektet përkatëse, por mungon dokumentimi i veprimeve pasuese dhe një vlerësim sistematik i arritjes së objektivave të asistencës teknike.

U konstatua se DH/MFKK ka dërguar 201 pyetësorë për vetëvlerësim, prej të cilëve janë kthyer të plotësuar vetëm 179, ose rreth 88%. Gjithashtu, disa njësi nuk kanë raportuar në mënyrë të plotë dhe në kohë, duke paraqitur mangësi në dokumentacion dhe vonesa në depozitim të të dhënave. Si pasojë, konsolidimi dhe vlerësimi në nivel kombëtar nga DH/MFKK rezulton i paplotë dhe jo gjithëpërfshirës. Për këto njësi, deri në përfundimit të auditimit në terren, nuk është marrë asnjë masë disiplinore nga Sekretari i Përgjithshëm të Ministrisë përgjegjëse për Financat, pavarësisht dërgimit nga DH/MFKK e listës me institucionet që nuk kanë raportuar, në kundërshtim me pikën 3 dhe 4 të nenit 31, të ligjit nr. 10296/2010, i ndryshuar. Nga përgjigjet e pyetësorit të vetëvlerësimit janë evidentuar vlerësimet në vijim nga DH/MFKK sipas paraqitjes në tabelë :

ELEMENTI	Vlerësimi 2023	Vlerësimi 2024
MJEDISI I KONTROLLIT	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
Parimi 1: Njësia Publike demonstroi angazhim për integritet dhe vlerat etike	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
Parimi 2: Titullari / Nëpunësi Autorizues (NA) / Bordi apo Këshilli i drejtuesve demonstroi pavarësi dhe përgjegjësi në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
Parimi 3: Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
Parimi 4: Njësia publike demonstroi angazhim në realizimin e kompetencave	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
Parimi 5: Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjësinë menaxheriale	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
MENAXHIMI I RISKUT	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
Parimi 6: Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikim dhe vlerësim të risqeve në lidhje to	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
Parimi 7: Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
Parimi 8: Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut të mashtrimeve	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
Parimi 9: Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet e rëndësishme	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
AKTIVITETET E KONTROLLIT	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
Parimi 10: Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitetet e kontrollit	Efektiv	Pjesërisht efektiv
Parimi 11: Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të përgjithshme të kontrollit mbi teknologjinë	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
Parimi 12: Njësia Publike vendos aktivitete kontrollit përmes politikave dhe procedurave	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
INFORMIMI DHE KOMUNIKIMI	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
Parimi 13: Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacionin përkatës cilësor	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
Parimi 14: Njësia Publike përdor komunikimin e brendshëm	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
Parimi 15: Njësia Publike përdor komunikimin e jashtëm	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
MONITORIMI	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
Parimi 16: Njësia Publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme dhe/ose të veçanta të sistemit të kontrollit të brendshëm	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
Parimi 17: Njësia Publike vlerëson dhe komunikon mangësitë	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
TOTAL	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv

Burimi: DH/MFKK në Ministrinë e Financave

Nga krahasimi me vitin 2023, asnjë prej elementëve nuk paraqitet në përmirësim me përjashtim të një ulje e efektivitetit për parimin nr. 10, pjesë e Aktiviteteve të Kontrollit nga viti i kaluar. Këto rezultate të dala nga procesi i vetëvlerësimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm financiar janë në një linjë me konstatimet e KLSH-së nga auditimet e kryera në njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe shoqëritë aksionare me kapital shtetëror, ku problematikat kryesore referuar komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, paraqiten si më poshtë:

MJEDISI I KONTROLLIT

- Mungesë e prioritetëve, vizionit, misionit dhe Planit Strategjik të Zhvillimit Afatmesëm në 7 institucione,
- Mungesë e dokumenteve të politikave institucionale në 7 institucione, dokumente këto të cilat duhet të drejtojnë vendimmarrjen duke sjellë fragmentim në proceset vendimmarrëse dhe cenuar efektivitetin e mjedisit të kontrollit,
- Mungesë e objektivave të matshme dhe të përcaktuar qartë në 5 institucione, duke bërë të pamundur matjen e performancës së institucionit,
- Mungesë e Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit në 4 institucione dhe Kodit të Etikës dhe procedurave për raportimin e shkeljeve në 7 institucione duke krijuar paqartësi në ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi,
- Mosngritje e Ekipit të Menaxhimit të Programeve dhe Grupit të Menaxhimit Strategjik në 8 institucione, të cilat kanë rol kyç në monitorimin e programeve dhe koordinimin institucional. Në 16 institucione rezulton mosdokumentim të vendimmarrjeve të GMS,
- Në 10 institucione mungojnë planet e veprimit për zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm,
- Në 13 institucione nuk janë përgatitur manualët e proceseve të punës, dhe në 17 institucione mungon përcaktimi i hartës së proceseve sipas sektorëve apo drejtorive,
- Në 29 institucione nuk janë hartuar apo përditësuar gjurmët standarde të auditimit (GjSA), duke vështirësuar gjurmueshmërinë e proceseve,
- Në 5 institucione nuk janë vendosur mekanizmat antikorrupsion për sinjalizimin e brendshëm; ndërsa janë konstatuar institucione të mospërcaktimit të qartë të përgjegjësi për NA dhe NZ dhe parregullsi në procedurat e vetëvlerësimit institucional,
- Në 5 institucione mungon rregullorja për mirëadministrimin e aktiveve, dhe në 9 institucione janë konstatuar mangësi në zbatimin e kuadrit për Protokoll-Arkivën dhe ruajtjen e informacionit,
- Në 19 institucione mungojnë plane vjetore dhe afatmesme për trajnimin e stafit, si dhe programe të dedikuara për zhvillimin profesional; ndërkohë në 14 institucione nuk janë zhvilluar trajnime për menaxherët dhe stafin mbi SKB,
- Në 8 institucione nuk janë reflektuar ndryshimet strukturore në rregulloret e brendshme, ndërsa janë konstatuar parregullsi në procedurat e delegimit të kompetencave.

Nga auditimet e teknologjisë dhe informacionit u konstatua:

- Infrastrukturë IT e vjetruar dhe joefikase; mungesë komponentësh bazë sigurie (firewall, switch-e të menaxhueshme), pajisje/periferikë të amortizuar, sisteme operative jo të sigurta, lidhje ADSL jo stabil në 2 institucione,

- Mbrojtje kibernetike e pamjaftueshme; mungesë licenca, politika të paqarta/pa zbatuara për aksesin dhe menaxhimin e fjalëkalimeve; ekspozim fizik i pajisjeve; mungesë qendre menaxhimi rrjeti në 3 institucione,
- Mungesë kuadri rregullator dhe dokumentacioni bazë për TI në 4 institucione,
- Mungesë kontrollesh dhe mekanizmash për krijim/mirëmbajtje/zhvillim të burimeve IT; mungesë delegimi përgjegjësish për sisteme kritike/online në 2 institucione,
- Mospërputhje sistemesh dhe rrezik për integritetin e të dhënave në 1 institucion.

Nga auditimet e performancës u konstatua:

- Kuadër ligjor/rregullator i paplotë ose i pazbatuar në 5 institucione,
- Struktura dhe koordinim i pamjaftueshëm institucional në 12 institucione,
- Planifikim strategjik dhe financiar i pamjaftueshëm në 9 institucione,
- Procese, dokumentim dhe evidencë të pamjaftueshme në 6 institucione.

MENAXHIMI I RISKUT

- Mosngritja e strukturës së menaxhimit të riskut dhe përcaktimit të përgjegjësive në 14 institucione si dhe në 18 institucione u konstatua mungesë e regjistrimit dhe matricës së riskut,
- Analiza e riskut jo periodike dhe jo e lidhur me planifikimin në 19 institucione, me impakt në devijime ndërmjet burimeve të planifikuara dhe risqeve reale, duke rritur ekspozimin ndaj vonësive dhe shpenzimeve joefikase,
- Në lidhje me menaxhimin e riskut dhe mekanizmat mbështetës të kontrollit të brendshëm, është konstatuar se në 8 institucione nuk është caktuar Koordinatori i Riskut dhe MFK, si dhe Koordinatori i Deleguar i Riskut, duke kufizuar përfshirjen e këtyre strukturave në proceset e vendimmarrjes dhe monitorimit të risqeve,
- Gjithashtu, në 10 institucione është vërejtur mungesa e një procedure të veçantë për mbledhjen, dokumentimin dhe analizën e gabimeve apo ankesave, duke cenuar ndërtimin e një sistemi efektiv të komunikimi dhe informimi.

Nga auditimet e teknologjisë dhe informacionit u konstatua:

- Mungesë masash bazë sigurie dhe politika të paformalizuara, në 1 institucion,
- Kontroll i pamjaftueshëm teknik i TI në, 3 institucione,
- Mospërputhje dhe shpëputje nga sistemet qendrore ose ndërveprueshmëri e ulët, në 1 institucion,
- Sisteme kritike jo-funksionale dhe praktikë manuale që çënon integritetin e të dhënave, në 1 institucion.

Nga auditimet e performancës u konstatua:

- Kuadër rregullator/strategjik i paplotë në, 4 institucione,
- Planifikim dhe indikatorë të pamjaftueshëm për matjen e performances, në 8 institucione,
- Mbikëqyrje dhe instrumente kontrolli të pamjaftueshëm, në 8 institucione,
- Nivel i lartë risqesh për mjedisin, në 10 institucione,
- Mungesë gjurme auditimi, në 5 institucione.

AKTIVITETET E KONTROLLIT

- Mungesë manualesh dhe dokumentesh standarde të punës dhe kontrollit në 30 institucione, të cilat sigurojnë uniformitet dhe gjurmueshmëri të veprimtarive,

- ▶ Ndarje e pamjaftueshme detyrash dhe funksionesh kyçe në 15 institucione, duke rritur riskun e mbivendosjeve, paqartësive dhe përgjegjësi,
- ▶ Mangësi në prokurime dhe menaxhim kontratash në 14 institucione në të cilat proceset e prokurimit nuk ishin të shoqëruara me dokumentacion të plotë, nuk ishte përcaktuar qartë fondi limit, ndërsa mbikëqyrja e kontratave rezultoi e mangët. Kjo ka sjellë risk të lartë për shpenzime joefikase dhe mosrespektim të parimeve të konkurrencës e transparencës,
- ▶ Kontrolle të pamjaftueshme në teknologjinë e informacionit në 25 institucione, ku mungonin politika për administrimin e aksesit në sisteme, rregullat dhe sistemet e backup-et e të dhënave dhe nuk mbahej gjurma e auditimit me pasojë rritjen e riskut të humbjes së informacionit.

Nga auditimet e teknologjisë dhe informacionit u konstatua:

- ▶ Kuadër dhe masa sigurie të pamjaftueshme në infrastruktura kritike, në 3 institucione,
- ▶ Mungesë kontrollesh teknike dhe plane vazhdimësie/rikuperimi, në 1 institucion,
- ▶ Mangësi në ruajtjen dhe garantimin e integritetit të të dhënave, në 2 institucione,
- ▶ Kapacitete të pamjaftueshme operationale të TI, në 1 institucion.

Nga auditimet e performancës u konstatua:

- ▶ Mungesë planesh masash/zhvillimi për pasuritë UNESCO, në 1 institucion,
- ▶ Menaxhim i papërshtatshëm dhe kapacitete të pamjaftueshme inspektimi në 9 institucione,
- ▶ Pamjaftueshmëri e dokumentimit të proceseve mbikëqyrëse, në 5 institucione,

INFORMIMI DHE KOMUNIKIMI

- ▶ Mungesë e një sistemi të unifikuar i raportimit të brendshëm, me afate dhe format të paracaktuara, duke sjellë vonesa dhe mospërputhje në informacionin e dorëzuar për vendimmarrje në 8 institucione,
- ▶ Komunikim i brendshëm jo i formalizuar ndërmjet njësive organizative në 4 institucione duke sjellë moskoordinim, informacion të fragmentuar dhe risk për vendimmarrje të pjesshme,
- ▶ Transparencë dhe akses i kufizuar në të dhëna ndaj publikut dhe institucioneve të tjera në mospërputhje me programin e transparencës në 6 institucione.

Nga auditimet e teknologjisë dhe informacionit u konstatua:

- ▶ Kanale dhe infrastrukturë komunikimi joefektive, në 3 institucione,
- ▶ Menaxhim i pamjaftueshëm i aksesit dhe kredencialeve, në 1 institucion,
- ▶ Mungesë e gjurmës dokumentare dhe planit të vazhdimësisë, në 1 institucion.

Nga auditimet e performancës u konstatua:

- ▶ Koordinim i munguar për dosjet UNESCO dhe detyrimet e konventave, në 2 institucione,
- ▶ Menaxhim jo i standardizuar dhe pa struktura të dedikuara për plazhet, në 6 institucione,
- ▶ Transparencë e pamjaftueshme dhe mungesë platformash zgjidhjeje mosmarrëveshesh, në 4 institucione,
- ▶ Informim publik i pamjaftueshëm në 6 institucione, Gjurmë audituese jo e plotë në sistemin e-Inspektim në 4 institucione.

MONITORIMI

- Mos kryerje e procesit të vetëvlerësimit periodik të sistemit të MFK në 6 institucione dhe/apo mungesë e raporteve për funksionimin e kontrolleve, duke penguar identifikimin e hershëm të dobësive dhe përmirësimin e qëndrueshëm të këtyre kontrolleve në 10 institucione ,
- Mungesë e planeve të veprimit dhe ndjekjes së tyre për zbatimin e rekomandimeve, duke sjellë përsëritjen e problematikave të konstatuara në 10 institucione,
- Raportim i pjesshëm ose jashtë afatit mbi funksionimin e MFK në 10 institucione.

Nga auditimet e teknologjisë dhe informacionit u konstatua:

- Kapacitete të pamjaftueshme monitoruese dhe reagimi ndaj incidenteve në 3 institucione,
- Mungesë planesh dhe mekanizmash formalë monitorimi/vazhdimësie në 1 institucion,
- Sisteme jo-funksionale dhe mungesë kontrolli mbi mirëmbajtjen në 1 institucion.

Nga auditimet e performancës u konstatua:

- Monitorim i pamjaftueshëm dhe mungesë plani menaxhimi në 3 institucione,
- Zbatim i pjesshëm i PKMM dhe mungesë raportimi plani në 3 institucione,
- Funksionim jo i rregullt i organit këshillimor dhe mungesë qasjeje të koordinuar për aksesueshmërinë në 4 institucione,
- Mbikëqyrje mjedisore e pamjaftueshme në 7 institucione.

F. ANEKSET

Aneksi 1. Lista e auditimeve për raportin e zbatimit të buxhetit 2024

Nr	Auditime
	Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit
1	Ministria e Financave mbi Zbatimin e Buxhetit
2	Ministria e Financave (Aparati)
3	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
4	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
5	Dega Doganore Rinas
6	Dega e Doganës Durrës
7	Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës
8	Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan
9	Instituti i Sigurimeve Shoqërore
10	Fondi i Kujdesit të Detyrueshëm Shoqëror
11	Disponibiliteti i barnave në trajtimin e sëmundjeve tumorale
12	Korporata e Investimeve Shqiptare
13	Mbi ecurinë, performancën dhe efektivitetin e masave të marra në lidhje me borxhin doganor
14	Mbi vlerësimin e ecurisë, performancës dhe efektivitetit të masave të marra në lidhje me borxhin tatimor
15	Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të tjerë
16	QendrA Burimore “Ramazan Kabashi”
17	Avokati i Popullit
18	Cirku i Tiranës
19	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave
20	Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë
21	Mbi Përputhshmërinë e monitorimit të HEC “Sasaj” Sarandë
22	Mbi përputhshmërinë në ofrimin e shërbimit rezidencial dhe procedurat për birësimin e të miturve
23	Shkolla e Magjistraturës
24	Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër
25	Universiteti i Tiranës: Fakulteti i Ekonomisë dhe Gjuhëve të Huaja
26	Universiteti i Tiranës: Gjuhët e Huaja
27	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit me temë: “Përmirësimi i aksesit të barabartë në shërbimet publike të standardit të lartë nëpërmjet operacionit Govtech”
	Departamenti i Auditimit të Njërive të Vetqeverisjes Vendore dhe Pronës Publike
28	Bashkia Belsh
29	Bashkia Berat
30	Bashkia Bulqizë

31	Bashkia Dimal
32	Bashkia Divjakë
33	Bashkia Delvinë
34	Bashkia Devoll
35	Bashkia Dropull
36	Bashkia Durrës
37	Bashkia Finiq
38	Bashkia Fushë Arrëz
39	Bashkia Gjirokastër
40	Bashkia Gramsh
41	Bashkia Has
42	Bashkia Kamëz
43	Bashkia Kavajë
44	Bashkia Këlcyrë
45	Bashkia Klos
46	Bashkia Kolonjë
47	Bashkia Konispol
48	Bashkia Korçë
49	Bashkia Krujë
50	Bashkia Kukës
51	Bashkia Kurbin
52	Bashkia Lezhë
53	Bashkia Libohovë
54	Bashkia Lushnje
55	Bashkia Malësi e Madhe
56	Bashkia Mallakastër
57	Bashkia Mat
58	Bashkia Memaliaj
59	Bashkia Mirditë
60	Bashkia Patos
61	Bashkia Përmet
62	Bashkia Pogradec
63	Bashkia Poliçan (financiar)
64	Bashkia Prrenjas
65	Bashkia Pukë
66	Bashkia Pustec
67	Bashkia Roskovec
68	Bashkia Rrogozhinë
69	Bashkia Shijak
70	Bashkia Skrapar
71	Bashkia Tepelenë

72	Bashkia Tropojë
73	Bashkia Vau i Dejës
74	Bashkia Vorë
75	Bashkia Poliçan evaduar 2024
	Departamenti i Auditimit të Institucioneve të Sigurisë, Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja
76	Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, Drejtoria Rajonale Durrës
77	Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, Drejtoria Rajonale Shkodër
78	Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, Drejtoria Rajonale Tiranë
79	Projekti: “Infrastruktura Bashkiake V”
80	Shoqëria Rajonale e Ujësllës Kanalizime Lezhë SHA
81	Spitali Rajonal Vlorë
82	Termocentrali i Vlorës SHA
83	KESH, OST, OSHEE, mbi detyrimet e ndërsjellta
84	Ndërtimi i Qendrës Rajonale të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve në Sherishtë të Vlorës
85	Operatori i Sistemit të Transmetimit SHA
86	Agjencia Kombëtare e Ujësllës Kanalizimeve
	Departamenti i Auditimit IT
87	Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara
88	Drejtoria Rajonale të Arsimit Parauniversitar Lezhë
89	Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër
90	Qendra e Arsimit Bashkia Lushnje
91	Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët
92	Qendra Kombëtare e Kinematografisë
93	Siguria kibernetike në infrastrukturën kritike e-Taxation
94	Universiteti i Sporteve të Tiranës
95	Zyra Rajonale Statistikore Fier
	Departamenti i Auditimit të Performancës
96	Orientimi për karrierë i nxënësve, në Sistemin Arsimor Parauniversitar
97	Mbrojtja e vlerave dhe pasurive të vendit tonë në UNESCO
98	Menaxhimi i hapësirave publike në plazhe
99	Cilësia dhe certifikimi i ujit të pijshëm që hidhet në treg për qytetarin
100	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura Tiranë, në Administratën e Zonave të Mbrojtura AdZM Kukës, AdZM Berat dhe AdZM Vlorë
101	Aksesueshmëria për personat me aftësi të kufizuar
102	Blerjet online në Shqipëri, taksat dhe shërbimi ndaj qytetarit
103	Masat e ndërmarra nga institucionet përgjegjëse për eliminimin e derdhjes së ujërave të përdorura në Lumin e Lanës në Tiranë
104	Ndikimi në mjedis dhe shëndet i aktivitetit të shfrytëzimit të naftës dhe gazit në zonën Patos-Marinëz
105	Ndotja e Liqenit Artificial të Tiranës
106	Roli dhe efektiviteti i oficerëve të sigurisë në shkolla

Aneksi 2- Përmbledhja e dëmit ekonomik dhe efekteve financiare negative, për buxhetin 2024

Në mijë lekë

Dëm ekonomik	
Shpenzime	21,029
Shpenzime për paga, shpërblime & sigurime shoqërore	1,186
Shpenzime të tjera	506
Zbatim punimesh / investime	19,337
Të Ardhura	121,700
Të Ardhura nga aktiviteti doganor	73,534
Të Ardhura të tjera	48,166
Totali	142,729

Në mijë lekë

Efekte financiare negative	
Shpenzime	1,886,258
Shpenzime për investime	301,089
Shpenzime operative	508,358
Shpenzime për paga, shpërblime & sigurime shoqërore	109,985
Shpenzime të tjera	966,826
Të Ardhura	8,493,409
Të ardhura nga keqadministrimi i pasurisë shtetërore dhe marrëdhëniet kontraktuale me palët e treta	397,014
Të Ardhura nga aktiviteti doganor	565,974
Të Ardhura nga aktiviteti tatimor	370,180
Të Ardhura të tjera	5,881,658
Të ardhurat nga sektori i tatimeve në qeverisjen vendore	1,278,583
Totali	10,379,667

KONTAKT



Rruga "Abdi Toptani" Nr. 1, Tiranë



www.klsh.org.al



klsh@klsh.org.al



Kontrolli i Lartë i Shtetit



[klsh_org_al](https://www.instagram.com/klsh_org_al)



(KLSH) Albanian Supreme Audit Institution